



Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology



TË PARANDALOJMË TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

MANUAL PËR MËSUES





TË PARANDALOJMË TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

MANUAL PËR MËSUES



Ky material u mundësua falë mbështetjes financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Qeverisë Finlandeze dhe asaj të Qeverisë së Holandës



Ministria e Arsimit,
e Shkencës dhe e Teknologjisë



Ministria Punëve
të Jashtme të Finlandës



Ministria Punëve të Jashtme të
Hollandës

Materialet e këtij teksti janë përpunuar nga manuali “Trafikimi i qenieve njerëzore dhe roli i shkollës në parandalimin e tij”, botim i Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë. Ky tekst është përshtatur për planin dhe programin shkollor në Kosovë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT): Lulavere Kadriu, Shqipe Gashi dhe nga IOM Kosova: Nora Demiri dhe Hera Shanaj.

Botuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në Kosovë

IOM Prishtina:

Address: Ismail Qemali 18, Arberi II

Tel: +381 38 249 042; 249 059; 249 041

Fax : +381 38 249 039

E-mail: iompristina@iom.ipko.org

Web faqja: www.iomkosovo.org

Ky botim është subjekt i të drejtës së autorit. Çdo referencë në lidhje me të, pjesë të veçanta të tij, apo përdorim i tekstit të përfshirë në këtë botim duhet të njohin të drejtën e autorësisë sipas ligjit përkatës në fuqi.

Korrektuar nga : Enton Elezi

Design&prepress: IDEA graphics - Prishtinë

Illustrations: Jeton Mikullovc

Print: Grafoprint



Falenderime të veçanta për Prof. Asoc. Dr. Marita Hamza, Prof. Asoc. Dr. Marjana Sinani, Prof. Asoc. Dr. Fatmira Zeneli nga Instituti i Studimeve Pedagogjike në Tiranë, si dhe për zyrën e IOM-it në Tiranë, për kontributin e dhënë për pjesë të veçanta të këtij libri, si dhe Ramush Lekaj dhe Habibe Buzuku (MASHT) Ann Guthmiller dhe Artan Billaca (IOM Kosova) për kontributin e tyre në realizimin e këtij projekti.

PARATHËNIE

Trafikimi i qenieve njerëzore në Kosovë është krim që është përkeqësuar prej vitit 1999 dhe për një kohë të gjatë është menduar si problem që godet vetëm vajzat dhe gratë e huaja (në këtë kapitull kur themi: vajza dhe gra “të huaja” i referohemi personave me origjinë jo kosovare). Ndonëse në vitet e para pas 1999, ky fenomen negativ është lidhur kryesisht me vajzat adoleshente dhe gratë e huaja, të cilat janë trafikuar në Kosovë, sot krimi i trafikimit të vajzave dhe grave kosovare, si në Kosovë, dhe jashtë vendit është i pamohueshëm. Egzistojnë prova për të besuar që ky krim është në rritje.

Aktualisht, Kosova nuk është vetëm vend tranziti apo destinacioni, por është edhe vend ku trafikimi i brendshëm për shfrytëzim seksual është në rritje. Megjithëse trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual mbetet dominues, ekzistojnë të dhëna edhe për forma të tjera të shfrytëzimit. Sidoqoftë, rastet e identifikuara të fëmijëve të trafikuar për kërkim lëmoshe, të cilëve iu është dhënë ndihmë, janë të pakta.

Duke humbur shpresën për një jetë më të mirë, duke pasur vështirësi ekonomike, probleme familjare, apo mungesë të informacionit të drejtë, shumë vajza largohen nga shtëpitë e tyre duke besuar në premtimet për punë, martesë apo kushte më të mira të jetës. Edhe më tronditës është fakti që disa nga ato janë rrëmbyer nga trafikantët për t’u shfrytëzuar.

Për të luftuar këtë dukuri, Këshilli i Ministrave i Institucioneve të Përkohshme Vetë-Qeverisëse të Kosovës, me datë 17 Maj 2005, ka miratuar “Planin e veprimit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë”. Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM-i) dhe organizata të tjera ndërkombëtare e kanë ndihmuar dhe mbështetur Zyrën Këshilldhënëse për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, gjatë gjithë procesit të hartimit të këtij plani.

Plani i veprimit për luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë shtron detyra për institucionet e Kosovës që të konkretizojnë masat për ta luftuar këtë dukuri. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse që të “sigurojë jetësimin dhe rrjedhën e vazhdueshme të ndërgjegjësimit të nxënësve për problemin e trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet planit dhe programit shkollor në nivelin e shkollave para-universitare”.

Përvoja e ofruar në këtë kapitull synon hapjen e horizonteve të reja për mësimdhënësit dhe sistemin shkollor, duke u mundësuar atyre të bëhen aktorë të fuqishëm në dhënien e kontributeve të pazëvendësueshme në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, e në veçanti të fëmijëve.

PËRMBAJTJA

Faqe

1. Hyrje.....	5
2. Kapitulli I: Trafikimi i Qenieve Njerëzore	6
3. Kapitulli II: Dhuna Gjinore dhe Dhuna Familjare	20
4. Kapitulli III: Roli i Shkollës në Transmetimin e Vlerave tek Nxënësit	28
5. Kapitulli IV: Shkolla, Kurrikula dhe Formimi i të Rinjve mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Rreziqet që ai Mbart.....	40
6. Kapitulli V: Trafikimi dhe HIV/AIDS, si dhe Infeksionet e Tjera Seksualisht të Transmetueshme (IST)	53
7. Kapitulli VI: Mësime Model.....	67

HYRJE

Trafikimi i qenieve njerëzore është një formë bashkëkohore e skllavërisë dhe përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Protokoli i Palermos i vitit 2001 e cilëson trafikimin e qenieve njerëzore si:

“Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës, ose formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të dredhisë, të mashtrimit, të abuzimit të pushtetit, ose të një pozite vulnerabiliteti, ose i dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi, duke pasur kontrollin mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin në minimum, shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, zgjedhë apo heqje organesh.¹”

Kjo dukuri e ka prekur thellë shoqërinë kosovare, si vend origjine, tranziti dhe destinacioni. Organizata të ndryshme japin shifra të ndryshme të rasteve të asistuar të trafikimit; përfshirë viktimat e huaja dhe kosovare. Kështu, Njësi hetues për prostitucion dhe trafikim (NjHPT) i policisë ka asistuar 241 raste të trafikimit, prej tyre 23 apo 9.54% kanë qenë fëmijë (nga 1999 deri në Prill 2004); Qendra për punë sociale (QPS) ka asistuar 73 raste të trafikimit, 61 prej tyre apo 83.56% kanë qenë fëmijë (nga 1999 deri në Prill 2004); Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve (QPGF) ka asistuar 469 raste të trafikimit, 278 apo 59.27% prej tyre kanë qenë fëmijë.²

Natyrisht, për vetë shkaqet sociale, ekonomike, kulturore dhe politike nga të cilat burojnë këto fenomene kriminale, nuk mundet që shërimi të jetë i shpejtë, i plotë, madje as i lehtë. Për të arritur në reduktimin dhe zhdukjen e këtyre fenomeneve, duhet një koordinim përpjekjesh e vullnet i përbashkët i shumë strukturave shoqërore, vendore e ndërkombëtare.

Një institucion i tillë është dhe shkolla, e cila mund të japë një kontribut të pazëvendësueshëm në pajisjen e brezit të ri me informacionin e duhur mbi trafikimin, shfrytëzimin dhe skllavërimin e njerëzve, në veçanti të fëmijëve, vajzave e grave, duke transmetuar te ky brez vlera universale mbi jetën, vendimmarrjen, ndërtimin e së ardhmes, të drejtat e njeriut etj.

Ky program synon që të rinjtë të ndërgjegjësohen dhe të mos mashtrohen nga premtimet joshëse, nga mundësitë e dyshimta të punësimit në vend dhe jashtë vendit, të cilat mund të çojnë në prostitucion të detyruar, shfrytëzim për lypje, shpërndarje droge, punë shtëpiake, transplantim organesh, si rezultat i mashtrimit, paditurisë dhe mungesës së informacionit.

Ky manual do të ndihmojë mësuesit, që të realizojnë në mënyrë cilësore e bashkëkohore trajtimin dhe shpjegimin e temave të tilla sociale, tepër të prekshme në komunitetet që rrethojnë shkollën, duke synuar në këtë mënyrë që shkolla, me kapacitetet dhe mundësitë e saj, të kontribuojë në mënyrë serioze në parandalimin që në embrion të këtyre fenomeneve.

1 Protokoli i Kombeve të Bashkuara për të Parandaluar, Ndaluar dhe Ndëshkuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar; dhjetor 2000.

2 Trafikimi i fëmijëve në Kosovë, studimi mbi mbrojtjen dhe asistencën që u ofrohet fëmijëve viktimat të trafikimit, UNICEF, Kosovë, Qershorë 2004.

1.1 Informacion i përgjithshëm

Trafikimi i qenieve njerëzore është një dukuri globale dhe konsiderohet si “Sklavëria e kohëve moderne”. Trafikimi i grave dhe vajzave nuk lidhet thjesht vetëm me prostitucionin e detyruar dhe shfrytëzimin seksual, por përfshin gjithashtu shfrytëzimin e njeriut në forma të ndryshme, dhunimin dhe probleme të tjera shoqërore.

Shumë vajza e gra nga vende të Europës Lindore, kryesisht nga Moldavia, Rumania, Shqipëria, Ukraina, Bullgaria, Rusia, Serbia dhe Sllovenia, u trafikuan në Kosovë, menjëherë pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999. Ato u rekrutuan në rrjetin e trafikimit në mënyra të ndryshme, por kryesisht nëpërmjet ofertave të rreme për punë. Në përgjithësi, viktimat e huaja të trafikimit janë femra, shumica të moshës së re. Rreth 60% janë të moshës 18-25 vjeçe³, të joshura nga ofertat për punë jashtë vendit, në kërkim të një jete më të mirë. Gjithashtu, ka raste edhe të grave të divorcuara që kanë pranuar të dalin jashtë vendit vetëm për të mbajtur fëmijët e tyre.

Vendi i origjinës	Janar 1999-dhjetor 2005
Moldavia	216
Rumania	89
Ukraina	58
Bulgaria	28
Shqipëria	27
Serbia	3
Rusia	3
Sllovakia	1
Nigeria	1
Totali:	585

Hera e parë që është raportuar për trafikimin e grave dhe fëmijëve kosovarë ishte në vitin 1999, në kohën kur mbi 800.000 kosovarë jetonin në kampe të refugjatëve në Shqipëri dhe në IRJ të Maqedonisë. Po ashtu, menjëherë pas konfliktit, flitej për raste në rritje të rrëmbimit të grave dhe të vajzave, që përhapën frikë në mesin e vajzave dhe grave kosovare⁴.

Rastet e para të viktimave kosovare, të trafikuar në vend dhe jashtë vendit, janë identifikuar nga policia e UNMIK-ut dhe janë asistuar nga IOM-i, në vitin 2001, duke iu siguruar strehim të sigurtë, përkujdesje mjekësore, si dhe ndihmë për t'u riatdhesuar. Që nga kjo kohë, numri i viktimave të asistuar është rritur për çdo vit. Në mesin e 58 rasteve të viktimave kosovare të trafikimit, të asistuar nga IOM-i (prej vitit 2001 deri në dhjetor të vitit 2005) 35 apo (60.34 %) janë nën moshën 18 vjeç. Ndonëse janë përdorur mënyra të ndryshme për rekrutimin e tyre në rrjetin e trafikimit, rastet më të shpeshta të raportuara përfshijnë: ofertat e rreme për punë, përgatitje të rreme udhëtimi marrjen me dhunë/rrëmbimin, dhe më pak të përdorura janë ofertat për martesë të rreme.

Faktor shqetësues është moshë e re e vajzave kosovare të trafikuar për shfrytëzim

3 Kjo e dhënë bazohet në moshën mesatare të vajzave dhe grave të huaja të trafikuar në Kosovë, të asistuar nga zyra e IOM-it, nga viti 1999 deri në dhjetor të vitit 2005.

4 UNIFEM, Nuk ka vend të sigurtë, Kosovë, 2000.

seksual, në përgjithësi të moshës 12-17⁵. vjeçe. Aktualisht, numri i rasteve të identifikuar të vajzave dhe grave kosovare të trafikuar jashtë vendit është relativisht më i ulët sesa numri i atyre të trafikuar Brenda Kosovës. Sidoqoftë, duke pasur parasysh numrin e madh të viktimave të trafikuar brenda Kosovës, ekziston shqetësimi dhe arsyeja për të besuar që një numër i madh i viktimave kosovare “zhvendosen” nga trafikantët për t’u shfrytëzuar edhe jashtë Kosovës.

Viktimat e trafikimit i nënshtrohen kufizimit të lirisë, përdhunimit, dhunës fizike, psikike e ndonjëherë edhe vrasjes. Ato pësojnë kërcënime për veten dhe për familjet e tyre, përballen me probleme shëndetësore (fizike dhe psikologjike) dhe rreziqe të tjera ndaj mirëqenies së tyre, duke u detyruar të përdorin narkotikë dhe praktikojnë seks të pambrojtur.

Trafikimi i qenieve njerëzore vjen për shkak të një sërë faktorëve. Ndër më kryesorët, janë faktet që personat që bien viktimë e trafikantëve, shpesh vuajnë varfërinë dhe mungesën e perspektivës për të ardhmen, mungesën e mundësive ekonomike në vendin e origjinës, mungesën e arsimit dhe informacionit, dhunën dhe shpërdorimin në familje etj. Trafikantët i konsiderojnë ato si të mira materiale dhe trafikimin e shrytëzimin si një mënyrë tjetër për të fituar jetesën.

Shkaqet e lartpërmendura kanë ndikuar që shumica e viktimave të trafikimit të kërkojnë punë dhe një të ardhme më të mirë në qytetet më të mëdha në Kosovë dhe jashtë vendit. Një numër i konsiderueshëm i viktimave kosovare janë mashtruar nga premtimet e rreme për punë.

Viktimat e trafikimit përballen me:

- Mashtrim
- Dhunë
- Kufizim të lëvizjes së lirë
- Përdhunim
- Abuzim mendor dhe fizik
- Torturë

Në shumicën e rasteve, personat e trafikuar janë nën kontrollin dhe mbikqyrjen e tutorëve, mjaft të pambrojtur ndaj akteve kriminale. Trafikantët i rrahin, abuzojnë me to seksualisht, i torturojnë, ndonjëherë viktimat e trafikimit edhe vdesin si pasojë e keqtrajtimit, apo vriten nga trafikanti në rast se nuk u binden atyre. Vrasja kryhet ndaj atyre që mundohen të ngrenë krye dhe shërben si shembull për të tjerët. Qëllimi i këtij keqtrajtimi është që vajzat të ndihen të rrënuara, të shkatërruara, të urrejnë veten dhe t’u binden atyre.

Edhe klientët mund të jenë të dhunshëm ndaj vajzave dhe grave që detyrohen të prostitutojnë, mund t’i keqtrajtojnë e ndonjëherë edhe t’i vrasin ato. Puna me detyrim në një ambient të dhunshëm, jeta nën frikën e përhershme të arrestimit dhe kthimit në vendin e tyre, kërcënimet direkte për to dhe familjet e tyre, rrahjet dhe vrasjet nga grupet kriminale, shkaktojnë dëmtime të rënda psikologjike. Shumë viktima të trafikimit, të asistuar nga

5 Kjo e dhënë bazohet në moshën mesatare të vajzave dhe grave kosovare të trafikuar, të asistuar nga zyra e IOM-it në Kosovë, nga viti 2001 deri në qershor të vitit 2005.

IOM, kanë pohuar se përvoja e trafikimit i ka ndryshuar ato krejtësisht. Pas përvojave të tilla ato kanë nevojë për kujdes dhe trajtim psikiatrik apo psikologjik të vazhdueshëm.

Ndërsa trafikantët dhe shfrytëzuesit e vajzave dhe grave, pavarësisht se mundohen të paraqiten si njerëz “të zotë” e “të aftë”, janë në kërkim nga policia, rrezikojnë burgimin, konsiderohen si njerëz të “pazotë”, që nuk janë të aftë të bëjnë asnjë lloj pune tjetër dhe “merren me femra”, si “imoralë” deri në atë shkallë sa nxjerrin në rrugë vajzën me të cilën janë fejuar apo martuar etj.

1. 2 Përkufizime dhe Terminologji

• Trafikimi

Siç u tha dhe më lart, Neni 3 i Protokollit të OKB-së për Trafikimin, e përcakton Trafikimin si më poshtë:

Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës, ose formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të dredhisë, të mashtrimit, të abuzimit të pushtetit, ose të një pozite vulnerabiliteti, ose i dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi, duke pasur kontrollin mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin në minimum, shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, zgjedhë apo heqje organesh.

Ky përkufizim, i dhënë në Protokollin e Trafikimit, ka shumë aspekte pozitive që reflektojnë realitetin e trafikimit të kohëve moderne:

- Ky përkufizim njeh të gjitha format e trafikimit dhe nuk e kufizon trafikimin vetëm në shërbimet seksuale. Ai fokusohet në kushtet e punës së detyruar, zgjedhës, praktikave skllavëruese dhe skllavërisë, që janë të përcaktuara në ligjin ndërkombëtar;
- Nuk fokusohet vetëm tek vajzat dhe gratë në mënyrë ekskluzive, por dallon që gratë, burrat, vajzat, dhe djemtë mund të jenë të gjithë viktimat;
- Nuk kërkon që viktimat të kalojnë ndonjë kufi ndërkombëtar të përcaktuar, duke marrë parasysh që personat gjithashtu trafikohen nga një zonë në tjetrën, brenda të njëjtit vend;
- Protokolli kërkon të dënohen disa forma të shtrembërimit të vullnetit të lirë të viktimës, p.sh., me anë të përdorimit të forcës, mashtrimit ose abuzimit me pushtetin, duke respektuar kështu aftësinë e personave të rritur për të marrë vetë vendime për jetën e tyre, veçanërisht në lidhje me zgjedhjet për punën dhe emigracionin.

• Trafikanti

Një person, ose një bashkësi personash, që kanë për qëllim të kryejnë, të bashkëpunojnë apo të japin pëlqimin për çdo një nga aktet që përshkruhen në trafikim (Aleanca Globale Kundër Trafikeve të Grave - GAATW, Standartet e të Drejtave të Njeriut për Trajtimin e Personave të Trafikuar, Janar 1999).

• Personi i trafikuar

Një person që është rekrutuar, transportuar, shitur, blerë, transferuar, pritur ose strehuar, siç përshkruhet në përkufizimin e trafikimit, duke përfshirë edhe një fëmijë, pavarësisht nëse fëmija ka pranuar ose jo (Aleanca Globale Kundër Trafikimit të Grave - GAATW, Standartet e të Drejtave të Njeriut për Trajtimin e Personave të Trafikuar, Janar 1999).

• Viktima

Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit me Pushtetin jep një katalog që përshkruan parimet bazë për viktimat e krimit, përsa i përket të drejtës për drejtësi dhe trajtim të drejtë, rikthim, kompensim dhe asistencë. Kjo Deklaratë u miratua me konsensus në Asamblenë e Përgjithshme në vitin 1985, duke reflektuar kështu vullnetin kolektiv të komunitetit ndërkombëtar për të vendosur balancën ndërmjet të drejtave themelore të të dyshuarve, të keqbërësve dhe të drejtat dhe interesat e viktimave. Ajo bazohet në filozofinë që viktimat duhet të dallohet në mënyrë të saktë dhe të trajtohet me respekt për dinjitetin e tyre. Deklarata e përkufizon viktimën si mëposhtë:

Personat, që në mënyrë individuale ose kolektive, kanë vuajtur dëme, duke përfshirë dëmtime mendore apo fizike, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose një shkelje të rëndë të të drejtave të tyre bazë, përmes veprimeve ose mosveprimeve që janë në kundërshtim me ligjet në fuqi të Shteteve Anëtare, duke përfshirë edhe ato ligje që ndalojnë abuzimin kriminal me pushtetin.

Ky përkufizim, gjithashtu, përfshin personat e trafikuar që shpesh vuajnë të gjitha pasojat e përmendura më lart. Një person mund të konsiderohet viktimë sipas kësaj deklarate, pavarësisht nëse autori është identifikuar, kapur, proceduar penalisht apo dënuar. Aty ku është i duhur, termi “viktimë” përfshin gjithashtu anëtarët direkt të familjes ose të varurit nga viktimat, si dhe “personat që kanë vuajtur dëme në ndërhyrjen për të asistuar viktimat në dëshpërim, apo për të parandaluar viktimizimin”, të tilla si Organizata, punonjës socialë, etj. Klauzolat përbërëse duhet të jenë të aplikueshme për të gjithë personat, pa dallime të ndonjë lloji, të tilla si race, ngjyrë, gjini, gjuhë, kombësi, lindje apo status familjar, origjinë etnike apo sociale.

• Shfrytëzimi

Shfrytëzimi përfshin, por nuk kufizohet, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve apo punës së detyruar, skllavërisë apo praktikave të ngjashme me skllavërinë, zgjedhën ose heqjen e organeve. Kjo mund të përfshijë gjithashtu abuzimet me pushtetin që nuk konsiderohet zyrtar, të tillë si shtatëzania me detyrim, adoptimi i paligjshëm, martesat me forcë dhe të jashtëligjshme,

si dhe lidhjet e borxhit. Shfrytëzimi gjithashtu përfshin të gjitha aktet që i shtohen dhe që janë bashkëfajtorë me trafikimin, duke përfshirë korrupsionin, konspiracionin, si dhe prostitucionin vullnetar vetëm nëse është kthyer në trafikim nëpërmjet mashtrimit, detyrimit me forcë apo abuzimit. Nuk duhet harruar që vulnerabiliteti mund të përfshijë gjithashtu faktin që viktimat beson që nuk kishte ndonjë alternative të arsyeshme përveçse të nënshtrohej.

- **Skllavëria**

Akti i Skllavërisë, Neni 1, e përcakton skllavërinë si “statusin apo gjendjen e një personi mbi të cilin ushtrohen të gjitha apo ndonjë nga kompetencat që kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë.” Praktikën skllavëruese përfshijnë skllavërinë me anë të borxhit, punën e detyruar për tjetrin, martesat skllavëruese dhe punën e fëmijëve”.

- **1.2.1 Ndryshimi ndërmjet Prostitucionit dhe Trafikimit**

Ka një problem të identifikimit ose, thënë ndryshe, egziston problemi i sqarimit të pamjaftueshëm të trafikimit të grave dhe vajzave nga fenomeni i përgjithshëm i prostitucionit. Nga kjo, lind nevoja për një përcaktim më të qartë dhe një njohje të elementeve që bëjnë ndryshimin e trafikimit të qenieve njerëzore, pikërisht trafikimin e grave dhe vajzave, nga fenomeni i prostitucionit. Dhënia me dëshirë e trupit dhe e shërbimeve seksuale, për një kompensim të caktuar material, është një karakteristikë domethënëse në përcaktimin e ndryshimit ndërmjet këtyre dy fenomeneve.

Kjo dëshirë në prostitucion dallohet nga zotërimi i mundësive për të marrë një vendim individual për ndalimin e këtij aktiviteti nga vetë prostitutat, d.m.th. kur të dëshirojnë dhe të vendosin ato, pavarësisht nga problemet ekonomike që veprojnë mbi to. Në trafikimin e qenieve njerëzore një mundësi e tillë thjesht nuk ekziston për gratë dhe vajzat e tregtuara d.m.th. për viktimat.

Ato kanë një sistem varësie të vendosur mbi to. Ky është një sistem i tërë i përbërë prej kërcënimit, përdorimit të dhunës psikologjike dhe fizike, të mashtrimit, të shkatërrimit mendor dhe fizik, lidhjet e borxhit dhe ngandonjëherë edhe raste vrasje, si shembuj për të tjerat. Ky lloj sistemi e bën viktimën të paaftë të çlirojë vetveten nga ky rreth i pamëshirshëm varësie, shfrytëzimi seksual dhe skllavërie.

Elementet e skllavërisë, të zgjedhës, të shfrytëzimit, të kontrollit, të realizuara nëpërmjet mjeteve çnjerëzore, të tilla si forca, detyrimi, mashtrimi, dhuna, kërcënim për jetën, deri tek gjymtimi e vrasja, tregojnë fare mirë se në çfarë gjendjeje janë këto viktimat kur bien në kontakt me policinë.

Askush nuk ka të drejtë që t'i paragjykojë dhe trajtojë viktimat e trafikimit si prostituta me dëshirë. Konceptet e vlerësimit të ulët për viktimën e trafikimit, të menduarit se ato shkojnë me dëshirë në shtëpi publike apo trotuare, se ato marrin para etj., janë koncepte të gabuara dhe paragjyquese. Faktet që do të përmendim, si dhe shumë fakte të tjera, do të ishin argumentet më të mirë për të çrrënjësuar njëherë e mire koncepte të tilla të gabuara.

• Fakte dhe Statistika

Gjatë periudhës janar 2000- dhjetor 2005, IOM ka asistuar në riintegrimin e 58 vajzave dhe grave kosovare, si dhe të 426 vajzave dhe grave të huaja të trafikuar në Kosovë. Shumica e viktimave me origjinë kosovare (89.65%) janë trafikuar për shfrytëzim seksual, por egziston edhe një numër i rasteve të raportuara të trafikimit për shfrytëzim për punë të detyruar (6.9%), dhe për kërkim lëmoshe/vjedhje (3.45%).

QËLLIMI I SHFRYTËZIMIT TË VIKTIMAVE KOSOVARE

Qëllimi i shfrytëzimit	Seksual	Kërkim lëmoshe/ Vjedhje	Punë e detyruar	Totali
Numri total i rasteve të asistuar	52	2	4	58

Në tabelën në vijim është dhënë numri i vajzave dhe grave kosovare të trafikuar që kanë kërkuar ndihmë pranë IOM-it, sipas grup moshës.

NDARJA SIPAS GRUPMOSHËS SË RASTEVE TË ASISTUARA KOSOVARE

Grup moshë	12-15	16-18	Fëmijë	19-22	23+	Nr. total rasteve
Numri total i rasteve të asistuar	9	26	35	13	10	58

Shënim: Shumica e rasteve (35) apo (60.34 %) janë nën moshën 18 vjeçe.

Vajzat dhe gratë e trafikuar kosovare, të cilat janë ndihmuar nga IOM-i, janë zakonisht nga zonat rurale (64.34 %), por një numër i rasteve vijnë edhe nga zonat urbane (39.66%). Nga të gjitha rastet e ndihmuara nga IOM, (44.83%) tregojnë të jenë joshur nga ofertat për punë dhe më pas janë shfrytëzuar, (9.44%) janë joshur nga premtimet për martesë, (15.52%) janë mashtruar nëpërmjet arranzhimeve të rrejshme të udhëtimit jashtë vendit, e edhe me tronditës është fakti që 27.59% janë rrëmbyer.

KATEGORIA SOCIALE E RASTEVE TË ASISTUARA

	Rurale	Urbane	Totali
Numri total i rasteve të asistuar	35	23	58

Më shumë se gjysma (39 apo 67.24%) e vajzave dhe grave të trafikuar që janë ndihmuar nga IOM, janë trafikuar brenda Kosovës; të zhvendosura nga një fshat apo qytet në tjetrin. Por ka raste që janë trafikuar edhe jashtë Kosovës. Numri më i madh i tyre është në IRJ të Maqedonisë, Itali dhe Shqipëri. Në tabelën në vijim ju do të gjeni shtetet në të cilat janë trafikuar vajzat dhe gratë kosovare si dhe numrin e tyre.

VENDET E DESTINACIONIT PËR VIKTIMAT KOSOVARE TË TRAFIKIMIT

Vendet e destinacionit	Numri i rasteve të asistuara
IRJ e Maqedonisë	8
Itali	4
Shqipëri	3
Britania e Madhe	1
Zvicër	1
Gjermani	1
Belgjikë	1
Numri total	19

Përsa i përket nivelit të tyre të arsimimit, qoftë nga zonat rurale apo urbane, shumica e viktimave të trafikuar kosovare (68.52%), të asistuar nga IOM-i kanë mbaruar shkollën 8-vjeçare. Është e rëndësishme të thuhet që 6.12 % prej tyre nuk kanë qenë asnjëherë në shkollë. Vetëm 8.7% kanë përfunduar disa klasë të shkollës së mesme dhe është vetëm një rast që për një kohë ka vijuar arsimin e lartë.

NIVELI I ARSIMIMIT TË VIKTIMAVE KOSOVARE TË TRAFIKIMIT

Niveli i arsimimit	Pa arsimim	Shkollë të ulët I-rë – V-të klasa	Shkollë të ulët VI-të – VIII-të klasa	Shkollë të mesme IX-të – XII-të klasa	Shkollë të lartë	Numri total
Numri total i rasteve të asistuar	5	12	37	3	1	5

Nëse kemi parasysh rrethanat familjare është e qartë që viktimat e trafikimit vijnë nga grupet më të dobëta të shoqërisë. Shpesh familjet e tyre janë jo funksionale dhe ndërkohë viktimat ka përjetuar dhunë familjare apo dhunë seksuale si pasojë e varfërisë ekonomike, arsimimit të ulët apo edhe vlerave tradicionale. Rrethanat e tilla janë faktorë që ndikojnë në rritjen e cenueshmërisë së një personi për t'u trafikuar/shfrytëzuar, si dhe vështirësojnë riintegrimin në shoqëri.

• **Fakte:**

- Një fëmijë nuk mund të quhet në asnjë mënyrë apo rrethanë prostitute me dëshirë.
- Të qenurit naëve, të mashtruesh nga premtimet dinake apo nga imazhi i një jete më të mirë përtej kufijve, nuk do të thotë aspak të shkosh të punosh si prostitutë me dëshirë.
- Një vajzë e rrëmbyer nuk mund të jetë kurrë një prostitutë me dëshirë;
- Një jetime, për të cilën nuk kujdesen mekanizmat vendore, dhe që mbetet pa mbështetje e shfrytëzohet nga trafikantët, nuk mund të quhet kurrë një prostitutë me dëshirë;
- Të hollat e fituara nga gratë dhe vajzat e trafikuar, përvetësohen nga tutorët e tyre.

• 1.2.2 Ndryshimi midis Kontrabandimit të njerëzve dhe Trafikimit të tyre

Termi kontrabandë do të thotë përdorim direkt i shërbimeve të ndërmjetësit, që ka të bëjë me organizimin dhe kalimin e kufijëve ndërkombëtarë, duke evituar kontrollin e policisë kufitare dhe të doganave.

Neni 3 i Protokollit kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar e përkufizon kontrabandimin si: Ndërmjetësimi për të futur në mënyrë të paligjshme një person në një shtet në të cilin personi nuk është shtetas ose me qëndrim të përhershëm, me qëllim të një përfitimi financiar ose përfitimi tjetër material.

Kontrabandimi dallohet nga trafikimi në atë që kontrabandimi i të huajve përfshin sigurimin e një shërbimi, megjithëse të paligjshëm, për njerëz që me ndërgjegje blejnë shërbimin në mënyrë që të hyjnë në një shtet të huaj.

Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë edhe pa kaluar ndonjë kufi ndërkombëtar. Përveç kësaj, një emigrant i kontrabanduar zakonisht dëshiron që ta çojnë përtej kufirit dhe mund të heqë dorë nga ky qëllim në çdo kohë. Viktimës së trafikimit nuk i lihet në dorë të bëjë zgjedhje.

Por, kontrabandimi i njerëzve gati gjithmonë përfaqëson një pjesë të veprimeve, të lidhura me krimin e trafikut të qenieve njerëzore (dhe lehtësisht mund të konvertohet në trafikim), ku si elemente bazë për të vlerësuar, është ekzistenca e paramendimit (dolus directus - qëllimshmëri direkte), ose edhe produkti i paramendimit, ajo që rezulton në fund (dolus eventualis - qëllimshmëri sipas rastit), për qëllimin final, shfrytëzimin, në këtë rast, shfrytëzimin seksual ose forma të tjera të shfrytëzimit.

Çdo lloj aktiviteti i kontrabandimit të qenieve njerëzore, veçanërisht grave, vajzave dhe fëmijëve, duke marrë parasysh mundësinë e abuzimit me to për shfrytëzim dhe prostitucion të detyruar, konsiderohet si trafikim.

• 1.2.3 Emigracioni jo i rregullt dhe pasojat e tij

Emigracioni ilegal dhe pasojat e tij kryesisht lidhen me çështje të tilla si:

- Mënyrat dhe format e realizimit. Shpesh këto forma dhe mënyra rezultojnë të rrezikshme për shëndetin dhe jetën, me probleme për statusin ligjor të individit në një vend të caktuar, me shkelje të të drejtave bazë të njeriut, me aksidente, etj;
- Llojet e punës që do të kryhen në vendet e destinacionit. Shpesh ka një zhgënjim të personave që emigrojnë ilegalisht për sa i përket punëve që kanë menduar apo ëndërruar dhe problemeve që ndeshin mbi punësimin, si pasojë e statusit të tyre si emigrant i paligjshëm;
- Kriminalizimi si pasojë e ligjit në vendin e destinacionit. Kjo ka të bëjë me procedurat e deportimit, apo sanksioneve të tjera ligjore si pasojë e mungesës së dokumentacionit të ligjshëm për punë dhe qëndrim;
- Shfrytëzimi në punë. Kjo ka lidhje me përfitimin ndaj emigrantëve të paligjshëm si pasojë e mungesës së sigurimeve, mungesës së të drejtave, apo gjithë ligjshmërisë që mbron punëtorët në punë;
- Të qenit në pozitë të vështirë si pasojë e mungesës së dokumentave, etj.

1.3 Fazat e Procesit të Trafikimit

• 1.3.1 Hyrja në proces në vendin e origjinës

Njerëzit që trafikohen nuk i kërkojnë shërbimet e trafikantëve, trafikantët u afrohen atyre. Mjetet, me anë të të cilave viktimat rekrutohen, janë përmes rrëmbimeve, mashtrimit, martesave ose fejesave false, që çojnë në detyrimin për prostitucion. Në disa raste, viktimat mund të kenë një ide për llojin e punës që do të detyrohen të bëjnë, por nuk i njohin kushtet. Çështja nëse një person është detyruar apo jo, ose ka pranuar në mënyrë vullnetare, shpjegohet me konsiderimin dhe referimin ndaj tyre si të trafikuar ose të kontrabanduar. Personat e trafikuar joshen me premtime false, gënjehen dhe keqinformohen përsa i përket rregullave të migracionit, ose shtyhen nga dëshpërimi ekonomik apo dhuna në shkallë të lartë. Megjithatë, në të gjitha rastet, abuzimet e rënda me të drejtat e njeriut, që pësojnë njerëzit në duart e trafikantëve, në mënyrë të qartë tregojnë që viktimat kanë nevojë për mbeshtetje dhe mbrojtje të veçantë. Në rastin e trafikimit, shkeljet më të shpeshta të të drejtave të njeriut janë ato që kanë të bëjnë me:

- Të gjithë qeniet njerëzore kanë lindur të lirë (Neni 1 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; 1948);
- Gjithsecili i gëzon të drejtat dhe liritë e shprehura në këtë deklaratë (Neni 2 UDHR);
- Gjithsecili ka të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë së personit; (Neni 3 UDHR);
- Askush nuk mund të mbahet në skllavëri, apo për ta përdorur; skllavëria dhe tregtia e skllavëve duhet të ndalohet në të gjitha format. (Neni 4 UDHR);
- Askush nuk duhet ti nënshtrohet torturës. (Neni 5 UDHR).

• 1.3.2 Udhëtimi

Viktimat e trafikimit dhe kontrabandimit mund të vuajnë nga abuzimet me të drejtat e njeriut gjatë udhëtimit të tyre, i cili mund ose mund të mos jetë përmes kalimit të kufinjve ndërkombëtarë. Shumë viktimat nuk kanë qenë kurrë jashtë shtetit të tyre të origjinës dhe janë plotësisht të varur nga trafikantët. Disa prej tyre largohen nga vendi i tyre pa ndonjë pasaportë ndërkombëtare, sepse u thuhet që nuk ka nevojë për një të tillë ose se do t'i pajisin më vonë. Migrantët shpesh nuk informohen ose gënjehen për mënyrën se si ata do të transportohen. Në raste ekstreme, transporti mund të arrijë deri në skllavëri, kur trafikantët ushtrojnë pushtet dhe pronësi mbi viktimën. Personat që udhëtojnë në situata të paligjshme janë veçanërisht të prekshëm ndaj tekave të trafikantëve, të cilët e dinë fare mirë se statusi i paligjshëm i viktimës së trafikimit i bën këto të fundit që të mos përfitojnë nga mbrojtja e Policisë apo e Shtetit, sepse ose duhet të ndërpritet procesi, ose viktimat duhet të kërkojnë mbrojtje në mënyrë vullnetare.

• 1.3.3 Mbërritja në Vendin e Destinacionit

Vajzat dhe gratë, me të mbërritur në vendin e destinacionit, e gjejnë veten në një jetesë në kushte skllavërie, kryesisht si prostituta, por edhe si punëtore fabrikash apo shërbimesh shtëpie, si dhe në martesë të detyruara. Padronët, në shumicën e rasteve në mënyrë

të paligjshme, i mbyllin këto gra dhe vajza, i konfiskojnë pasaportat ose letërnjoftimet, i detyrojnë ato të punojnë me orë të zgjatura dhe në kushte çnjerëzore, të tilla si banesa të përbashkëta, të fjeturit në karrige, ushqim të pamjaftueshëm, kushte mjaft të këqia higjienike, seks të pambrojtur, etj. Ndihamë mjekësore u jepet vetëm në rastet kur preken fitimet. Shpesh ata i rrahin dhe i përdhunojnë ato dhe i mbajnë paratë deri sa të paguhet “ borxhi” i rekrutimit të tyre. Ndërkohë, frika nga raprezaljet dhe mungesa e letrave të identitetit i ndalojnë shumë prej tyre të shpëtojnë prej abuzimeve. Abuzimi konstant fizik, psikologjik dhe seksual i lënë viktimat pa alternativë.

1.4. Legjislacioni vendor lidhur me kundër-trafikimin e qenieve njerëzore

Kosova është e detyruar të respektojë marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare, marrëveshje, që janë përfshirë në legjislacionin e aplikueshëm sipas Kornizës Kushtetuese (Rregullorja 2001/9)⁶, duke përfshirë: Deklaratën Universale për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; Konventa mbi Eliminimin e Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave; Konventa për të Drejtat e Fëmijëve; dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

• 1.4.1 Konventa për të drejtat e fëmijëve (KDF)

Neni 35 i Konventës për të drejtat e fëmijëve - parashikon që: Shtetet palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumë palësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikimin e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Protokolli Opsional i KDF-së lidhur me shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve,

Neni 3 thotë:

1. Çdo shtet Palë do të sigurojë si minimum, që aktivitetet e poshtëshënuara të mbulohen tërësisht me ligjin e tij penal, pavarësisht nëse këto akte janë kryer në vend apo jashtë vendit, në mënyrë të organizuar apo jo:

Në kuptim të shitjes së fëmijëve, të definuar sipas nenit 2:

(i) Ofrimi, dhënia apo pranimi i fëmijës, përmes çfarëdo forme, me qëllim të:

- a. Shfrytëzimit seksual të fëmijës
- b. Transferimit të organeve të fëmijës me qëllim të përfitimit
- c. Angazhimit të fëmijës në punë me dhunë

(ii) Të bindurit, nga ana e ndërmjetësuesit/es, në mënyrë të parregullt për dhënien e pëlqimit lidhur me adoptimin e fëmijës, që paraqet shkelje të instrumenteve ligjore ndërkombëtare për adoptim;

- a. Ofrimi, marrja, prokurimi apo furnizimi me fëmijë për prostitucion, siç citohet në nenin 2.

⁶ Korniza kushtetuese e Institucioneve të Përkohshme Vetë-Qeverisëse të Kosovës: www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm

• 1.4.2 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës

Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, i cili hyri në fuqi më 6 Prill 2004, jep përcaktimin për trafikimin, që është i bazuar në Protokolin e Palermos.

Sipas Nenit 139, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës:

1. Shprehja “trafikim me njerëz” do të thotë rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave, me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me formë të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, abuzimit me pozitën, apo me pafuqishmërinë e pozitës së tjetrit, me anë të dhënies apo marrjes së pagesave për të arritur pëlqimin e personit për të pasur kontrollin mbi ndonjë person tjetër, për qëllime shfrytëzimi.
2. Shprehja “Shfrytëzim” (siç është përdorur në pikën 1 të këtij paragrafi) përfshin: shfrytëzimin për prostitucion të tjerëve, ose formë të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës së detyruar, të skllavërisë, apo praktikave të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose të heqjes së organeve.
3. “Pëlqimi” i viktimës së trafikuar për qëllime të shfrytëzimit, nuk merret parasysh kur egziston cilado prej mënyrave (të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, abuzimit me pozitën, apo me pafuqishmërinë e pozitës së tjetrit, me anë të dhënies apo marrjes së pagesave për të arritur pëlqimin e personit për të pasur kontrollin mbi ndonjë person tjetër, për qëllime shfrytëzimi) të parashtruara në pikën 1.
4. Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit konsiderohet “Trafikim me njerëz”, madje edhe nëse kjo nuk përfshin asnjë nga mjetet e parashtruara në pikën 1 (të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, abuzimit me pozitën, apo me pafuqishmërinë e pozitës së tjetrit, me anë të dhënies apo marrjes së pagesave për të arritur pëlqimin e personit për të pasur kontrollin mbi ndonjë person tjetër, për qëllime shfrytëzimi).

Neni 139 cakton edhe kohëzgjatjen e privimit nga liria, duke përfshirë këtu dënime të ashpra, në veçanti kur viktimat janë nën moshën 18 vjeçe.

- (1) Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçe, kryesi i veprës dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- (3) Kushdo që organizon një grup personash për të kryer vepra nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.
- (4) Kushdo, që nga pakujdesia, lehtëson kryerjen e trafikimit me njerëz dënohet me burgim prej gjashtë muajsh e deri në pesë vjet.
- (5) Kushdo që përdor ose siguron shërbime seksuale të një personi, duke pasur dijeni se personi i tillë është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim prej tre muajsh deri në pesë vjet.

- (6) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18 vjeçare, kryesi dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.
- (7) Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës, kryesi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjet vjet për veprën penale nga paragrafi 1 dhe 2, me burgim së paku prej 10 vjetësh për veprën penale nga paragrafi 3, me burgim prej pesë vjetësh deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 6.

1.5 Trafikimi në Kosovë

• 1.5.1 Profili i viktimës së trafikuar dhe shfrytëzuar

Sa më shumë që thellohet analiza e trafikimit, aq më shumë del në pah se procesi social dhe psikologjik i viktimizimit fillon shumë më herët se procesi i trafikimit. Viktima vjen e profilizohet me hershëm, saqë mund edhe të evidentohen dhe të adresohen nevojat e viktimave aktuale, por edhe atyre potenciale të trafikimit. Ky profil përvijohet si:

- Vlerësim i ulët për veten;
- Ndjenja ankthi;
- Ndjenjat e fajit;
- Ndjenja e braktisjes dhe frika nga braktisja në marrëdhëniet me të tjerët;
- Mungesa e besimit tek vetja dhe të tjerët;
- Marrëdhënie varësie;
- Pasiguria dhe mungesa e besimit tek të tjerët dhe tek vlerat njerëzore;
- Ndjenja e largimit dhe të qenit të huaj në ambientin përreth;
- Të ndjerët i paragjykuar apo frika prej paragjykimit;
- Ndjenjë paaftësie për të kontrolluar veten apo ambjentin;
- Paaftësi për të përfituar nga mundësitë që i jepen;
- Negativizëm në perspektivë;
- Paaftësi për të zhvilluar sjellje të reja;
- Konfuzion lidhur me marrëdhëniet ;
- Vështirësi në marrje dhe ekzekutim vendimesh.
- Ndjenjë pafuqishmërie për të ndryshuar vetveten.

- Konformizmi

Shumica e vajzave dhe grave që janë trafikuar, vijnë nga shtresa të ulëta social ekonomike apo grupe shoqërore të lëna në mjerim. Pamundësia ekonomike, izolimi, neglizhenca dhe abuzimi gjinor, i bazuar në paragjykime gjinore, rezulton me shkollimin e ulët, apo mungesë e plotë të shkollimit për këto vajza.

Këta faktorë, si dhe mungesa e strukturave dhe aktiviteteve, lë gjurmë të thella, sidomos në atë pjesë të grave dhe vajzave, të cilat e kërkojnë zgjidhjen apo shpëtimin në lidhje apo martesë të hershme apo në largime të rrezikshme të paplanifikuara, duke i dhënë një pozicion shoqëror që nuk përkon me moshën dhe zhvillimin e tyre.

Rezultantja në këtë rast është se ato në moshë të re (minorene) bëhen nëna dhe jetojnë e lëvizin në ambiente me ekspozim dhe rrezik të lartë dhune dhe abuzimi. Izolimi social dhe mungesa e informacionit është një karakteristikë tjetër e ambjentit të rritjes së këtyre vajzave. Ky izolim, i cili vazhdohet dhe strukturohet qëllimshëm nga trafikantët, kufizon dhe shtrembëron rrethin e njohjeve dhe mbështetjeve të mundshme shoqërore. Ndarja nga familja, realiteti dikur i dhunshëm prej trafikantëve dhe më pas mentaliteti dhe kërcënimet (edhe me vdekje) të të denoncuarve, i bëjnë këto vajza dhe gra të shkëputura dhe të paragjykuara shoqërisht. Varfëria ekonomike është një tjetër karakteristikë e profilit të këtyre vajzave. Ato jo vetëm që nuk kanë arritur të vënë nga puna asnjë lloj paraje apo pasurie mënjane, por shpesh tregojnë për situata në të cilat kanë punuar të uritura, janë pa banesa apo në banesa në kushte të mjerueshme.

Shpesh, janë rritur në ambiente familjare të çorganizuara, të cilat kanë dështuar në transmetimin e një sërë vlerash universale, besimesh e qëllimesh në jetë. Të shkëputura forcërisht prej këtyre vlerave e të detyruara ta konceptojnë veten si të paafta, pa kontroll mbi ambjentin dhe duke e parë vetë situatën si pa rrugëdalje, mund të rezultojë në ndjesinë që nuk ka arsye të vazhdojnë të jetojnë, gjë që mund të çojë (dhe shpesh ndodh) në tentativa për t'i dhënë fund jetës.

Profili fizik i tyre demonstroi që ato janë viktimë të dhunës së vazhdueshme (p.sh. thyerje kockash, plagë plumbi, thikash apo djegiesh cigareje etj.) dhe neglizhencës së tutorëve, dhunës së pësuar prej shfrytëzuesve të tyre dhe mosmarrjes së ndihmës mjekësore në kohën e duhur. Ato vuajnë shpesh nga sëmundjet gjenitale dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme, pësojnë shtatzani të padëshiruara dhe aborte të kryera në kushte të papërshtatshme, si pasojë e seksit të pambrojtur.

- **Roli i familjes** - Ambjenti familiar luan një rol të rëndësishëm si përpara, gjatë, ashtu edhe pas trafikimit. Në këtu do të përpiqemi të fokusohemi te roli i familjes para trafikimit dhe pamundësia apo moskryerja e roleve që vijojnë:

- **Ushqimi** - Rastet e vështirësive të punësimit janë të shpeshta në shoqërinë kosovare dhe e vështirësojnë shumë sigurimin e ushqimit për familjen; shpesh kryefamiljari (zakonisht babai) nuk mund të sigurojë të ardhura për të përmbushë nevojat e një familjes. Shkalla e papunësisë së përgjithshme është 54,3% (41,1% për meshkuj dhe 78,4% për femra)⁷, përderisa përqindja e papunësisë në mesin e të rinjve 15-19, është 85%.⁸ Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, shumë fëmijë detyrohen të punojnë në rrugë dhe shpesh

7 Zyra e statistikave në Kosovë (2004), Studimi demografik dhe shëndetësorë në Kosovë, fq. 46, Tabela 5.6

8 Zyra e statistikave në Kosovë (2004), Studimi demografik dhe shëndetësorë në Kosovë, fq. 46,

paralelisht vijojnë mësimin. Edhe pse ata shkojnë në shkollë, janë të stërngarkuar, meqë nuk kanë mundësi as të pushojnë si duhet, e as të mësojnë si duhet. Kushtet e punës, sidomos në zonat rurale, nga vijnë pjesa më e madhe e vajzave dhe grave të trafikuar, janë të vështira. Ato zakonisht bëjnë punë shtëpie apo bujqësie.

- **Krijimi i një ambjenti të sigurt fizik për rritjen e fëmijëve** - Varfëria dhe lëvizjet e shpeshta i vendosin fëmijët dhe vajzat adoleshente në kushte të pabanueshme, sëmundjesjellëse dhe të ekspozuar ndaj personave apo grupeve kriminale apo të dyshimta.

- **Edukimi** - Moskujdesi që fëmijët të mësojnë e të ndjekin rregullisht shkollën, është një nga mangësitë që mund të tregojë familja.

- **Dhënia e shprehive shoqërore dhe socializimi i fëmijëve** - Dhënia e shprehive sociale dhe futja e fëmijëve, e sidomos e vajzave, në rrethet shoqërore të ngushta me familjen e më gjerë, është e shpejtuar dhe më qëllime që bien ndesh mes prindërve e fëmijëve. Shumë prej vajzave kanë përfunduar në rrjetën e trafikimit, kryesisht sepse familja ka parë si rrugëzgjidhje martesën, ose e kanë sajuar atë pa marrë informacionet e duhura mbi personin, apo dhe duke fshehur informacione të dyshimta.

- **Krijimi i një ambienti të dashur dhe të ngrohtë** - Një ambient i ngrohtë dhe i dashur është i nevojshëm për zhvillim normal, intelektual dhe psikologjik. Ky ambient zgjon ndjenjën e përkatësisë, si dhe të qenurit të rëndësishëm, duke u bërë kështu shumë i domosdoshëm për fëmijën. Mungesa e këtij ambienti dëmton fëmijën dhe të ardhmen e tij. Shumë prej vajzave tregojnë se janë larguar prej shtëpive, sepse janë ndjerë të tepërta, të mosdashura, apo kanë qenë në mes të konflikteve mes prindërve të tyre.

• 1.5. 2 Trafikimi i fëmijëve⁹

Një faktor shqetësues është numri i fëmijëve të pashoqëruar, të cilët trafikohen për shfrytëzim seksual në Bashkimin Europian. Studimet tregojnë se shumica e fëmijëve të cilët vijnë nga struktura familjare, që janë shkatërruar si pasojë e papunësisë, të ardhurave të pakta dhe pasigurisë sociale, janë më të rrezikuarit. Veçanërisht të prekur janë fëmijët nga fshatrat, familjet e të cilëve ia besojnë vajzën atij që i ofron asaj një të ardhme të sigurt, pavarësisht se kjo mund të jetë thjesht joshje. Një tjetër kategori janë edhe fëmijët e familjeve Rome.

Kërkesat për seks të pambrojtur kanë nxitur edhe më shumë tregun për vajza të reja, meqë ato konsiderohen më pak të rrezikuara nga përhapja e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme apo të HIV/AIDS-it. Raportet theksojnë numrin e madh të fëmijëve të pashoqëruar, që shfrytëzohet nga bandat kriminale të organizuara, të cilët i përdorin ata si transportues droge apo si hajdutë, duke përfituar nga fakti se në rast se autoritetet kapin një minoren, ai/ajo do të përjashtohet nga procedurat penale, ose për të do të jenë më të lehta.

⁹ Fëmijë quhet çdo person nën moshën 18 vjeçe

2.1 Dhuna Gjinore

• 2.1.1 Çfarë është seksi dhe gjinia?

Seksi ka të bëjë me ndryshimet biologjike midis burrave e grave, ndërsa gjinia është një rol shoqëror, i ndërtuar apo i krijuar nga shoqëria për burrat e gratë. Njerëzit nuk lindin në role gjinore të përcaktuara, ato janë krijuar me kohë nga shoqëria në varësi të kushteve shoqërore e ekonomike. Duke qenë se rolet gjinore janë stereotipe të krijuara nga shoqëria, ato mund të sfidohen për të siguruar që të gjitha të drejtat të jenë të garantuara për gratë dhe burrat, në një mënyrë të barabartë. Si në shumë shoqëri të tjera, shoqëria kosovare siguron një ekuilibër jo të barabartë të pushtetit politik e mundësive ekonomike për burrat e gratë, duke i kufizuar gratë në ushtrimin e të drejtave të tyre, njësoj si dhe burrat.

Seks apo gjini (Quiz)

1. Gratë lindin fëmijë, kurse burrat jo. Seks/Gjini (S/GJ)
2. Vajzat e vogla janë të sjellshme dhe të ndrojtura; djemtë janë të ashpër dhe aventurierë. S/GJ
3. Në shumë vende, gratë fitojnë 70% të asaj që fitojnë burrat. S/GJ
4. Gratë mund të ushqejnë me gji fëmijët, burrat përdorin shishet me qumësht për të ushqyer fëmijët. S/GJ
5. Gratë merren me rritjen e fëmijëve. S/GJ
6. Burrat marrin vendime. S/GJ
7. Në Egjiptin e Lashtë, burrat qëndronin në shtëpi dhe merreshin me endje, ndërsa gratë merreshin me biznesin e familjes. Gratë trashëgonin pronë ndërsa burrat jo. S/GJ
8. Djemve u ndryshon zëri në moshën e pubertetit, ndërsa vajzave jo. S/GJ
9. Në bazë të statistikave të Kombeve të Bashkara, gratë bëjnë 67% të punëve në botë, megjithatë fitimet e tyre zënë vetëm 10% të të ardhurave në botë. S/GJ
10. Gratë interesohen për nivelin e edukimit të fëmijëve të tyre. S/GJ
11. Gratë janë të ndaluara të punojnë në punë të rrezikshme të tilla si në minierë; burrat punojnë duke rrezikuar veten. S/GJ

• 2.1.2 Dimensioni i gjinisë përballë të drejtave

Siç është cekur më herët, Kosova është e detyruar të respektojë konventat e ndryshme ndërkombëtare, si dhe Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), e përfshirë në legjislacionin e aplikueshëm sipas Kornizës Kushtetuese (Rregullorja 2001/9);

Neni 1 i CEDAW thotë:

Mbështetur në qëllimin e konventës së tanishme, termi: “diskriminim ndaj grave” do të thotë çdo diskriminim, përjashtim apo kufizim i bërë në bazë seksi, efekti apo qëllimi i së cilës është të pengojë apo të mohojë njohjen, gëzimin apo ushtrimin nga gratë,

pavarësisht se janë të martuara, në bazë të barazisë të burrave e grave, të të drejtave njerëzore dhe lirive thelbësore në fushën ekonomike, sociale, civile apo të ndonjë fushë tjetër.

Neni 5 i CEDAW thotë:

Institucionet shtetërore duhet të marrin të gjithë masat e duhura për të modifikuar gjithë modelet e sjelljes shoqërore dhe kulturore të burrave dhe grave, me qëllimin për të eliminuar paragjykimet dhe sjelljet kanunore, si dhe gjithë praktikën e tjera, të cilat bazohen mbi idenë e inferioritetit apo të superioritetit të ndonjë prej seksëve, apo mbi rolet stereotipe të krijuara për burra apo për gra.

Instrumentet Ndërkombëtare dhe Korniza Kushtetuese e Kosovës (Rregullorja 2001/09) janë instrumente ligjore, të cilat njohin dallimet në mes të seksit dhe gjinisë, dhe kërkojnë vendosjen e barazisë në mes të burrave dhe grave si e drejtë themelore e njeriut.

2.2 Dhuna në Familje

• 2.2.1 Përkufizimi i “Dhunës në familje”

“Dhuna në familje është raporti i abuzimit dhe i kontrollit, i ushtruar nga një person në një marrëdhënie ndaj një tjetri”. Fjala “abuzim” i referohet dhunës fizike, seksuale, kërcënimeve psikologjike, fyerjeve, izolimit, sulmeve verbale dhe atyre ndaj pronës. Dhuna familjare mund të ndodhë në çdo marrëdhënie, viktimë mund të jetë si grua, ashtu edhe burrë, por në pjesën më të madhe viktimat e dhunës familjare janë gratë. Si pasojë e mungesës së dijenisë mbi natyrën e vërtetë të dhunës familjare dhe shfaqjeve të ndryshme të saj, mitet e mëposhtme ekzistojnë në përgjithësi në Kosovë:

- Dhuna familjare nuk është një problem serioz social;
- Probleme të tilla ndodhin vetëm në shtresën e ulët social-ekonomike;
- Gratë kanë bërë ndonjë gabim dhe kjo është arsya e ushtrimit të dhunës ndaj tyre;
- Nëse gratë janë në një marrëdhënie të tillë të dhunshme, nuk duhet të jetë e vështirë për to për tu larguar;
- Pendesa e keqardhja nga ana e burrit tregon se ai ka ndryshuar;
- Degradimi në dhunë fizike është vetëm një humbje durimi e momentit.

2.3. Llojet e dhunës familjare

Në një kuptim më të gjërë, dhuna familjare nuk është e kufizuar vetëm me rrahjen e bashkëshortes, siç mendohet zakonisht. Ajo mund të marrë trajta e forma të ndryshme, siç janë:

• 2.3.1 Dhuna Fizike

Abuzimi fizik mund të jetë: shuplaka, rrahja, përndrydhja e krahut, gjuajtja, shtrëngimi në fyt, djegia, goditja, kërcënimi me një objekt, me armë, apo kërcënimi për vrasje. Përfshin gjithashtu mohimin e nevojave bazë njerëzore, siç janë ushqimi, gjumi, ndihma mjekësore,

si dhe çdo lloj akti dhune, të krijuara për të kontrolluar, bërë keq, dëmtuar apo sulmuar fizikisht partnerin.

• 2.3.2 Dhuna Psikologjike

Abuzimi psikologjik përfshin sjellje që synojnë frikësimin dhe persekutimin dhe merr formën e kërcënimeve, braktisjes apo abuzimit, mbylljes në shtëpi, mbajtjes nën kontroll, kërcënime për t'i marrë fëmijët, shkatërrim të pronës, izolim, privim, agresion verbal dhe poshtërime të vazhdueshme. Kjo dhunë ka për synim të degradojë, poshtërojë dhe të përlulë në publik apo privatisht viktimën.

• 2.3.3 Dhuna Ekonomike

Abuzimi ekonomik, që përfshin veprime të tilla, si kontroll me anën e të ardhurave që sigurohen në familje, refuzim për të kontribuar financiarisht, mohim të nevojave për ushqim dhe nevojave të tjera bazë, kontroll i punësimit, etj. Viktima ka liri të kufizuar ose nuk ka fare, nuk ka kontroll mbi të ardhurat familjare, duke e detyruar atë të jetë e varur prej abuzuesit për para dhe mbijetesë.

• 2.3.4 Dhuna Seksuale

Abuzimi seksual shfaqet si seks me dhunë me anën e kërcënimit, frikësimit apo forcës fizike, kryerjes së marrëdhënieve seksuale me forcë, detyrimit për të kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirë, apo detyrimit të kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të tjerë, sulmi fizik ndaj pjesëve seksuale të trupit të gruas, ose bërja e komenteve seksuale përlulëse e poshtëruese. Kjo përfshin edhe çdo tentativë për të detyruar me forcë bashkëshorten të kryejë akte seksuale kundër dëshirës së saj.


• 2.3.5 Dhuna shoqërore

Izolimi shoqëror i forcuar ose kontrolli shoqëror, ku abuzuesi ndalon gruan e tij të ketë kontakte shoqërore, ose në mënyrë strikte kontrollon çdo kontakt me miq dhe/ose familjarë, kufizon atë që bën gruaja, me kë takohet, çfarë lexon, ku shkon, etj.

• 2.3.6 Cikli i Dhunës Familjare

Edhe pse në mënyrë të dukshme dhuna familjare ndodh papritur me ose pa provokim, ajo nuk është një veprim i izoluar dhe i pazakontë nga ana e abuzuesit apo ekzekutorit të dhunës. Ajo manifestohet me sjellje para e pas “incidentit”, siç shpjegohet më poshtë në ciklin e dhunës:

Janë gjashtë faza të ciklit të dhunës:



Faza përgatitore

Tensioni përgatitet brenda ekzekutorit për arsye të ndryshme (siç janë presionet familjare, streset e punës ose vetë rrjedha e mendimeve të tij). Sjellja e tij bëhet gjithnjë e më agresive dhe më e ashpër, pavarësisht sa fort viktima përpiqet ta qetësojë atë. Në disa raste, disa individë kanë një seri sjelljesh të ndryshme ndaj këtij tensioni, i cili mund të mos përfshijë përdorimin e dhunës, por në marrëdhënien abuzuese i lë vend fazës në pritje.

Faza në pritje

Gjatë kësaj faze, gruaja ndjen se është nën kontrollin e burrit të saj, si rrjedhojë e fuqisë së tij fizike dhe kërcënimeve të tij reale për ti bërë keq asaj. Sulmet e tij gojore do ta dobësojnë gruan më tepër.

Faza shpërthyese

Në këtë fazë, një shpërthim dhune ndodh nga ana e ekzekutorit, e cila bëhet zakonisht si një furi në vetvete e drejtë. Këto shpërthime kanë tendencë të shpeshtohen në kohë.

Faza e pendimit

Pas sulmit, bashkëshorti hyn në fazën e pendimit. Ai mund të ndihet i turpëruar, fajtor, ose dhe i frikesuar për pasojat. Megjithatë, ai zakonisht do të mohojë ose nënvlerësojë dhunën dhe do të refuzojë të marrë përgjegjësi për veprimet e tij. Ai mund të thotë se ajo është përgjegjëse për dhunën, pasi e provokoi atë, se ajo e meriton atë ose ai që jashtë kontrollit dhe nuk po kuptonte se çfarë po bënte. Për fat të keq, gruaja shpesh ka tendencë të besojë këtë “arsyetim”, për të ruajtur marrëdhënien.

Faza e ndjekjes

Nësë viktima largohet pas veprimit të dhunshëm, ai zakonisht do të përpiket t'i kthejë mendjen. Kjo është gjithashtu njohur si faza e blerjes mbrapsht, sepse ai do të përpiket të kthejë pas partneren e tij duke e mbushur me dhurata luksoze, duke u treguar i dashur dhe i vëmendshëm, dhe duke i premtuar se nuk do ta lëndojë përsëri. Ajo mund të kthehet duke besuar se ai ka ndryshuar. Nëse ajo vazhdon të refuzojë kthimin mbrapsht, ai mund

të përdorë kërcënime dhe më shumë dhunë. Ai mund të kërcënojë t'ia bëjë jetën tepër të vështirë për të, pavarësisht nga varfëria e tyre, gjendja financiare, fëmijët, të afërmit e të tjera. Kjo është periudha në të cilën ndodhin pjesa më e madhe e vrasjeve familjare. Nga ana tjetër, ai mund të bëhet si i pashpresë dhe se nuk mund t'ia dalë pa të dhe kërcënon me vetëvrasje, nëse ajo nuk kthehet. Shumë gra kthehen duke u ndjerë të kërkuara, ose sepse ato ndjejnë se duhet ta mbrojnë atë që të mos i bëjë keq vetes. Çifti kalon në fazën e muajit të mjalit.

Faza e muajit të mjalit

Nëse pajtimi ndodh, (duke vajtur kaq pranë ndarjes e shkatërrimit), çifti mund të përjetojë një eksperiencë tepër të fuqishme, marrëdhënie intime ku asnjëri nuk do të kujtojë dhimbjen e dhunës. Vështirësitë e mëparshme mohohen. Ai mund të jetë i komunikueshëm dhe i hapur ndaj nevojave të saj dhe ajo shpreson, ose beson, se ai ka ndryshuar. Për fat të keq, në marrëdhëniet e dhunshme, cikli vazhdon në mënyrë të paevitueshme, pasi çështja e kontrollit rishfaqet dhe marrëdhënia dobësohet akoma nën peshën rritëse të tensioneve.

Burrat e dhunshëm zakonisht ndihen plot pendesë, pas shpërthimit në dhunë, me qëllim që të arrijnë synimet e tyre. Megjithatë, pendesa e keqardhja nuk janë tregues të ndryshimit, as nuk nënkuptojnë se ai është i gatshëm të heqë dorë nga fuqia që ka brenda marrëdhënies. Ai mund të përpiqet të “blejë mbrapsht” partneren e tij pas një incidenti të dhunshëm, duke u treguar i dashur, i ndjeshëm, i komunikueshëm dhe lozonjar ndonjëherë. Kjo nuk do të thotë se ai ka ndryshuar. Cikli i dhunës shpjegon se pse gratë shpesh bashkohen me burrat e tyre, edhe pse kanë përjetuar dhunën nga duart e tyre. Gjatë fazave të Pendimit, Ndjekjes dhe Muajit të Mjalit, disa burra janë të suksesshëm për të bindur viktimat e tyre se ata kanë ndryshuar tashmë dhe gratë kanë tendencë ti besojnë ata. Megjithatë, duke parë se tendencat e dhunës në bashkëshortë të tillë qëndrojnë të fjetura, për t'u rishfaqur një herë tjetër, ata përsëri përfshihen në veprime dhune kundrejt grave të tyre. Si rrjedhojë, kur gra të tilla bëhen përsëri viktimë e denoncojnë rastin në polici, ato nuk merren seriozisht dhe oficerët e policisë nuk janë simpatizues me ankimet e tyre. Por nëse oficeret e policisë do të kuptojnë dinamikën e ciklit të dhunës, ata do të jenë në gjendje të sjellin një ndryshim pozitiv dhe proaktiv në sjelljen e tyre.

• 2.3.7. Efektet e Dhunës në Familje

• Ndikimi tek gratë

Nuk ka dyshim se viktimë e parë e dhunës në familje është gruaja. Studimet për këtë çështje tregojnë se gratë reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj dhunës në familje. Këto reagime varen nga niveli i arsimit, aftësia për të luftuar dhe mbrojtur veten, nga mbështetja që ka në familjen e saj, nga gjendja ekonomike, mbështetja nga fëmijët, informacioni që ajo ka për ekzistencën e shërbimeve sociale, etj.

Efektet fizike	Efektet mendore
Plagosje (nga prerje në frakturë, në dëmtim të organeve të brendshme)	Depresion Frikë
Shtatzani e padëshiruar	Ankth
Probleme gjinekologjike	Vetëvlerësim i ulët
Sëmundje si HIV/AIDS, IST	Keqfunksionim seksual
Dështim shtatzanie	Probleme oreksi
Sëmundje të legenit	Anomali nervore
Dhimbje kronike të legenit Gjymtim të përhershëm	Anomali stresi post-traume
Asma	
Sindroma të sëmundjeve të org. gjentiale	
Sjllje vetëdëmtuese (pirja e duhanit, seks i pambrojtur)	
Vetëvrasje	
Vrasje	
Vdekshmëri në lindje	

Burimi: Organizata Botërore e Shëndetësisë. Parandalimi i Dhunës dhe Dëmtimit: Dhuna ndaj Grave.

• Ndikimi tek fëmijët

Fëmijët preken nga dhuna, po aq sa dhe nënat e tyre, e disa herë edhe më tepër. Niveli i zhvillimit të tyre psikologjik nuk i lejon ata të kuptojnë gjendjen e dhimbshme në shtëpi. Fëmijët kanë role të rëndësishme në familje, si kujdesje për fëmijët më të vegjël, ata marrin përgjegjësinë për t'i bërë prindërit të lumtur e të bëjnë gjëra që ata të ndihen më mirë. Fëmijët ka shumë mundësi të ndërpresin kontaktet me miqtë e tyre të ngushtë, nga frika se mund të ndodhin incidente të dhunshme në praninë e tyre. Ata izoloohen në një moshë të re të jetës, duke rrezikuar kështu të largohen gjithnjë e më shumë nga shoqëria. Fëmijët e dhunuar ndodhen gjithashtu përballë dilemës që ta duan apo ta urrejnë personin e familjes që ushtron dhunë kundër tyre, apo nënës së tyre.

Fëmijët që rriten në një mjedis ku ushtrohet dhunë, ka shumë mundësi ta përdorin dhunën si metode për zgjidhjen e problemeve. Këta fëmijë shumë shpejt paraqesin vështirësi në procesin e të mësuarit, u mungon vëmendja, nuk studiojnë sa duhet dhe humbasin dëshirën për arsim.

Të jetosh me dhunën familjare mund të rëndojë pambarimisht jo vetëm mbi viktimën, por

edhe tek fëmijët e saj. Shkatërron personalitetet dhe zvogëlon kapacitetet e tyre. Fëmijët mund të përjetojnë shqetësime emocionale, fizike e në sjellje, siç janë:

• Efektet Emocionale

- Ndjenja inati, frike, turpi, konfuzioni, depresioni dhe pamundësie;
- Anomali gjumi siç janë pagjumësia, ankth në gjumë, urinim në shtrat etj;
- Disa humbin respektin për viktimën, disa të tjerë bëhen tepër mbrojtës ose të varur ndaj tyre;
- Stresi dhe sëmundje të lidhura me stresin, siç janë sindroma e stresit posttraumatike, atake frike, depresion, përdorim droge, nënvleftësim të vetvetes dhe incidente alarmuese të vetëvrasjeve e tentativave për vetëvrasje;
- Përpjekje me emocione konfliktuale. Ata janë konfuzë rreth faktit se si mund të duan dhe urrejnë në të njëjtën kohë. Këto ndjenja pamundësie dhe konfuzioni shpesh çojnë fëmijët të përpiqen të kopjojnë një strategji mohimi mbi dhunën që është duke ndodhur;
- Vuajtje të ndjenjës së fajit se dicka nuk shkon mirë me ta, ose se ata vetë janë përgjegjës për dhunën.

• Efektet në sjellje

- Disa bëhen të mbyllur e disa të tjerë agresivë në mënyrë të pazakontë.
- Disa kopjojnë agresivitetin që kanë parë tek baballarët e dhunshëm dhe të tjerë përdorin dhunën kur rriten.

• Efektet fizike

- Ftohje e shpeshtë, dhimbje koke apo acarime të stomakut.

Asnjë shoqëri nuk mund të quhet shoqëri e shëndoshë dhe asnjë komb nuk mund të bëjë përpara, nëse gjysma e popullsisë së tij nuk mund të bëjë një jetë normale, të lirë nga dhuna. Efektet e dhunës në mënyrë të qartë tregojnë se dhuna familjare është një problem serioz social dhe nuk mund të konsiderohet më thjeshtë si një problem privat.

• Pse Qëndrojnë Gratë me Burrat e Dhunshëm?

Një pyetje që është ngritur shpesh nga shumë njerëz, përfshirë dhe oficerët e policisë, është ajo se nëse gratë ndeshen me kaq shumë mizori dhe tirani, pse vazhdojnë të qëndrojnë me burrat e dhunshëm? Disa herë pyetja ka një grimasë sarkastike, pasi një numër i madh oficerësh policie besojnë se ankesat e grave ndaj burrave të tyre janë të ekzagjeruara dhe të momentit, pasi ato vazhdojnë të jetojnë ose bashkohen prapë pas disa intervalesh me burrat e dhunshëm. Por shpeshherë, thjesht është e vështirë për disa njerëz të kuptojnë pse grate, të cilat jetojnë në një marrëdhënie abuzive, nuk largohen prej saj.

Në fakt, ka shumë arsye, siç janë ato të varësisë financiare, fëmijët, mungesë mbështetje nga familja, e cila i ndalon gratë të marrin një hap të tillë. Oficerët e policisë kanë nevojë

ta kuptojnë këtë problem më mirë. Faktorë që detyrojnë gruan të jetojë me burrin e dhunshëm mund të jenë:

Varësia ekonomike. Ky faktor bën që viktimat të preokupohet rreth nevojave ekonomike, pasi ajo mendon “Kush do të më mbështesë mua dhe fëmijët”?

Çështja prindërore. Në një shoqëri patriarkale, prezenca e një burri në familje mund të jetë një burim sigurie kundër kërcënimeve dhe tundimeve që vijnë nga jashtë.

Presionet sociale e familjare. Presionet për të mbajtur familjen së bashku, gjithashtu detyrojnë viktimën të qëndrojë në një marrëdhënie të tillë.

Siguria. Frika e të qenit vetëm, ndjenja se ajo nuk do të jetë në gjendje të përballojë fëmijët dhe shtëpinë vetëm, detyron gjithashtu viktimën të durojë torturën e bërë nga burri.

Keqardhja. Ndjenja e keqardhjes dhe simpatisë për bashkëshortin, merr përparësi ndaj agonisë së saj dhe viktimat vendos të qëndrojë me një burrë të tillë.

Mohimi. Disa herë viktimat mohojnë ekzistencën e problemit vetë, duke besuar se “Nuk është dhe aq keq”.

Dashuria. Ndjenja e dashurisë për burrin mund të kapërcejë urrejtjen e viktimës kundër tij duke e bërë veten të besojë se “kur ai nuk abuzon, është tepër i dashur”.

Detyra. Ndjenja e përgjegjësisë dhe e detyrës ndaj bashkëshortit të tyre, i bën shumë gra të durojnë dhunën në shtëpi.

Faji. Abuzuesi fajëson viktimën për problemet martesore, duke thënë se është faji i saj se, ajo i shkakton këto probleme. Viktimat disa herë tentojnë të besojë atë.

Ndjenja e përgjegjësisë. Normat shoqërore thonë se është përgjegjësia e grave të mbajnë martesën së bashku emocionalisht dhe përgjegjësia e burrit është financiare. Ajo e beson këtë.

Turpi, qenia në pozitë të vështirë dhe poshtërimi. Ndjenja e turpit, e vënies në një pozitë të vështirë i detyron gratë të mos tregojnë problemet e tyre me miq dhe familjarë, duke qëndruar kështu në një marrëdhënie abuzive.

Identiteti. Në një shoqëri të dominuar nga meshkujt, shumë gra kanë nevojë për prezencën e një burri për t’u ndjerë të kompletuara dhe shoqërisht të pranueshme.

Optimizmi. Shpresa se gjërat do të përmirësohen pas një kohe, po ashtu i mban gratë që të vazhdojnë të rrinë me burrat e tyre të dhunshëm.

Qëndrimi fajësues ndaj vetes. Disa gra mund të kenë një qëndrim fajësues ndaj vetes dhe shfajësojnë sjelljen e burrave të tyre të dhunshëm, duke përgjithësuar se “duhet të jetë faji im”, “e meritoj”, “nuk do të gjej dikë më të mirë”.

Mosbesimi i të tjerëve. Ndjenja e pasivitetit dhe e paralizës, që fillon kur një grua është rrahur, përforcohet nga përgjigjia e familjes apo miqve të cilët injorojnë problemin, nuk besojnë se vërtet ka ndodhur, dhe/ose fajësojnë gruan.

Fenomeni Stokholm. Kur pengjet janë mbajtur për një kohë të gjatë nga pengmarrësit, ata fillojnë të identifikohen me vetë pengmarrësit. Në mënyrë të ngjashme, shumë femra viktimat

të dhunës familjare, mbahen në fakt si pengje nga burrat e tyre. Gra të tilla shfaqin këtë sindromë. Kur gruaja jeton në një terror/stres pa fund, ulet aftësia e tyre për të rezistuar. Ato bëhen konfuze, të lodhura dhe iu mungon energjia e nevojshme për të bërë ndryshime.

• 2.4. Familjet që nuk funksionojnë

Neglizhimi i fëmijëve si pasojë e madhësisë së familjes, si familje me shumë fëmijë, me shumë breza, apo të mbledhur bashkë si pasojë e emigracionit, është një nga fenomenet më të përhapura dhe më me jetëgjatësi e me pasojë trafikimin. Shumë prej vajzave vijnë nga familje të mëdha, ku koha, kujdesi dhe vëmendja janë detyrimisht të kufizuara e të pakta, për shkak të numrit të madh të anëtareve të familjes. Si pasojë, ato mbeten të pazhvilluara nga pikëpamja intelektuale, pa informacion, apo me informacion të gabuar, që marret shpesh nga bashkëmoshatarët apo nga fëmijë të tjerë brenda familjes. Si pasojë e këtij neglizhimi, fëmijët mund të afrohen me persona apo grupe shoqërore potencialisht të rrezikshme, apo që ushtrojnë dhunë të menjëherëshme mbi ta.

Shumë viktimat trafikimi vijnë nga familje të divorcuara, me konflikte, apo me marrëdhënie jashtëmartesore. Tek ato janë të shpeshta historitë e të qenit prezent në grindjet dhe rrahjet mes prindërve, duke u munduar t'i ndajnë apo të venë gjërat në vend. Në shumë raste jeta e tyre para trafikimit është kaluar sa në njërin shtëpi apo prind në tjetrin, nëpër të afërm të bezdisur, apo edhe në shtëpi fëmije.

Pasojat e atëhershme dhe të tanishme janë, siç është përmendur edhe më lart, ndjenjat e fajit dhe të përndësisë, agresiviteti ndaj vetes dhe të tjerëve, vështirësia në kontrollin e ndjenjave dhe prirja për t'u rifutur në marrëdhënie abuzive edhe vetë, për shkak të këtyre sjelljeve të mësuara. Në shumicën e rasteve, divorci apo ndarja shoqërohet me ushqyerje të qëllimshme të urrejtjes së fëmijës ndaj prindit tjetër, duke asgjësuar jo vetëm një gjysmë të rëndësishme mbështetje, kujdesi dhe dashurie, por edhe duke krijuar tek fëmija një negativizëm dhe mungesë fleksibiliteti të përjetshëm.

Edhe pse forma më e përhapur e abuzimit me fëmijët është ajo e abuzimit fizik, në disa raste viktimat e trafikimit raportojnë se janë abuzuar seksualisht prej babait, vëllait apo një personi shumë të afërt gjaku. Kjo ngjarje njihet si fillesa më e dallueshme e trafikimit, duke pasur si karakteristikë të parë sjellje dëshirën për të ndëshkuar veten, tentativa për vetëvrasje, dëmtime të njohjes dhe identitetit, mungesë besimi dhe ekuilibri, konfuzion dhe prishje të roleve dhe marrëdhënieve me prindin dhe fëmijët e tjerë, paaftësi për marrëdhënie të qëndrueshme joabuzive.

3.1 Roli i shkollës në transmetimin e vlerave tek nxënësit

Studimet tregojnë se përgjithësisht personave të trafikuar iu mungon respekti për veten dhe vlerat individuale, ndaj dhe shpesh depresionet dhe vetëvrasjet janë të pranishme në këto kontigjente njerëzish. Kështu që përpjekjet për krijimin e vlerave tek nxënësit, njohja e vlerave të vetes dhe respekti për veten konsiderohen si tepër të nevojshme, si në fushat e tjera të jetës, ashtu dhe për të përballur dhe kundërshtuar trafikimin e për të fituar luftën me të.

Vlerat, janë një sërë bindjesh të brendshme ose parimesh të sjelljes që pranohen nga individët ose grupet. Shkolla synon që, përmes veprimtarisë së saj, të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë dhe qartësojnë vlerat individuale dhe besimet, të jenë të ndjeshëm ndaj vlerave. Nxënësve u kërkohet të reflektojnë, imagjinojnë, dialogojnë, komunikojnë, krijojnë, shkruajnë mbi vlerat.

Çdo fushë kurrikulare mund të shërbejë për zbulimin dhe zhvillimin e vlerave dhe efekteve të tyre. Shumëllojshmëria e aktiviteteve për vlerat synon të përfshijë nxënësit në të menduarit rreth vlerave dhe përdorimit praktik të tyre, si dhe t'i ndihmojë ata të bien dakort me vlerat. Por nuk është mjaft që nxënësit të dëgjojnë rreth vlerave, ata duhet t'i eksperimentojnë ato në nivele të ndryshme, për t'i përvetësuar si duhet ato.

AKTIVITET

Tema: Vlerat njerëzore për një botë më të mirë

- Shtrohen për diskutim me nxënësit këto pyetje:

1. Ç'do të kërkonit që bota të ishte e pëlqyer?
2. Si do të dëshironit të ishte mjedisi?
3. Si do të dëshironit të ishin marrëdhëniet midis njerëzve?

- Mësuesi përgjithëson diskutimet e nxënësve duke nënvizuar se:

Të gjitha qeniet njerëzore, pa përjashtim, pavarësisht nga kultura dhe vendi nga vijnë, do të dëshironin një botë me paqe e dashuri, ku të jetohej në lumturi e shëndet të mirë, ku të mos kishte varfëri, luftë, dhunë, dhimbje dhe të gjithë të ishin të mbrojtur. Se të gjitha kulturat njerëzore ndajnë vlera universale, por ne nuk mund të jetojmë me vlerat tona, bota është kthyer në një vend të tmerrshëm për miliona njerëz, ka korrupsion, varfëri, dhunë etj. Janë njerëzit ata që krijojnë të mirën e të keqen. Njerëzit duhet të përpiqen për të bërë një botë më të mirë.

- Nxënësit marrin detyrën, shkruajnë disa cilësi dhe vlera që i shohin shumë të rëndësishme për njerëzit dhe veten.
- Mësuesi zgjedh për t'u ndalur dhe diskutuar njërën nga vlerat që nxënësit kanë shkruar si të rëndësishme. Ai u drejton këtë pyetje nxënësve:
- Si do të ndryshonte bota, në qoftë se të gjithë njerëzit do të shfaqnin vlerën në fjalë?
- Më tej, mësuesi kërkon nga nxënësit të kujtojnë disa momente të rëndësishme pozitive në jetën e tyre, duke u ndalur në vlerat që ata treguan në ato çaste dhe ndjesitë që përjetuan.

- Në fund nxënësit ndahen në grupe prej katër vetash dhe marrin detyrën:

Tema: Respekti

- Shtrohen këto pyetje për nxënësit:

1. Ç'është respekti?
2. Si do të ndjeheshit brenda vetes në qoftë se të gjithë do iu trajtonin me respekt?
3. Si mendoni se do ishte bota në qoftë se gjithsecili do të kishte respekt për mjedisin?
4. Si mendoni se do të ishte bota në qoftë se njerëzit të gjithë do të kishin respekt për njëri-tjetrin?

AKTIVITET

Ndahen nxënësit në grupe me katër nxënës. Udhëzohen grupet, që në një letër flipchart të ndarë në dy pjesë, të parashtrojnë mendimet e tyre për:

- Efekte që ka respekti ndërmjet njerëzve (në njërën nga gjysmat e flipchartit).
- Efekte që ka mungesa e respektit mes njerëzve (në gjysmën tjetër të flipchartit).

Në fund, secili grup prezanton idetë e tij rreth detyrës. Organizohet përsëri diskutim me nxënësit në lidhje me pyetjet që vijnë:

1. Çfarë gjërash në lidhje me respektin duhet të ndryshojnë në vendin tonë, shkollën tonë?
2. Shihni ndonjë lidhje të respektit ndërmjet njerëzve dhe trafikimit të qenieve njerëzore? Ç'do të ndodhte me dukurinë e trafikimit, nëse gjithë njerëzit do jetonin në respekt mes tyre?

Në mbyllje, komentohet nga të gjithë pjesëmarrësit thënia:

“Çdo njeri në botë ka të drejtë të jetojë me respekt dhe dinjitet, përfshirë edhe mua.”

Tema: Cilësitë e heronjve të mi

Përmes trajtimit të kësaj teme synohet të zërthehet më tej me nxënësit ideja se të respektosh do të thotë të dallosh cilësi pozitive tek vetja dhe individët e tjerë.

- Kërkohej nga nxënësit:
 - Të mendojnë rreth një personi, të cilin e admirojnë dhe të shkruajnë cilësitë për të cilat e respektojnë;
 - Të shkruajnë cilësitë që dallojnë tek shoku/shoqja i/e afërt për ta;
 - Të shkruajnë pesë cilësi që mendojnë se janë më të rëndësishme për një individ;
 - Të shkruajnë për cilësitë pozitive individuale, që ata mendojnë se i kanë;
 - Të mendojnë rreth heronjve që pëlqejnë dhe të shkruajnë për cilësitë pse ata i konsiderojnë heronj keto persona në sytë e tyre.
- Më tej, nxënësit listojnë me rradhë në dërrasë të gjitha cilësitë që kanë përmendur, për të organizuar rreth tyre ankandin e vlerave

AKTIVITET

Tema: Ankandi i vlerave

Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i thuhet se kanë në dispozicion nga 100 euro për të blerë një ndër cilësitë e shënuara në dërrasë. Nxënësit në secilin grup do të diskutojnë mes tyre, për të vendosur mbi cilësitë që ata i mendojnë si më të rëndësishmet për t'i pasur një individ dhe që ata dëshirojnë t'i blejnë me një çmim të caktuar. Më pas organizohet ankandi, ndodh që për një a më shumë cilësi do të ofrohen disa grupe, cilësia zotërohet nga grupi që ofron më shumë para. Grupi që e blen cilësinë vendos emrin në të. Për çdo cilësi të blerë, një nxënës nga grupi do të komentojë pse e konsiderojnë të rëndësishme. Mësuesi nënvizon, se njerëzit kanë individualitetet e tyre për vlerësimin e cilësive më të rëndësishme.

- Para nxënësve shtrohet kërkesa:

Të mendojnë dhe shkruajnë mbi cilësitë që i duhen një individ:

- a. për të mos u bërë viktimë e trafikimit;
- b. për të mos hyrë në rrjetin e trafikantëve.

Më pas organizohet diskutimi rreth mendimeve të nxënësve mbi cilësitë dhe trafikimin.

- Në mbyllje komentojnë nga pjesëmarrësit thëniet:

“Një pjesë e vetërespektit është njohja e cilësive të mia”.

“Respekti për veten siguron rritje të besimit në vete”.

Tema: Probleme të botës

- Me nxënësit organizohet një „stuhim mendimesh“ mbi “problemet e botës”. Nxënësit do të përmendin probleme të tilla, si: abuzimet, trafikimi, luftërat, varfëria, ndotja e

mjedisit, sëmundjet vdekjeprurëse etj. Problemet rradhiten dhe nxënësve u kërkohet të ndalen në problemet më kryesore.

- ❑ Nxënësit ndahen në 4 grupe. Secilit grup i jepet për të menduar, e më pas dhe për të diskutuar për një nga problemet e rradhitura më sipër (në këtë moment, përjashtohet problemi i trafikimit). Në udhëzimet mbi mënyrën e plotësimit të detyrës, mësuesi kërkon që nxënësit të përgjigjen për secilën nga çështjet e shënuara në tabelën që vijon:

Problemi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore	Faktorë që e shkaktojnë	Antivlerat në përgjigje të secilit faktor	Vlerat e nevojshme në vendimmarrjen për zgjidhjen e problemit
--	-------------------------	---	---

- ❑ Pas plotësimit të detyrës, nxënësit komentojnë rreth mendimeve të shprehura. Mësuesi udhëheq dhe drejton komentet, duke u ndalur dhe në faktorët e përbashkët për shkaqet dhe zgjidhjet e problemeve të ndryshme.
- ❑ Në vijim të gjitha grupet marrin detyrën të mendojnë dhe veprojnë në formën e mësipërme në lidhje me problemin e trafikimit të qenieve njerëzore. Tabela mund të plotësohet nga nxënësit si në shembullin e mëposhtëm:

Problemi	Faktorë që e shkaktojnë	Antivlerat në përgjigje të secilit faktor	Vlerat e nevojshme në vendimmarrjen për zgjidhjen e problemit
Trafikimi i qenieve njerëzore	-Varfëria e skajshme -Mungesa e informacionit. etj	-Mungesë e respektit për veten -Mungesë respekti për të tjerët etj.....	-Vlerësimi i vetes - Respekti për të tjerët etj.....

- ❑ Pasi grupet punojnë më vete, paraqesin me rradhë pikëpamjet rreth detyrës. Një tabelë sipas shembullit të mësipërm plotësohet me përgjigjet e tyre. Mësuesi mund të ndërhyjë për plotësime të nevojshme. Një grup nxënësish vullnetarë marrin përsipër ta shkruajnë në formë artistike këtë tabelë dhe ta vendosin në këndin e kundërtrafikimit në klasë, shkollë.

Tema: Mungesa e respektit për njerëzit e tjerë

- ❑ Mësimi nis me organizimin e diskutimeve të nxënësve për thëniet që vijnë:
 - “Kur kemi respekt për veten tonë, është e lehtë të kemi respekt dhe për të tjerët”
 - “Të njohësh vlerat natyrore të vetes dhe të nderosh vlerat e të tjerëve, është rruga e vërtetë në lindjen e respektit”
 - “Ata që tregojnë respekt do të jenë të respektuar”

❑ Në një fazë të dytë, organizohet diskutimi me nxënësit në lidhje me çështjen:

– Pse njerëzit shpesh tregojnë mungesë respekti ndaj njëri-tjetrit?

Nxënësit japin argumentat që mendojnë në lidhje me këtë pyetje, ndërkohë mësuesi duhet të nënvizojë se mungesa e respektit që një pjesë e njerëzve tregojnë për të tjerët, lidhet ngushtë si me mungesën e kulturës, injorancën e tyre, ashtu edhe me shpirtin e tyre bosh, ku mungon ndjenja fisnike e dashurisë e mbizotëron egoizmi dhe zemërimi.

AKTIVITET

Ndahen nxënësit në grupe të vogla pune për të diskutuar:

- Si do t'u pëlqente nxënësve që njerëzit të trajtonin njëri-tjetrin?
- Çfarë këshillash mendojnë nxënësit t'u japin njerëzve që sillen pa respekt me njerëzit e tjerë?

Mësuesi orienton nxënësit të paraqesin këshillat e tyre në një fletë dhe më pas t'i ekspozojnë në klasë ose shkollë.

Në përfundim, kërkohet nga nxënësit që të komentojnë mbi lidhjet midis trafikimit dhe mungesës së respektit. Diskutimi orientohet mbi pikat në vijim:

- Shkruani arsyet për të cilat ju gjykoni, se personat e përfshirë në rrjetin e trafikimit tregojnë mungesë respekti për njerëz të tjerë.
- Përshtuani veçoritë e individëve të përfshirë në rrjetin e trafikimit, si i mendojnë ose njohin nxënësit individë të tillë.
- Çfarë këshillash do t'u jepnit këtyre njerëzve?

Tema: Cilësitë e mia

- Diskutohet në klasë thënia:

“Respekti për veten nënkupton besim të rritur në vete”

AKTIVITET

Nxënësit vendosen në rreth. Atyre u kërkohet që secili të shkruajë emrin e tij në një letër format dhe t'i kalojnë këto letra tek njëri-tjetri. Nxënësit udhëzohen të shkruajnë një cilësi që ata mendojnë se ka shoku, letra me emrin e të cilit i ka rënë në dorë. Në fund letra kthehet tek personi, emrin e të cilit mban dhe secili nxënës lexon për cilësitë e tij.

Pas aktivitetit të mësipërm shtrohen para nxënësve pyetjet:

- ❑ Cilat janë ato mendime që ju ndihmojnë të forconi respektin për veten?
- ❑ Cilat janë ato fjalë që ju bëjnë të lumtur dhe ju forcojnë respektin për veten?
- ❑ Ç'veprimtari ju ndihmojnë të forconi respektin për veten? Cilat prej tyre ju krijojnë një ndjenjë të përkohshme të vetërespektit dhe cilat një ndjenjë të qëndrueshme të tij?

Kalohet në diskutimin e thënies:

“Më shumë vetërespekt do të thotë dëshirë e rritur për t’u njohur nga të tjerët, gjë që mundëson më pak viktimë që humbin respektin për veten”. Vazhdohet me diskutime të nxënësve mbi raste kur ata kanë ndjerë se kanë humbur respektin për veten, dhe si ata kanë reaguar më tej për ta rifituar përsëri respektin për veten.

AKTIVITET

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë një pemë të madhe, me të gjithë elementet (rrënjë, trung, degë, gjethe dhe frute). Më tej kërkohet nga ata që në disa kuadrate të vendosura në rrënjët e pemës të shënojnë cilësitë dhe aftësitë, talentet e tyre, kurse në krahët e pemës të shënojnë gjithçka pozitive që ata bëjnë dhe në frutet të shënojnë efektet e këtyre gjërave të mira. Secili nxënës diskuton në grupe me katër-pesë vetë vizatimin e tij, duke komentuar cilësitë individuale. Si i shrytëzon dhe çfarë përfitimesh i kanë sjellë në jetën e tij?

Organizohet përsëri diskutim me nxënësit në lidhje me pyetjet:

- ☐ A mendoni se viktimat e trafikimit kanë respekt për veten? Si e argumentoni mendimin tuaj?
- ☐ Cilat janë disa nga arsyet pse kjo kategori njerëzish nuk ka fituar respektin për veten?
- ☐ Si mund të ndihmojë familja, shkolla shoqëria që fëmijët dhe adoleshentët të fitojnë respektin për veten?
- ☐ A mendoni se te viktimat e trafikimit mund t’i kthehet një ditë respekti për veten? Si mund të arrihet kjo?

Tema: Të bësh një ndryshimi

Kërkohet nga nxënësit të flasin rreth një ndryshimi të vogël ose të rëndësishëm në jetën e tyre, si e kanë arritur ndryshimin dhe se si janë ndjerë pas ndryshimit.

Nxënësit nxiten të përmendin gjëra të tjera të vogla apo të rëndësishme, që ata dëshirojnë t’i ndryshojnë në jetën e tyre, duke treguar dhe mënyrën si mendojnë ta arrijnë këtë ndryshim. Organizohet diskutimi rreth thënies :

“Pjesë e respektit për veten është të dish se unë mund të bëj një ndryshim”.

Si mbyllje realizohet diskutimi në lidhje me pyetjet në vijim:

- ☐ A e gjykoni të rëndësishëm një ndryshim në jetën tuaj të përditëshme për t’u mbrojtur nga trafikantët? Cilat do të ishin këto ndryshime?
- ☐ A duhet të mendojnë për të ndryshuar njerëz, të cilët kanë përjetuar fatkeqësinë e trafikimit?
- ☐ Si duhet ta arrijnë ndryshimin?
- ☐ Cfarë ndihme duhet të kërkojnë në këtë rast?

Nga nxënësit kërkohet si detyrë shtëpie hartimi i një faqeje me reflektime në fund të trajtimit të çështjes së respektit.

Në këtë faqe nxënësit rrjeshtojnë si në vijim të gjitha thëniet/fjalitë e diskutuara në klasë mbi respektin. Me dëshirën e nxënësve, një kopje e saj mund të afishohet (të vendoset

në faqen e murit) edhe në këndin e klasës.

Çështje të reflektimit mund të jenë:

- ☐ Çdo qenie njerëzore ka vlera të natyrshme.
- ☐ Pjesë e respektit për vete është të njohësh cilësitë e tua.
- ☐ Respekti për veten rrit besimin në vetvete.
- ☐ Kur ne kemi respekt për veten, është e lehtë të kemi respekt për të tjerët.
- ☐ Të njohësh vlerat e tua natyrore dhe të nderosh vlerat e të tjerëve është rruga e vërtetë për të lindur respekti.
- ☐ Ata që tregojnë respekt, do jenë të respektuar.
- ☐ Rritje e respektit për veten d.m.th rritje e kërkesës për t'u pranuar nga të tjerët.
- ☐ Dëshirë më e madhe për t'u pranuar nënkupton më pak viktime që humbin respektin për veten.
- ☐ Secili në botë ka të drejtën të jetojë me respekt dhe dinjitet, duke më përfshirë dhe mua.
- ☐ Pjesë e respektit për veten është të dish se unë mund të bëj një ndryshim
- ☐ Respekti për veten të krijon ndjesinë e të qenurit i fuqishëm, i sukseshëm, i dobishëm.
- ☐ Respekti për veten të ndihmon të marrësh përgjegjësi, të ndihmosh të tjerët.
- ☐ Respekti për veten të jep iniciativë, të bën të ndjehesh i guximshëm.
- ☐ Respekti për veten të jep ndjesinë e pasjes së aftësive për të vendosur vetë për veten, të vendosësh vetë qëllimet e jetës tënde.
- ☐ Respekti për veten të bën të ruash figurën morale.
- ☐ Respekti për veten të bën të jesh korrekt në marrëdhënie me të tjerët.

3.3 Vendimarrja

Duke qenë i lirë, njeriu ka të drejtë të marrë vendime. Njerëzit marrin vazhdimisht vendime, duke filluar nga vendimet e vogla për jetën e marrëdhëniet e përditshme, gjer tek vendime tepër të rëndësishme me ndikim mbi jetën e ardhme dhe perspektivat jetësore të individëve. Të marrësh një vendim do të thotë të zgjedhësh ndër alternativat e mundshme. Nëse vendimi merret me kujdesin e duhur, kjo do të thotë zgjedhje e alternativës më të përshtatshme për të shkuar drejt rezultatit të dëshiruar.

Në marrjen e vendimeve të vështira dhe të rëndësishme, nevojitet të ndiqet metodika e marrjes së vendimeve, e ashtuquajtur “pema e vendimit”.

Edukimi antitrafik, ndër të tjera, sheh tepër të rëndësishme dhe përgatitjen e nxënësve me aftësi të vendimarrjes, ndaj një program edukimi antitrafik duhet të përfshijë dhe aftësimin e nxënësve drejt vendimarrjes efektive. Për këtë mësuesi planifikon të realizojë me nxënësit :

- Ushtrime praktike dhe diskutime për kuptimin dhe rëndësinë e vendimarrjes.

- Ushtrime praktike përmes së cilave nxënësit të përforcojnë rrugën e nevojshme metodike, që duhet të ndiqet për të marrë vendime të duhura në raste të vështira, si dhe marrjen e vendimeve që lidhen me trafikimin.

Tema: Kuptimi dhe rëndësia e vendimmarrjes

- Shtrohen para nxënësve pyetjet:
- Ç'do të thotë për ju të marrësh një vendim? Ç'vendime keni marrë në ditën e sotme? I morët lehtë ato?
- Keni pasur rast të ndodheni në një situatë të vështirë, në të cilën duhet të merrnit një vendim? Si vepruat në atë rast? Ishte i drejtë vendimi që morët? Ç'pasoja kishit prej tij?

AKTIVITET

Në tavolinën e mësuesit janë vendosur katër pako, ku secila ka një numër nga 1-4. Pakot kanë pamje të ndryshme. Nxënësit ndahen në tre grupe, secili grup nxjerr një përfaqësues i cili do të zgjedhë njërin nga pakot e vendosura. Këto përfaqësues dëgjojnë dhe mendimin e shokëve për të bërë zgjedhjen e tyre. Nxënësit zgjedhës orientohen t'i marrin në dorë të gjitha pakot, para se të zgjedhin. Pas zgjedhjes, pakot hapen me rradhë, secili nxënës para se të hapë pakon, jep argumenta pse bëri këtë zgjedhje. Pakot mbushen nga mësuesi në mënyrë që:

Në pakon e parë, të jetë diçka që të ketë volum, por që zgjedhja ta vërë disi në turp nxënësin. Synohet që nga kjo zgjedhje nxënësit të kuptojnë se vendimet në pamje të parë mund të duken pozitive, por ato të shpesh të sjellin pasoja të papritura që të venë dhe në turp.

Në pakon e dytë, të jetë diçka që mund t'i zhgënjejë nxënësit, p.sh., të ketë pamjen e diçkaje që hahet, por që në fakt nuk është e tillë. Kjo zgjedhje duhet të japë për nxënësit mesazhin: shpesh vendimet e marra të zhgënjejnë.

Në pakon e tretë, të jetë diçka që në pamje të duket një zgjedhje e mirë por, në fakt nuk të sjell asgjë as të mirë dhe as të keqe, p.sh., një qese me dhé brenda pakos mund të shërbejë për këtë. Pra mesazhi për nxënësit nëpërmjet kësaj zgjedhjeje është që shpesh zgjedhjet tona nuk sjellin asgjë as të mirë dhe as të keqe.

Në pakon e katërt, të jetë diçka që në pamje nuk të mbush mendjen se mund të të sigurojë ndonjë gjë të rëndësishme pakoja duhet të jetë e vogël dhe tepër e lehtë, ndërkohë brenda saj të ketë vërtet diçka vërtet të mirë, p.sh., një sasi e konsiderueshme lekësh, një lajmërim për një bursë studimi etj. Zgjedhja duhet të japë për nxënësit mesazhin se nëse je i sigurt se s'ka asnjë rrezik, duhet dhe të rrezikosh.

Në përfundim, nxënësit diskutojnë mbi mesazhet që nxjerrin prej secilit rast zgjedhjeje. Po ashtu, në përmbledhje të tyre del se të marrësh një vendim është shumë e vështirë. Para se të marrësh vendimin, duhet të gjykosësh mbi gjithë pasojat e mundshme dhe për këtë nevojitet më shumë informacion, vëmendje dhe të peshosh me kujdes ndikimet e të tjerëve.

Tema: Metodika e marrjes së vendimeve

Nxënësve u mësohet se tri janë elementët më të rëndësishme, që duhen mbajtur parasysh në një vendimmarrje; sfida me të cilën përballlet individi, mundësitë që ai ka për zgjedhje, pasojat e secilës zgjedhje. Është e kuptueshme që një rrugë e tillë përshkohet nëse vendimi është me rëndësi, këtu nuk është fjala për vendime të vogla të jetës së përditshme, por për vendime të rëndësishme të vështira për t'u marrë. Format i që vijon është mirë të afishohet për nxënësit.

Elementë me rëndësi për marrjen e një vendimi

1. Sfida që kemi përpara:
2. Zgjedhjet që mund të bëjmë:

Zgjedhja 1:

Zgjedhja 2:

Zgjedhja 3:

Zgjedhja 4:

3. Pasoja të secilës zgjedhje:

Zgjedhja	Pasoja pozitive	Pasoja negative
E parë
E dytë
E tretë
E katërt

Vendimi është:

Arsyeja për këtë vendim është:

AKTIVITET**Ushtrime praktike për marrje vendimesh**

Nxënësit ndahen në grupe të vogla me tre-katër persona. Secilit grup i jepet për të vendosur rreth dy situatave të vështira që ju jep mësuesi në lidhje me moshën dhe problemet që nxënësit kanë. Situatat mund të jenë jetësore, ndër rastet e dëgjura ose të lexuara, ose mund të improvizohen nga mësuesi në lidhje me vendimet që duhet të marrë një i ri, e re kur gjendet para një presioni për të marrë drogë, për të kryer marrëdhënie seksuale në moshë të re, konsumuar duhanin apo alkoolin, apo për të kryer studimet në një degë për të cilën s'është i bindur etj.

Nga nxënësit ërkohet të ndjekin modelin e mësipërm për marrjen e vendimit, duke bërë

kujdesin e duhur për të siguruar zgjedhjen më të mirë, më të informuar, duke menduar për pasojat e mundshme nga secila zgjedhje. Lihet koha e mjaftueshme për zgjidhjen e detyrës, pastaj një përfaqësues i grupit argumenton rrugën e ndjekur dhe vendimin e marrë nga grupi që ai përfaqëson.

Në mbyllje organizohet diskutimi në lidhje me:

- Vështirësitë që patën nxënësit në lidhje me vendimin e marrë.
- Ç'mendojnë ata për pemën e vendimit, i ndihmon në marrjen e vendimeve të
- duhura, në situata të vështira? Do ta përdorin në rastet që do iu duhet të marrin vendime të vështira?
- Çfarë ndikon zakonisht tek njerëzit kur u duhet të marrin një vendim?
- Si është një vendimmarrje, nëse kemi informacionin e nevojshëm në lidhje me çështjen që duhet të zgjidhim etj?

Tema: Trafikimi i fëmijëve dhe marrja e vendimeve

AKTIVITET

Nxënësit ndahen në grupe, ku secili grup ka përpara një situatë trafikimi, të sjellë në klasë nga shembuj jetësorë trafikimesh të vajzave dhe fëmijve, të lexuar apo dëgjuar në median e shkruar dhe audiovizive, apo burime të tjera informacioni.

Në një fazë të dytë, kërkohet nga nxënësit të imagjinojnë se ndodhen në situatat e përshkruara në rastet që kanë përpara dhe, që duke ndjekur pemën e marrjes së vendimeve, të analizojnë situatat dhe të shprehin për vendimin e tyre në mënyrë të argumentuar.

Secili grup përshkruan për shokët rrugën e ndjekur dhe vendimin e marrë.

Në mbyllje organizohet diskutimi lidhur me çështjet:

- Cilat janë arsyet që ju bëjnë të refuzoni propozimet joshëse ?
- Cilat rrugë mendoni se duhen ndjekur kur rrezikoni të ndodheni para një mundësie trafikimi? Të siguronit më shumë informacion? T'u drejtoheni njerëzve të besuar, që mendoni se mund t'ju ndihmojnë sinqerisht?
- Cilat janë organizmat përkatëse që mund t'ju japin shërbimet e duhura në të tilla raste?

3.4 Ndërtimi i aftësive

Megjithatë nuk mjafton që nxënësi të jetë i vetëdijshëm për trafikimin dhe pasojat e tij. Ata duhet të fitojnë dhe ushtrojnë aftësi të shumta, që lidhen me jetën e përditshme. Aftësia për jetën nënkupton paisjen e nxënësve me aftësi për sjellje adoptive dhe positive, që i lejojnë atij të luftojë me kërkesat dhe sfidat e jetës së përditshme. Aftësitë për jetën janë një grup kompetencash psiko-sociale dhe aftësish ndërpersonale, që ndihmojnë njerëzit

të marrin vendime të informuara, të zgjidhin probleme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të komunikojnë në mënyrë efektive. I ndihmojnë të ndërtojnë marrëdhënie të sigurta dhe të shëndetshme me të tjerët. Aftësitë për jetën ndihmojnë për ndërmarrjen e aksioneve personale dhe aksioneve për të tjerët.

Ndalemi në një shtjellim të shkurtër për kuptimin e disa aftësive të rëndësishme për jetën. Të klasifikuara sipas tre grupeve kryesore, ato paraqiten të ndara nga njëra-tjetra, por në fakt janë të ndërlidhura dhe mund të përvetësohen së bashku përmes një aktiviteti të caktuar mësimor. Aftësitë e përmendura zhvillohen përmes fushave kryesore të të mësuarit dhe në kontekste të ndryshme kroskurrikulare.

Aftësi të komunikimit dhe ndërpersonale	Aftësi të vendimmarrjes dhe të menduarit kritik	Aftësi përballuese dhe manaxhuese të vetes
<p>* Ndërpersonale</p> <ul style="list-style-type: none"> - aftësi komunikimi - aftësi dëgjimore - shprehje e ndjenjave <p>* Negocimi / aftësi të refuzimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - negociimi - menaxhimi i konflikteve - aftësi të pranimit - aftësi të refuzimit <p>* Ndërtim miqësish</p> <ul style="list-style-type: none"> - aftësi të dëgjimit - të kuptuarit e nevojave dhe rrethanave të të tjerëve - shprehje mirëkuptimi <p>* Bashkëveprimi dhe puna në grup</p> <ul style="list-style-type: none"> - shprehja e respektit për të tjerët (kontributet dhe stilet e ndryshme) - vlerësim mundësish individuale, kontribut në grup <p>* Aftësi këshillimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - aftësi të ndikimit tek të tjerët dhe bindëse - aftësi të motivimit dhe krijimit të rrjetit 	<p>* Vendimmarrja</p> <ul style="list-style-type: none"> - aftësi të zgjidhjes së problemeve - aftësi të mbledhjes së informacionit - vlerësimi i së ardhmes, pasoja të veprimtarisë së tanishme për veten dhe të tjerët/përcaktim alternativash në zgjidhje problemesh - aftësi për të analizuar situatat dhe njerëzit <p>* Aftësi të mendimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - kritikanalizë e influencës së bashkëmoshatarëve dhe medias - analizë e qëndrimeve, vlerave, normave sociale, përfitimeve dhe faktorëve që ndikojnë në to - identifikim i informacionit që ka lidhje me problemin, dhe burimin e informacionit 	<p>* Aftësi për rritjen e konfidencës personale</p> <ul style="list-style-type: none"> - mundësi për të marrë përsipër kontrollin, për të bërë diferencat, nxjerrë ndryshimet - ndërtim i vetëvlerësimit / besimit - krijimi i aftësive të vënies në dukje të vetes, duke përfshirë njohjen e të drejtave, influencave - vlerave, qëndrimeve, drejtësisë, forcës dhe dobësi - vendosja e qëllimeve vetëvlerësimi/ vetëgjykim / monitorimi individual i aftësive <p>* Aftësi për menaxhimin e ndjenjave</p> <ul style="list-style-type: none"> - menaxhimi i zemërimit - qëndrimi me fatkeqësitë dhe shqetësimet - përballimi i humbjeve, abuzimeve, traumave <p>* Aftësi për të përballuar stresin</p> <ul style="list-style-type: none"> - menaxhimi i kohës - të menduarit pozitiv - teknika të relaksimit

Të gjitha aftësitë janë të rëndësishme, në qoftë se nxënësit arrijnë potencialin e tyre. Programet që synojnë zhvillimin e aftësive për jetën duhen organizuar në lidhje me çështje të caktuara si p.sh., ajo e trafikimit, mbrojtjes nga drogat, sida etj. Programet jashtë konteksteve të tilla janë më pak efektive në paisjen e nxënësve me aftësitë për jetën.

Edukimi i aftësive në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore

Aftësi të komunikimit dhe ndërpersonale	Aftësi të vendimmarrjes dhe të menduarit kritik	Aftësi përballuese dhe menaxhuese të vetes
<p>* Aftësi të komunikimit</p> <p>Nxënësit mund të vëzhgojnë dhe praktikojnë rrugë të ndryshme të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shprehjes efektive të një vullneti për të ndjekur studimet dhe mos menduar për punësim apo martesë jashtë vendit, influencës tek të tjerët për t'u mbrojtur nga joshjet e trafikantëve - demonstroi mbështetje për parandalimin e diskriminimit të viktimave të trafikimit - dëgjon pikëpamjet e të tjerëve lidhur me problemet e trafikimit <p>* Aftësi këshilluese</p> <p>Nxënësit mund të vëzhgojnë dhe praktikojnë rrugë të ndryshme për të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - prezantuar argumenta në shërbim të të rrezikuarve dhe viktimave të trafikimit - qenë të përfshirë në aktivitete që nxisin sjellje mbrojtëse prej trafikantëve - informuar të tjerët rreth aktiviteteve dhe organizimeve antitrafik - përkrahur programet anti-trafik në shkollë dhe jashtë saj <p>* Aftësi të negociimit/ refuzimit</p> <p>Nxënësit mund të vëzhgojnë dhe praktikojnë rrugë të ndryshme për të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - refuzuar propozimet joshëse për para, martesë pa njohjen e tjetrit, për të ndërhyrë dhe ndihmuar të tjerët në kohën e duhur për të shmangur trafikimin. <p>* Aftësi ndërpersonale</p> <p>Nxënësit mund të vëzhgojnë dhe praktikojnë rrugë të ndryshme për të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qenë të kujdesshëm dhe respektues kur kanë marrëdhënie me një viktimë të trafikimit - realizuar marrëdhënie të sigurta me të panjohurit 	<p>* Aftësi vendimmarrëse</p> <p>Nxënësit mund të vëzhgojnë dhe praktikojnë rrugë të ndryshme të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kërkimit dhe gjetjes së burimeve të informacionit mbi rrugët e trafikimit, pasojat e tij, organizmat shtetërore dhe joqeveritare që punojnë kundër tij etj - të roleve të tutorëve, rekrutuesve, viktimave, soditësve, policisë etj - analizës së llojeve të situatave potenciale që mund të shpien drejt trafikimit, apo të rrugëve si mund të shpëtosh nga trafikantët në rast se e keqja ka ndodhur <p>* Mendimi kritik</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizës së ngjarjeve të trafikimeve në komunitet e më gjerë (të marra përmes tregimeve gojore dhe mediave) - analizës së influencave sociale në lidhje me rastet e trafikuar- të identifikimit dhe shmangjes së situatave të trafikimit - vlerësimit të zgjedhjeve të bëra vetë dhe nga individë të tjerë, si të gabuara ose të drejta - analizës së stereotipeve të bindjeve dhe cilësive që mbështesin trafikimin. 	<p>* Aftësi të menaxhimit të stresit</p> <p>Nxënësit mund të vëzhgojnë dhe praktikojnë rrugë të ndryshme të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikimit dhe zgjidhjeve të suksesshme të rreziqeve të trafikimit, rezistencës ndaj presioneve të prindërve dhe të rriturve të tjerë për punësim ose martesë me të panjohur - kërkimit të shërbimeve për t'u ndihmuar për çështjet e trafikimit <p>* Aftësi për rritjen e konfidencës</p> <ul style="list-style-type: none"> - personale dhe mundësi për të ushtruar kontroll, marrë përgjegjësi, nxjerrë në pah ndryshimet <p>Nxënësit mund të vëzhgojnë dhe praktikojnë rrugë të ndryshme të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendosjes së një sistemi vlerash personale që janë të pavarura nga influencat kundërshtuese të mjedisit. Përmendim vetëbesimin, këmbënguljen, ndershmërinë, qëndrueshmërinë etj

Fitimi i aftësive të nevojshme të nxënësve për të parandaluar trafikimin, nuk mund të realizohet në gjerësinë dhe thellësinë e duhur vetëm gjatë një periudhe të shkurtër kohore,

qoftë kjo dhe një vjeçare. Ajo kërkon një programim afatgjatë në tërë vitet e shkollimit, duke vendosur objektiva të qarta për t'i përgatitur nxënësit që:

- Të njohin vetveten
- Të zotërojnë aftësi kritike dhe krijuese;
- Të kenë aftësi të përshtatshme komunikimi;
- Të kontrollojnë emocionet;
- T'i bëjnë ballë streseve, konflikteve, dhunës;
- Të adoptojnë stile jetësore të mbrojtura dhe të sigurta;
- Të ndjejnë përgjegjësinë sociale.

Nxënësit fitojnë aftësi jetësore gjatë procesit që përfshin:

- Modelimet;
- Vëzhgimin;
- Ndërveprimet sociale.

Roli i mësuesit është të ndihmojë dhe lehtësojë realizimin e këtij procesi, që sigurisht kërkon përdorim të një metodologjie efektive e të përshtatshme për arritjen e objektivave të vendosura. Ndër komponentë kryesorë të veprimtarisë për paisjen e nxënësve me aftësitë për jetën, përmendim:

- Vënie e theksit tek aftësitë për jetën;
- Praktikimi i aftësive për t'ju përgjigjur jetës së përditshme;
- Përdorim i metodave ndëraktive;
- Nxitje e prindërve për të ndihmuar fëmijët të zbatojnë aftësitë;
- Ofrim i mundësive që nxënësit të zbatojnë aftësitë praktike në projekte të komunitetit

Synimi nuk është vetëm që nxënësit të aplikojnë sjellje pozitive antitrafik, por që t'i përgatisim ata me kompetencën e veprimt antitrafik.

Kompetenca e veprimt antitrafik përfshin ndërmarrjen nga nxënësit të aksioneve kundërshtuese të trafikimit, në lidhje me veten dhe të tjerët.

Kapitulli 4

4.1 Një plan veprimi shkollor i edukimit antitrafikim, një domosdoshmëri

Problemet janë shumë të ndjeshme dhe rreziqet shumë të larta për t'u injoruar, ndaj tyre duhet vepruar. Shkolla nga ana e saj trajton një spektër të gjerë sjelljesh, aftësish, që janë të nevojshme në edukimin e nxënësve për parandalimin e trafikimit. Ajo ka detyrë të përgatisë nxënësit me aftësinë për t'u përballur me vështirësitë dhe situatat e pasigurta, ndërmarrjen e përgjegjësiwe personale dhe gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e problemeve, në mënyrë që zgjedhjet e tyre të jenë të bazuara në një informacion të plotë, jo vetëm mbi analizën e situatës aktuale por dhe mbi vizionin e së ardhmes që ata dëshirojnë, shikimit përtej nevojave themelore drejt interesave individuale afatgjata. Shkolla gjithashtu, ofron mundësi për të siguruar programe aftësimi kundër trafikimit, sipas nevojave të moshës. Këtu është vendi më i përshtatshëm për realizimin e këtyre programeve, sepse:

1. Shkolla vendos thekse me fëmijët dhe adoleshentët në shkallë të gjerë, duke ofruar informacion dhe arsyetime që përdoren për të bindur nxënësit rreth rëndësisë së parandalimit të trafikimit, si dhe duke argumentuar nevojën për përkrahjen e institucioneve lokale dhe shtetërore të mbrojtjes nga trafikimi.
2. Shkolla identifikon dhe zhvillon aftësitë, që nxënësit kanë nevojë t'i mësojnë dhe zbatojnë, në mënyrë që të mos ballafaqohen me situata të rrezikshme të trafikimit.
3. Infrastruktura për zbatimin e programeve të edukimit kundër trafikimit është e ngritur, gjë që e bën më ekonomik zbatimin e këtyre programeve. Shkollat mund të bëjnë ndërhyrje të thjeshta dhe jo të kushtueshme, të cilat do të ndihmojnë në krijimin e një ambjenti fizik dhe psikologjik, si dhe të një atmosfere në favor të edukimit të nxënësve për parandalimin e trafikimit.
4. Mësuesit janë të përgatitur për punë edukative me nxënësit.
5. Shkolla ka kredibilitet për atë që bën me nxënësit, si për prindërit, ashtu edhe për anëtarët e tjerë të komunitetit. Ajo mund të bashkëveprojë me antarët e komunitetit, prindërit dhe shërbimet lokale në mbështetjen e iniciativave për parandalimin e trafikimit, si dhe në udhëzimin e të rinjve drejt një jete të suksesshme.
6. Qëndrimi i një numri të madh të rinjsh në shkollë, jep mundësi për vlerësime efektive, të shpejta, afatshkurtra dhe afatgjata në lidhje me ecurinë e programimeve për parandalimin e trafikimit.

• 4.1.1 Kush do ta hartojë programin e kundërtrafikimit në shkolla?

Drejtorja e shkollës përcakton një grup pune të përbërë nga mësues, prindër, nxënës dhe anëtarë të komunitetit, specialistë të çështjes së trafikimit në fusha të ndryshme, për të hartuar një program vjetor, ose për një kohë më të gjatë, të aktiviteteve kundër trafikimit në shkollë.

Ndër mësuesit e shkollës që duhen përfshirë në këtë grup pune përmendim, mësuesit e lëndëve të Biologjisë, Gjeografisë, Historisë, Edukatës Qytetare, apo të lëndëve të tjera sociale, të cilët kanë më shumë mundësi reale në trajtimin e temave, që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerezore, gjatë procesit mësimor të përditshëm. Kjo do të ndikojë

në fitimin e informacioneve dhe aftësive të nevojshme të nxënësve për t'u mbrojtur nga trafikimi.

Grupi i punës në planifikimin e veprimeve merr në konsideratë nevojat, burimet në dispozicion, si dhe përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e programit kundër trafikimit në shkollë. Për të gjitha këto vendime, anëtarët e grupit të punës negociojnë dhe thithin paraprakisht mendime nga mësuesit e tjerë të shkollës, përfaqësues të politikës, prindërit, antarë të tjerë të komunitetit.

Drejtoritë arsimore, si dhe zyrat rajonale të edukimit, mund të ndërhyjnë për të siguruar shkëmbimin e përvojave të programimeve ndërmjet shkollave, ose dhe të ofrojnë një model programi, që vetë drejtoria arsimore propozon të ndiqet nga shkollat nën administrimin e saj.

• 4.1.2 Sigurimi i angazhimeve të nevojshme

Suksesi i veprimtarisë antitrafik në shkollë, lidhet mjaft me ndërgjegjësimin dhe vullnetin e njerëzve të komunitetit për të mbështetur këto aktivitete. Është e nevojshme të sigurohet nga shkolla përkrahja e politikanëve, prindërve, liderëve të komunitetit, anëtarëve të komunitetit në përgjithësi, medias lokale, grupeve fetare, biznesmenëve dhe studentëve.

Politika vendore (rajonale), me udhëzimet dhe përkrahjen që mund të japin, përbëjnë një ndihmë të madhe për shkollat. Përkushtimi, vëmendja dhe veprimet e autoriteteve mund të ndihmojnë shkollat të fitojnë mjete financiare, ashtu dhe përkrahje publike.

Pjesëmarrja e komunitetit dhe familjes, mundëson ndihmën në lidhje me planifikimin, vlerësimin dhe zbatimin e veprimtarive parandaluese të trafikimit në shkollë. Shoqatat e prindërve, arsimtarëve, qendrat fetare, takimet e grupeve të komunitetit si grupet rinore, grupet e grave, apo grupet këshilluese që funksionojnë në komunitet, shërbejnë si këshilltarë për të identifikuar dhe trajtuar shqetësimin e trafikimit të njerëzve, në veçanti të fëmijëve dhe grave, për të komunikuar vazhdimisht të dhëna në lidhje me trafikimin dhe për të siguruar një proces të shkëmbimit të mendimeve.

Angazhimi i mësuesve, është mjaft i rëndësishëm në përpjekjet për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, mendimi dhe puna e tyre janë mjaft të nevojshme në planifikimin dhe zbatimin e programeve antitrafik. Të gjithë mësuesit e shkollës duhet të marrin pjesë në diskutime lidhur me vendosjen e objektivave të edukimit antitrafik në shkollë, rrugët për arritjen e tyre, nevojat që kanë për t'u trajnuar, për materialet burimore që u nevojiten, format e bashkëpunimit të shkollës me familjet dhe pjesëtarë të tjerë të komunitetit etj.

Përfshirja e të rinjve, mundëson ndihmën shumë të vlefshme të tyre në planifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që u përgjigjen nevojave dhe shqetësimeve të tyre. Pjesëmarrja e të rinjve gjithashtu zhvillon tek ata ndjenjën e përgjegjësisë dhe të pjesëmarrjes në proces, gjë që bën procesin më të qëndrueshëm.

• 4.1.3 Procesi i planifikimit

Menjëherë me ngritjen e grupin e punës, duhet të fillojë procesin e planifikimit. Një planifikim i suksesshëm kërkon së pari analizën e gjendjes, për të vlerësuar më mirë

nevojat, mjetet, problemet në luftën kundër trafikimit të vajzave dhe fëmijëve.

Vlerësimi i nevojave, mundëson përcaktimin e mungesave në informacionin dhe aftësitë e nevojshme të nxënësve dhe prindërve në lidhje me shkaktarët, rrugët, dëmet që sjell trafikimi i qenieve njerëzore dhe masat mbrojtëse prej tij. Diskutimet dhe debati mes anëtarëve të grupit të punës është i nevojshëm në lidhje me përcaktimin e nevojave dhe situatës shkollore për të parandaluar rrezikun e trafikimit mes nxënësve të shkollës. Informacionet mbi nevojat përbëjnë bazën për përcaktimin e prioritetëve për veprim, dhe përcaktimin e grupeve që kanë nevoja të posaçme. Shkollave u duhet të njohin mirë dhe të identifikojnë kushtet sociale dhe ekonomike në të cilat jeton secili nga nxënësit, për të përcaktuar dhe bërë kujdes të veçantë për fëmijët më të rrezikuar, të cilët jetojnë në varfëri ekstreme, pa kujdes prindëror apo që kanë përjetuar abuzim seksual dhe forma të tjera të dhunës. Organizimi i programeve edukative për fëmijë të kësaj kategorie duhet të përbëjë një çështje urgjente për drejtoritë dhe mësuesit në shkolla. Mjaft e rëndësishme në lidhje me mbrojtjen e fëmijve nga rreziku i trafikimit është dhe shqyrtimi i nevojave të veçanta mësimore të nxënësve, duke përcaktuar rrugë të gjithëpërfshirjes dhe të integritetit të tyre në mësim. Nxënësit e stresuar nga mësimet, janë kontigjent potencial ndaj trafikimit dhe trafikantëve, ndaj duhen konsideruar si të nevojshme dhe përpjekjet, që nxënës të tillë të mos ketë në shkolla dhe që të gjithëve t'u sigurohet arsimim i përshtatshëm dhe kënaqësi për ndjekjen e shkollës.

Vlerësimi i mjeteve, ka të bëjë me përcaktimin e potencialeve që shkolla (apo shoqata të ndryshme që veprojnë brenda shkollës) zotëron, konkretisht në lidhje me parandalimin e trafikimit. Po ashtu vlerësohen burimet dhe shërbimet që mund të jepen nga komuniteti, në ndihmë të procesit të ndërmarrjes së veprimtarive të ndryshme kundër trafikimit në shkollë. Njohja e elementeve të tillë bën të mundur planifikimin, bazuar në mundësitë njerëzore dhe ato financiare që shkolla zotëron.

Mbledhja e të dhënave mbi problemin, nënkupton njohjen e rrezikut konkret të trafikimit në zonën rreth shkollës apo të kushteve shkollore për të përballur trafikimin. Këto të dhëna bëjnë të mundur që përpjekjet të përqëndrohen në probleme reale të nxënësve dhe anëtarëve të komunitetit në zonë, duke mundësuar kështu ndërhyrje konkrete pikërisht për problemet më urgjente. Disa të dhëna që ndihmojnë në përshkrimin e gjendjes aktuale mund të jenë:

- Numri i viktimave të trafikuar në zone, së paku për 2 vitet e fundit.
- Natyra, koha dhe vendi i trafikimit.
- Përdorimi i drogës nga nxënësit.
- Prania e temave mësimore në plan-programet mësimore që i ndihmojnë mbrojtjes nga rreziku i trafikimit.
- Sa mësuesit realizojnë me nxënësit diskutime të situatave të rastit që lidhen me trafikimin
- Sa shërbime këshilluese bëhen për nxënësit në lidhje me trafikimin dhe nga kush?
- Sa janë në gjendje prindërit të realizojnë edukimin e fëmijëve për të parandaluar trafikimin etj?
- Cilët janë nxënësit më të rrezikuar në shkollë?

Të dhënat sigurohen përmes:

- Intervistave dhe sondazheve me nxënës, prindër, mësues, etj;
- Shqyrtimit të raporteve të policisë mbi rastet e trafikuar;
- Raportimeve të spitaleve për numrin e të rinjve të mjekuar, në lidhje me përdorimin e drogës;
- Vëzhgimeve në klasë;
- Pyetësorëve me mësuesit, nxënësit në lidhje me njohuritë e nevojshme mbi çështjen e trafikimit etj.

Pas analizës së gjendjes, grupi i punës përpilon planin e veprimit antitrafikim.

• 4.1.4 Elementë përbërës në planin e veprimit

- a. Qëllimet duhet të përshkruajnë në vija të trasha çfarë shpreson shkolla që të arrijë nëpërmjet përpjekjeve për të parandaluar trafikimin. Diskutimet e hapura me mësues, nxënës, prindër, anëtarë të komunitetit, shërbejnë për të formuluar qëllimet e duhura. Si qëllime p.sh., mund të jenë:
 - Krijimi i një mjedisi shkollor mbrojtës dhe mbështetës për nxënësit;
 - Krijimi i aftësive tek nxënësit për parandalimin e trafikimit në të ardhmen;
 - Përfshirja dhe aftësimi i të rinjve për t'u bërë udhëheqës të parandalimit të trafikimit të fëmijëve dhe të tjerëve në shoqërinë kosovare.
- b. Objektivat janë hapa të rëndësishme në arritjen e qëllimeve të përgjithshme, ato mund të klasifikohen në afatgjata dhe afatshkurtra. Objektivat saktësojnë atë që duhet bërë për arritjen e qëllimeve të përgjithshme, ato duhet të jenë të matshme dhe të realizueshme. Disa nga objektivat mund të jenë:
 - Të zvogëlohet numri i nxënësve që mungojnë në shkollë, për shkak të frikës nga mësimet (p.sh., brenda semestrit të parë.);
 - Të ndryshojë jeta sociale në shkollë, për të rritur interesimin dhe kënaqësinë e nxënësve për shkollën (p.sh., gjatë gjithë vitit);
 - Të rritet informacioni i nxënësve mbi rrugët e trafikimit, dëmet e tij, dhe mënyrat e parandalimit (p.sh., muajt janar, shkurt, mars).
- c. Strategjitë për parandalimin e trafikimit duhet:
 - Të jenë bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse, të jenë të kombinuara dhe të marrin shembuj nga jeta reale në komunitet dhe përtej tij;
 - Të jenë të aplikueshme në përshtatje me moshën, psikologjinë, njohuritë dhe aftësitë që kanë nxënësit;
 - Të jenë të vazhdueshme dhe të konsiderojnë ndryshimin e rrethanave, pengesat;
 - Të përfshihen burimet e nevojshme për arritjen e qëllimeve të vendosura, duke bërë kujdes për grupet vulnerabel dhe ato të neglizhuara;

- Të bëhet motivimi i nxënësve për të marrë pjesë në aktivitetet kundër trafikimit në shkollë, komunitet.
- d. Aktivitetet duhet të reflektojnë objektivat e vendosura. Sa më të qarta dhe të përcaktuara të jenë objektivat, aq më e lehtë do të jetë zgjedhja e aktiviteteve të përshtatshme për përmbushjen e tyre. Aktivitetet që ndërmerren duhet të marrin parasysh çfarë ndryshimesh priten? Kush do ta zhvillojë aktivitetin? Çfarë do bëhet? Kur do realizohet? Ku do realizohet? Veprimet e planifikuara lidhen me shprehjet “për të siguruar”, “për të krijuar”, “për të themeluar” etj. Disa nga modelet e veprimeve që mund të ndërmerren janë:
- Përcaktimi i temave të kurrikulit, ku informacioni dhe përfitimi i aftësive të nevojshme kundër trafikimit janë të mundura;
- Organizimi i bisedave me policë, juristë, për t’u folur nxënësve lidhur me sigurinë, krimin, pasojat dhe masat parandaluese.

Shkollat shpesh nuk kanë mjetet e duhura për të filluar veprime të mëdha për parandalimin e trafikimit, por kjo nuk duhet të bëhet pengesë që ato të mos marrin përsipër trajtimin e tematikës, pasi edhe hapat e vegjël sjellin rezultate pozitive. P.sh., mund të zhvillohen dy apo tre aktivitete që janë të mundshme për t’u realizuar në kushtet e çdo shkolle të tilla si, trajnimi i mësuesve, diskutimet ndërmjet nxënësve, këshillimet e prindërve etj.

- e. Vlerësimi dhe monitorimi, është një mjet i fuqishëm që duhet përdorur për forcimin e aktiviteteve antitrafikim në shkollë. Të dhënat e mbledhura përmes një vlerësimi të përcaktuar me kujdes, përbëjnë një informacion të rëndësishëm për të korigjuar dhe ecur përpara, për të realizuar qëllimet dhe objektivat e vendosura, si dhe të asaj që duhet bërë për të ecur më tej në të ardhmen. Vlerësimi duhet t’u japë përgjigje pyetjeve:
- A prek veprimtaria e dhënë personat e dhënë, në momentin kur ata kanë nevojë?
- A shfrytëzohen materialet e planifikuara?
- A janë përfshirë prindërit dhe anëtarët e tjerë të komunitetit sipas planifikimit të bërë?
- A është arritur ajo që pritej?
- Cilat trajnime ose aspekte të punës shkojnë mirë, cilat jo? Në ç’rrethana?
- Cilët komponentë nuk funksionojnë? Ku ka qenë gabimi?
- Ku duhet të përqëndrohemi më tepër në të ardhmen? Çfarë mund të përmirësojmë?

Vlerësimi përfshin planifikimin, procesin dhe rezultatet.

Vlerësimi i planifikimit, ka për qëllim të ndihmojë dhe modifikojë një planifikim të ri. Vlerësimi i planifikimit mbështetet në metoda cilësore dhe të rëndësishme si vëzhgimi, intervistat individuale dhe në grup, mbledhja e informacioneve nga nxënësit, mësuesit ose profesionistët në përpjekjet për parandalimin e trafikimit.

Vlerësimi i procesit, dokumenton atë që është bërë dhe me kë. Duhet të ekzistojë një proces i vazhdueshëm i vlerësimit të aktiviteteve, sepse kjo ndihmon në vlerësimin e

procesit drejt përmbushjes së qëllimeve dhe detyrave të edukimit antitrafik, për të bërë përmirësime të ndjeshme edhe gjatë procesit të zbatimit.

Vlerësimi i rezultateve, tregon nëse masat dhe aktivitetet e zhvilluara, kanë arritur të ndryshojnë diçka ose jo. Ky vlerësim bëhet për të dëshmuar çfarë ndryshimesh janë bërë që nga koha e fillimit të aktiviteteve gjer në përfundim të zbatimit. Maten rezultatet që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e vendosura.

4.2 Nxitja e një mjedisi mbrojtës dhe mbështetës antitrafik në shkollë

Një mjedis mbrojtës dhe mbështetës antitrafik është pjesë e sigurimit të nxënësve nga rreziku i trafikantëve dhe motivimit të tyre për të bërë zgjedhjet e duhura kundërshtuese ndaj trafikimit.

Mbrojtës: I referohet mjedisit ku mungojnë rreziqet, traumat, streset, dhuna, abuzimi.

Mbështetës: Nënkupton një mjedis që siguron një marrëdhënie të afërt me familjen, të rriturit e tjerë, përfshirë mësuesit dhe bashkëmoshatarët.

Krijimi i një mjedisi, ku nxënësi të arrijë të shprehet para të rriturit, është gjëja më e mirë që mund të bëhet për mbështetjen dhe mbrojtjen e tij.

Material ndihmës për mësuesit dhe nxënësit, për të njohur: ç'është stresi, faktorët stresues dhe menaxhimi i këtyre faktorëve.

• Çfarë është stresi?

Stresi është reagimi fizik dhe emocional ndaj rreziqeve apo kërkesave.

Tri llojet e stresit që mund të shkaktohen nga rrethana të brendshme dhe të jashtme janë:

- Shqetësim ose ankth. Ky lloj stresi ndodh kur mundësia për të arritur një qëllim të dëshiruar pengohet ose ndalohe, për shembull, ndjenja të tilla përjeton dikush që përpiqet të mësojë në një dhomë të zhurmshme ose me shumë njerëz.
- Konflikt. Ndodh atëherë kur duhet të zgjedhësh ndërmjet dy mundësive, për shembull, një adoleshent mund të jetë në konflikt, kur i duhet të zgjedhë të bëjë çfarë duan prindërit apo atë çfarë duan shokët.
- Presion. Ndodh kur dikush detyrohet ose nxitet të bëjë diçka, që ai nuk ndihet shumë i sigurtë për ta bërë. Për shembull, kur një adoleshent është i detyruar të pijë duhan, alkool apo edhe më keq drogë, në mënyrë që të jetë i pëlqyer dhe i pranuar nga shokët.

• Si ndikon stresi tek njeriu?


Stresi ndikon tek trupi i njeriut, duke shkaktuar ulçer, tension të lartë të gjakut ose sjellje të dhunshme. Ndikon tek emocionet duke shkaktuar ndjenja shqetësimi, inatii ose mosbesimi tek vetja.

• Nivelet e stresit

1. **Stresi**, që shkaktohet nga një faktor i vetëm (i brendshëm apo dhe i jashtëm), që e

bën njeriun të ndjehet i tensionuar. (Shembuj: kur nuk je i përgatitur në mësim, të ndaloresh nga prindërit të flasësh në telefon, dënim në shkollë për një veprim të gabuar etj).

2. **Stres i shumëfishtë** ndodh kur veprojnë disa faktorë njëkohësisht, për shembull, një nxënës i vdes gjyshja, por ndërkohë ai është në sezonin e provimeve të maturës, për të cilat nuk ka kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur, duke shtuar këtu edhe gjendjen e tij shpirtërore nga vdekja e gjyshes.
3. **Stresi fizik**, ndodh kur kemi probleme shëndeti, për shembull, dhimbje koke, dëmtim në sport, akne, vështirësi në shikim, dhembje dhëmbi etj.
4. **Mbingarkesë**, ndodh kur grumbullohet shumë stres. Në këtë rast, njeriu me mbingarkesë të stresit sillet në mënyrë jo racionale dhe ai nuk bën atë që duhet për të përballuar stresin. Në këtë rast njeriu mund të pijë alkool, drogë dhe sillet me irritim me të tjerët.
5. **Kulmi i agresivitetit** është pika kur janë grumbulluar aq shumë faktorë stresues, sa dikush është gati për të shpërthyer në mënyrë të dhunshme, si: përdhunimi, vetëvrasja, ikja nga shtëpia, zënie, vrasjet etj.



Stresi tek nxënësit mund të shkaktohet nga:

- **Presioni nga familja**

- ☐ Grindje me motra, vëllezër ose prindër;
- ☐ Shumë përgjegjësi, si për shembull, përkujdesja për motrat, vëllezërit më të vegjël

ose të mbash shtëpinë, megjithëse i ke prindërit;

- ☐ Rezultatet, që familja pret në shkollë;
- ☐ Jetesa me shumë njerëz në një shtëpi, mungesa e një mjedisi ku i riu të mësojë etj;
- ☐ Dhunë në familje;
- ☐ Një anëtar i familjes është alkoolist ose përdor drogë;
- ☐ Abuzim seksual.

• Stres në shkollë

- ☐ Presion për rezultate të larta;
- ☐ Mbingarkesa e programeve mësimore;
- ☐ Përballja me etiketime të tilla si “dembel”, “dështak”, “rrugaç”, etj;
- ☐ Klasa të mëdha, ku jepet pak vëmendje individuale nga mësuesit;
- ☐ Mërzitje;
- ☐ Të ndihesh i parespektuar nga ndonjë nxënës në klasë;
- ☐ Konflike karakteri me mësuesit ose me të rriturit e tjerë.

• Presioni nga bashkëmoshatarët

- ☐ Preokupimi për të qenë i pëlqyeshëm dhe i pranueshëm prej tyre;
- ☐ Presion direkt ose indirekt nga shokë. **Kulmi i** filluar marrëdhëniet seksuale, për të përdorur substanca të rrezikshme, **agresivitetit** diçka të ndaluar etj;
- ☐ Dhunë, zënie me grushta dhe zërë “ ” se me armë.

Mbingarkesë

• Stres nga media

- ☐ Dhunë në film, televizion dhe në internet. **Stresi fizik**
- ☐ Reklama që i shtynjë nxënës të konsumojnë produkte të caktuara. **Stres i shumëfishtë**
- ☐ Shtimi i temave seksuale në film, televizion, magazinë e libra, gjë që i shtyn nxënës të eksperimentojnë sjellje të tilla.

Stresi

4.3 Veprimtari me nxënës..

Tema: Stresi

Mjetet: Materiali ndihmës për mësuesin “Stresi”, tabakë letre ose tabelë dhe shkumës.

Koha: 45 minuta

Qëllimi: Identifikimi i streseve, që mund të grumbullohen e të shkaktojnë shpërthime dhe që janë faktorë që ndikojnë në trafikimin e fëmijëve.

Metodat: leksion, punë në grupe dhe diskutim i lirë.

Plani i veprimtarisë:

Hapi i parë:

Shpjegoni materialin ndihmës për mësuesin “Stresi”, (sqaroni tre llojet e stresit duke përdorur shembujt e vetë nxënësve). Vizatoni në tabelë ose në tabakun e letrës ilustrimin “Vullkani i agresivitetit” dhe shpjegoni nivelet e stresit. Gjatë sqarimit të këtij informacioni, i rikujtoni nxënësve se është e rëndësishme që kur dikush të lëndon ose të inatos, duhet të flisni dhe të shpreheni hapur dhe me këmbëngulje, në mënyrë që të shmangni grumbullimin e inatit deri në shpërthim. Gjithashtu, vini në dukje se shumë gjëra bëjnë që ndjenjat të grumbullohen dhe të çojnë në inat. Të quajtura “stresuese” këto përfshijnë çdo gjë që ndodh në jetë dhe që shkakton tension. U thoni atyre që ata që, kohët e fundit, janë ndjerë të stresuar, të ngrenë duart. Kërkojini atyre që të përmendin faktorët që e shkaktojnë këtë stres.

Hapi i dytë:

Ndani nxënësit në 5 grupe. Secilit grup jepini detyrat si më poshtë:

Grupi 1. Të shkruajnë shembuj të stresit të nivelit të parë nga përvoja e tyre.

Grupi 2. Të shkruajnë shembuj të stresit të nivelit të dytë, përsëri nga përvojë e tyre.

Kështu do të vazhdoni edhe me grupet e tjera, derisa të arrini tek grupi 5, i cili do të japë shembuj të kulmit të agresivitetit.

Mbasi nxënësit punojnë 10 minuta, më pas çdo kryetar grupi prezanton punën e grupit të tij.

Hapi i tretë:

Përfundoni aktivitetin me çështjet për diskutim.

1. Cilat janë shenjat që tregojnë se po fillon të grumbullohet stres? (Përgjigjet mund të jenë: nuk ke durim dhe reagon në mënyrë negative ndaj të tjerëve; gjëra të vogla që zakonisht nuk të shqetësojnë, bëhen shumë shqetësuese; shpatullat kontrahohen ose nuk ndiheni mirë nga stomaku; shpërqëndroheni lehtë dhe nuk arrini të përfundoni asgjë).
2. Si mund ta ulni stresin kur fillon të grumbullohet? (Përgjigjet mund të jenë të ndryshme. Mësuesi mund të prezantojë projekte të shkollave pilot, që janë të pajisura me punonjës socialë ose psikologë.)
3. Si mund ta kuptoni se një shok ose shoqe është në fazën e mbingarkesës me stres? (Përgjigje: ndryshimet në sjellje, si mospërgatitje e mirë në mësim, ndryshimi i sjelljes në familje ose shoqëri; shtimi i pirjes së duhanit ose i pijeve alkoolike; përdorimi i drogës, mohimi i stresit dhe pesimizmi). Çfarë mund të bëni për të ndihmuar?

4.4 Mbi realizimin e edukimit antitrafik në shkollë

• 4.4.1 Integrimi i edukimit antitrafik në planin dhe programin shkollor

Në këtë pjesë të manualit jemi ndalur për të përshkruar mënyrat si duhet punuar që nxënësit të mund të marrin informacione të sakta mbi trafikimin dhe pasojat e tij, të

kuptojnë vlerat dhe pikëpamjet e tyre, si dhe të fitojnë aftësi personale, që nevojiten për t'iu shmangur rrezikut të trafikimit. Zakonisht nuk mjafton që trafikimin ta trajtojmë si një dukuri të veçantë, do ishte efektive forma kroskurrikulare e trajtimit. Sipas kësaj mënyre, edukimi mbi parandalimin e trafikimit duhet të integrohet midis fushave të kurrikulit shkollor, siç janë lëndët shoqërore, shëndetësore, artet, letërsia, shkencat, gjeografia etj. Mesazhet për parandalimin e trafikimit bëhen më të fuqishme në qoftë se përsëriten në kontekste të ndryshme.

Tre janë modelet kroskurrikulare që mund të zbatohen.

T'i shtjellojmë ato:

Modeli 1: Ndërkurrikulare në bazë klase.

Bazohet në studimin e çështjes paralel në të gjitha lëndët mësimore që nxënësit e një klase studiojnë. Mësimdhënësit p.sh., që japin mësim në klasën e pestë, planifikojnë temat mësimore dhe qëllimet lidhur me trafikimin, që ata mund të mbulojnë gjatë mësimdhënies. Kjo formë ofron një bazë koherente, që ndihmon nxënësit të kuptojnë aspekte të ndryshme të çështjes së trafikimit. Grupi i punës antitrafik në shkollë merr pjesë në këtë programim nga mësuesit lëndor, me udhëzimet dhe kujdesin për zbatimin cilësor të tematikës së caktuar.

Modeli 2: Ndërkurrikulare në bazë shkolle.

Bazohet në të mësuarit me anë të projektit. Shkolla p.sh., ka ndërmarrë një projekt një, dy a më shumë vjeçar, në lidhje me trafikimin. Në lidhje me projektin, hartohen planet vjetore të punës, ku përfshihen një sërë detyrash, që do të realizohen në një periudhë dy-tre javore të vitit. Nxënësit shprehin dëshirën të jenë bashkëpunëtorë në realizimin e njëres nga detyrat antitrafik të planifikuara, duke punuar kështu në grupe pune me nxënës të klasave të ndryshme. Lëndët mësimore me tematikat që studiojnë, përfshihen sipas përkatësive në realizimin e detyrave të projektit.

Modeli 3: Programe aktivitesh në bazë shkolle.

Në këtë model, edukimi antitrafik mbulohet të gjitha klasat e shkollës gjatë gjithë vitit. Aktivitete të tilla janë p.sh., bisedat me përfaqësues të luftës antitrafik, ndjekja e organizuar e emisioneve në median elektronike, një konkurs midis klasave për vizatimin ose shkrimin më të mirë kundër trafikimit, vajtje e organizuar në një aktivitet artistik antitrafik etj. Megjithatë nuk ekziston një metodë, që të tregojë cilat lëndë duhet të kontribuojnë dhe në ç'periudhë kohore mund të organizohen aktivitetet e përbashkëta me të gjithë nxënësit e shkollës. Shkollat vetë përcaktojnë llojet e aktiviteteve që do të ndërmarrin, kohën e realizimit të tyre në përputhje me kushtet dhe burimet, që çdo shkollë zotëron. Është e mira që shkolla të ndërthurë të tre modelet kroskurrikulare për arritjen e synimeve të saj antitrafik.

• 4.4.2 Modeli i integrit

Një shembull integrimi të veprimtarive antitrafik në kurrikulën shkollore, i propozuar nga një grup mësuesish dhe njësi të ndryshme të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (njësia e kurikules dhe plan-programeve, njësia për të drejtat e njeriut, etj.) është paraqitur më poshtë. Në shkollat tuaja ju mund të hartoni një plan integrimi në përputhje me nevojat dhe problemet që keni.

Kritere për përzgjedhjen e temave:

- Temat janë përzgjedhur nga programi aktual zyrtar i lëndës “Edukatë qytetare”, “Biologji”, “Histori ” dhe “Gjehorafi”, që realizohen në arsimin e ulët, të mesëm, dhe të mesëm të lartë, me nga një ose dy orë në javë.
- Këto lëndë janë parë të arsyeshme të përdoren si shtrat i mundshëm, për të prekur çështjet që lidhen me trafikimin dhe synojnë të trajtojnë çështje që e ndihmojnë nxënësin të njohë më shumë veten, mjedisin social, rreziqet me të cilat përballet etj.

Konkretisht synojmë të ndihmojmë nxënësin:

- Të informohet mbi fenomenet e trafikimit, të migracionit jo të rregullt, si dhe pasojat e tyre;
- Të rrisë respektin për veten;
- Të formulojë qëllimet për veten;
- Të marrë vendime për veten;
- Të informohet rreth procesit të HIV/AIDS dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme;
- Të manaxhojë stresin.

Lëndët e mësipërme janë përzgjedhur si të mundëshme për objektin shkencor dhe social që kanë dhe çështjet që trajtojnë. Këto lëndë janë zgjedhur për faktin se, mësuesit që i zhvillojnë, kanë ekspertizën dhe trajnimet e nevojshme dhe të mundshme për të trajtuar në dimensionet e duhura këto çështje.

Lloji i veprimtarisë që rekomandojmë të aplikohet nga mësuesit, nuk është vetëm brenda kurrikulës dhe vetëm brenda orës 45 minutëshe, por, sugjerojmë të jetë kroskurrikulare dhe ekstrakurrikulare, vizita pune të nxënësve dhe përfshirje e ekspertit të jashtëm në procesin mësimor, siç mund të jenë punonjës të gjykatave, të rendit, punonjës të qendrave për punë sociale, shoqata të ndryshme vendore e ndërkombëtare etj. Për trajtimin sa më konkret dhe të natyrshëm të çështjeve që lidhen me trafikimin, rekomandojmë që mësuesit sidomos të fokusohen në trajtimin e informacionit që vjen nga media vizive dhe e shkruar. Shtypi duhet të bëhet objekt hulumtimi nga nxënësit nën drejtimin e mësuesve për të trajtuar çështje që lidhen me opinionin dhe faktin dhe sa janë njerëzit viktimë të opinionit mediatic në këtë rast. Si metoda për trajtimin e çështjeve që lidhen me trafikimin kemi përzgjedhur: pyetësorin, intervistën, diskutimin që zgjidh problemin, situatat e rastit, dhe histori njerëzore.

Temat që trajtojnë çështjet si: familja si institucion, është parë e arsyeshme të bëhen shtrat ku të diskutohet për çështjet e trafikimit, pasi faktet na çojnë tek nevoja për të trajtuar statusin e fëmijëve në familje, si dhe sa e gjejnë fëmijët veten në familjet e tyre, cilat janë kontradiktat që kanë prindërit me fëmijët, të cilës natyrë janë dhe pse... etj. Gjatë programit të trajnimit pjesëmarrësit do të përfshihen

në veprimtari “akullthyesë”, që i paraprijnë dhe stimulojnë realizimin e programit në tërësi. Gjatë trajnimit do të fokusohemi dhe tek faktet që vijnë nga shtypi i përditëshëm, për t'i analizuar dhe ballafaquar faktet me legjislacionin tonë dhe atë ndërkombëtar e lokal.

Faktet na çojnë në përfundimin se një fëmijë tenton të gjejë “zgjidhje” në rrugë, pasi nuk gjen hapësira në familjen e vet.

Tabela që pason, përfshin vetëm disa nga klasat dhe temat ku mund të ndërhyhet për të realizuar veprimtaritë. Gjithsesi, mësuesit janë të lirë të gjejnë vetë hapësira për të realizuar veprimtari, që prekin çështje të trafikimit. Temat që pasojnë nuk janë të detyrueshme për t’u zbatuar, ato vetëm sa orientojnë mësuesit se ku është me e mundshme dhe e arsyeshme të preken çështje e trafikimit.

Lënda	Klasa	Tema
Gjeografi	6-të	“Numri dhe dendësia e popullsisë” (60) “Shtimi natyror, dendësia dhe migrimet e popullsisë” (61)
Edukata Qytetare	6-të	“Dokumentet e identitetit personal” (11); “Shëndeti, HIV/AIDS-përhapja dhe pasojat” (25); “Ligji-Llojet dhe funksioni i ligjeve”(32); “Diskriminimi dhe paragjykimi” (64-65); “Liria dhe përgjegjësia “(72); “Sistemi i vlerave “(78);
Edukata Qytetare	7-të	“Roli i shoqërisë Civile” (19); “Familja” (27-30); “Shtëpia” (31-33); ” Përdorimi i mediave si burim informacioni” (46); “Si të lexohet një artikull”(47); “ Të dallojmë faktin nga opinioni “(48); “Çfare rrezikon shëndetin tonë” (57); “Mbrojtja e qytetarëve” (65); ” Si të bëjmë një fushatë” (73); “Vlerësoni vetveten” (76); “Pushteti gjyqësor” (108);
Historia	7-të	“Pengmarrja dhe rekrutimi i fëmijëve shqiptarë në ushtrinë Osmane” (59); “Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe qytetarit” (137);
Edukata Qytetare	9-të	“Shkolla dhe komuniteti” (5) ; ”Informimi dhe mjetet e komunikimit masiv” (6); “Llojet e ligjeve dhe përgatitja e tyre”(18); Tema “AIDS-sëmundje e shekullit” (29); “Kufizimi i të drejtave ” (71); “Liria dhe përgjegjësia “(72); “Të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut dhe vlerat morale e filozofike “(61);

Biologji	9-të	“Zhvillimi i seksit”(133); “Baza molekulare e trashëgimisë” (135); Gjenet”(137);
Edukata qytetare	10-të	Temat e përfshira në “doracakun për mësimdhënës” janë të përfshira në librin ekzistues të lëndës Edukata Qytetare për klasën e 10-të, por duhet të trajtohen si të integruara/ndërlidhura në mes tyre.
Edukata qytetare	11-të	Marrja e vendimeve (72) Jeta në komunitet (76) Përfshirja e komunitetit në përmirësimin e jetës (81) Të drejtat e njeriut (107) Llojet e ligjeve (135) Krimi dhe format e tij (142) Trafikimi i qenieve njerëzore (163) Ligji për trafikimin (167) Ndryshimi i familjes (170) Ligji në familje (180) E drejta për jetë private (187) Dhuna në familje (191) Abuzimi i fëmijëve dhe llojet e tij (195) Masat e parandalimit dhe rehabilitimi i fëmijëve të abuzuar (204) Dallimi i faktit nga opinioni (220) Leximi i një artikulli në gazete (222)

Sigurimi i informacionit

Fëmijët dhe adoleshentët kanë nevojë për informacione të sakta mbi trafikimin, në mënyrë që të jenë të mirëinformuar dhe mbrojtur prej tij. Nxënësit duhet të kuptojnë trafikimin dhe pasojat serioze të tij, ata duhet të dinë se sot në Kosovë ekziston një rrjet i organizuar i shitjes së paligjshme të njerëzve, në veçanti të vajzave. Ata duhet të kuptojnë, gjithashtu, lidhjet që ekzistojnë midis qenieve të trafikuar dhe drogës, sidës e infeksioneve seksualisht të transmetueshme.

Shpesh, tek vajzat e trafikuar ndodhin lëndime fizike, dhe kjo nuk ndodh vetëm nga klientët, por dhe nga tutorët e tyre. Nxënësit duhet të ndërgjegjësohen se trafikimi i fëmijëve dhe vajzave, është akoma një rrezik i niveleve të larta dhe që ta parandalojnë duhet të sigurojnë një sjellje dhe qëndrim të sigurt e të shëndetshëm.

Atyre duhet t’u jepet informacioni i nevojshëm për pasojat e trafikimit, rrugët e mundshme përmes së cilave funksionon, legjislacionin në fuqi kundër tij, institucionet vendase që punojnë për parandalimin, mjetet dhe rrugët mbrojtëse, dhe si të ndihmojmë për parandalimin e tij në shkollën dhe rajonin rreth nesh, apo si të ndihmojmë viktimat e trafikimit. Përmes këtij informacioni nxënësit inkurajohen të marrin hapa drejt parandalimit të trafikimit në përgjithësi, dhe në komunitetin e tyre në veçanti, si dhe të zgjerojnë njohuritë mbi sistemin ligjor të drejtësisë.

Studime në zonat problematike të trafikimit dëshmojnë për informim dhe ndërgjegjësim të pakët të popullatës në lidhje me problemin e trafikimit.

Informacioni nuk është kurrë i mjaftueshëm; fëmijët dhe të rinjtë, prindërit dhe komunitetet duhet të informohen më shumë në mënyrë që të kuptojnë situatën.

Përdorimi i shembujve konkretë të rasteve të trafikimit, ndërgjegjëson më mirë nxënësit dhe familjarët mbi rrezikun e madh të trafikimit. Ata do të ishin më të mbrojtur, nëse do të kishin më shumë dijeni për mënyrat që përdoren për trafikim si dhe vuajtjet e shkaktuara prej tij.

Informimi nuk duhet të ndalet vetëm për metodat e trafikimit dhe rekrutimit, por gjithashtu dhe për atë që i ndodh viktimave kur shkojnë jashtë shtetit, kushtet e punës, dhunën e protektorëve. Rritja e ndërgjegjësimi është arsyeja domethënëse për pakësimin e numrit të të rekrutuarve, por njohuritë më të plota mund të frenojnë gjithashtu edhe rastet kur shkojnë vullnetarisht.

Fushata vendore e mediave kundër trafikimit, posterat e fletëpalosjet, janë dhe ato mënyra që çojnë në informimin rreth problemit të trafikimit dhe rrugëve të parandalimit të tij. Shkolla duhet të bashkërendojë informacionin e saj me atë të mediave për të arritur një informim më të mirë të nxënësve

TRAFIKIMI DHE HIV/AIDS, SI DHE INFEKSIONET E TJERA SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

5. 1. Informacion i Përgjithshëm

Nevoja për edukimin e të rinjve mbi AIDS po fiton gjithnjë e më shumë terren. Sidomos fakti, që marrëdhëniet seksuale ndërmjet klientëve dhe viktimave të trafikimit, në shumicën dërmuese të rasteve kryhen pa mbrojtje, duke rrezikuar infektimin dhe HIV/AIDS dhe IST, do të thotë se mbrojtja dhe parandalimi i këtyre infeksioneve ka rëndësi parësore dhe duhet diskutuar me nxënësit. Studimet tregojnë se edukimi mbi seksin dhe AIDS, ka aftësinë të sjellë si rezultat vonimin e fillimit të marrëdhënieve seksuale e njëherazi edhe përdorimin e praktikave më të sigurta seksuale tek ata nxënës, që tashmë kanë filluar marrëdhënie të tilla. Ky material është hartuar për t'u ardhur në ndihmë mësuesve, për të hartuar programe edukative mbi HIV-in, AIDS dhe SSI (Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme), që përfshijnë nxënësit e moshës nga 12 deri në 16 vjeç. Materiali që paraqitet, mbështetet në metodat e aktivizimit të nxënësve, metoda që praktika i ka vërtetuar si veçanërisht të efekshme për edukimin e nxënësve me aftësitë e duhura të sjelljes.

• 5.1.1 Konteksti për edukimin mbi HIV/AIDS dhe IST (Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme)

Idetë dhe veprimtaritë që paraqiten në këtë material, përqendrohen veçanërisht në veprimtaritë që lidhen me AIDS. Mirëpo AIDS nuk mund të shihet i shkëputur nga një gamë e gjerë problemesh, siç janë alkooli dhe drogat e tjera, prostitucioni i moshave të vogla, shtatzanitë në moshat e adoleshencës, kushtet e një jetese në varfëri, dhuna dhe papunësia. Në të vërtetë shumë nga aftësitë dhe qëndrimet që u duhen të rinjve për të

parandaluar infektimin nga AIDS dhe IST, janë në vetvete aftësi jetike, pasi ato janë të domosdoshme për të përballuar me efektivitet një sërë problemesh të tjera, me të cilat ata do të ndeshen gjatë rritjes së tyre.

Në veçanti, programi edukativ që trajton IST, HIV-in dhe AIDS shtron si kërkesë, që nxënësit të kenë një kuptim të qartë për zhvillimin e tyre fizik, seksual dhe emocional gjatë adoleshencës, në mënyrë që të jenë të aftë të fitojnë edhe një kuptim të qartë për aspektin seksual tek vetja e tyre dhe tek të tjerët. Është e rëndësishme të mos harrojmë, se rruga kryesore e tejçimit të HIV/AIDS janë marrëdhëniet seksuale, ku rreziku i infektimit bëhet edhe më i madh nga prania e IST. Nxënësit duhet të marrin njohuritë themelore lidhur me menstruacionet, marrëdhëniet seksuale, mbetjen shtatzanë dhe kontracepsionin (shmangien e shtatzanisë). Dhënia e mësimave të edukimit mbi HIV/AIDS dhe IST bëhet shumë më dobiprurëse, kur ky edukim shihet si komponent i edukatës shëndetësore, i edukatës seksuale, i lëndës së biologjisë apo dhe i lëndës së edukatës qytetare.

• 5.1.2 Etapat kryesore të programit për edukimin mbi HIV/ AIDS dhe IST

1. Përcaktimi i tipit të programit.
2. Përzgjedhja e objektivave.
3. Hartimi i planit në bazë të programit shkollor.
4. Hartimi i udhëzuesit për mësuesit.
5. Hartimi i veprimtarive të nxënësve.
6. Kualifikimi i mësuesve.
7. Zbatimi i programit.
8. Vlerësimi i programit.

• 5.1.3 Tipi i programit

Shumë programe që trajtojnë parandalimin e AIDS dhe IST përqëndrohen vetëm në të dhënat biomjeksore, në ato që kanë të bëjnë me virusin që shkakton AIDS, sistemin imunitar, shenjat dhe simptomat e AIDS dhe me trajtimin mjekësor të tij. Tashmë, dihet mirë se nuk është e mjaftueshme që vetëm t'i bindim të rinjtë që të edukohen me sjellje pozitive, të shëndetshme, për të parandaluar infektimin nga HIV/AIDS dhe IST. Ata kanë nevojë si për t'i motivuar veprimet e tyre, ashtu edhe për të qenë në gjendje që njohuritë e fituara t'i kthejnë në praktikë.

Infeksioni nga HIV-i dhe nga sëmundjet IST ndodh në rrethana të veçanta, të mbarsura me rrezik: kur një vajze i imponohet kryerja e aktit seksual nga miku i saj ose nga një mashkull më i madh në moshë, kur një shiringë që përmban drogë i jepet një shoku etj. Në këto rrethana, për të ruajtur shëndetin e tyre, të rinjtë duhet patjetër të dinë dhe të kenë zotësinë të thonë “jo”, të dinë se çfarë alternativash të propozojnë si dhe të vlerësojnë rreziqet e mundshme. Në qoftë se nxënësit, gjatë mësimin, do të mësojnë vetëm të dhënat mbi sistemin imunitar, ata do të jenë të papërgatitur për të përballuar situatat reale me të cilat mund të ndeshen. Mos të harrojmë se qëllimi i edukimit për

AIDS dhe IST është që nxënësit të fitojnë sjellje, që parandalojnë tejçimin e HIV/AIDS dhe IST, dhe jo thjesht dhënia e sa më shumë njohurive rreth kësaj sëmundjeje. Prandaj programi që propozojmë do të synojë shtimin e njohurive, zhvillimin e aftësive, nxitjen e qëndrimeve pozitive dhe të përgjegjshme të nxënësve.

• 5.1.4 Njohuritë

Informacione të dobishme, për t'i ndihmuar nxënësit, që të vendosin se cilat sjellje janë të përgjegjshme dhe në dobi të shëndetit, janë:

- Zhvillimi fizik dhe seksual i adoleshentëve
- Dallimi midis HIV-it dhe AIDS
- Rrugët në të cilat HIV dhe IST tejçohen
- Rrugët në të cilat HIV dhe IST nuk tejçohen
- Mjetet e mbrojtjes nga HIV / IST
- Si të sillemi me njeri të sëmurë me AIDS

• 5.1.5 Zhvillimi i aftësive

Aftësitë që lidhen me sjelljet mbrojtëse ndaj HIV/ AIDS dhe IST janë:

Marrja e vendimit

- Vendosmëria për t'i bërë ballë trysnive të bashkëmoshatarëve për të përdorur drogë ose për të kryer marrëdhënie seksuale;
- Aftësitë komunikuese që mundësojnë një siguri më të madhe në marrëdhëniet seksuale; Aftësitë praktike për përdorimin me efektivitet të prezervativëve.

Këto aftësi fitohen nëpërmjet mësimave ushtrimore simulative ose nëpërmjet luajtjes së roleve të ndryshme (inskenimeve) të situatave, që, në jetën reale, do t'i kërcënonin të rinjtë me rrezikun e infektimit nga HIV/ AIDS dhe IST.

Qëndrimet

Qëndrimet rrjedhin nga bindjet, ndjenjat dhe nga vetëvlerësimet. Edukimi mbi HIV/ AIDS dhe IST duhet të nxisë:

- Qëndrimet pozitive kundrejt vonimit (shtyrjes) të kryerjes së marrëdhënieve seksuale;
- Përgjegjshmërinë vetiake për kryerjen e marrëdhënieve seksuale
- Përdorimin e prezervativëve;
- Kapërcimin e paragjykimeve të ndryshme;
- Qëndrimet kundër marrëdhënieve seksuale me partnerë të shumtë apo marrëdhënie seksuale të dhunshme dhe jo normale;

- Ndjenjën jo vetëm për të mos u kthyer krahët njerëzve të infektuar nga HIV-i ose të sëmurë nga AIDS, por, përkundrazi, për tu treguar të durueshëm dhe dashamirës me ata.

Mbështetje nxitëse

Edhe një njeri i mirëinformuar dhe me aftësi, ka nevojë për të ndërmarrë veprime të parrezikshme, ashtu edhe për t'iu përmbajtur kësaj praktike. Një kuptim realist nga ana e nxënësit për rrezikun, të cilit ai i ekspozon veten, si dhe dobitë e përdorimit të shprehive parandaluese janë të lidhura ngushtë me nxitjen. Përforcimi dhe mbështetja, që bashkëmoshatarët i japin shokëve të tyre në praktikimin e veprimtarive të dobishme për shëndetin, ka rëndësi vendimtare për arsye se normat që vendosin ata ndërmjet tyre janë nxitës të fuqishëm për sjelljet e të rinjve. Për shkak se bashkëmosharët e njohin më mirë mënyrën e të folurit dhe kulturën e njëri-tjetrit, programet që i kushtojnë vëmendje udhëheqësve të bashkëmosharëve, janë mjaft të frytshëm. Por objektivat e programit mund të motivohen dhe të përforcohen edhe nga prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, ndaj edhe këta duhen nxitur për të luajtur rolin e tyre në edukimin seksual të fëmijës. Duke pasur parasysh se çelësi i parandalimit të HIV/AIDS dhe IST janë sjelljet (shprehitë) e përgjegjshme, objektivat që do të parashtrojmë më poshtë, konsiderohen si kërkesa minimale për cilindo program që ka të bëjë me to.

Në fund të realizimit të programit nxënësit do të kenë fituar këto aftësi:

- Të bëjnë dallimin midis HIV/AIDS dhe IST;
- Të përcaktojnë se në cilat rrugë mund të tejçohet HIV/ AIDS dhe IST;
- Të përcaktojnë se në cilat rrugë nuk mund të tejçohet HIV/ AIDS dhe IST;
- Të rendisin metodat e parandalimit të HIV/ AIDS dhe IST në bazë të efektivitetit të tyre;
- Të përvetësojnë arsyet pse duhen vonuar në kohë marrëdhëniet seksuale;
- T'u përgjigjen në mënyrë të prerë trysnive për marrëdhënie seksuale;
- Të diskutojnë rreth arsyeve dhe metodave se pse dhe si duhen vonuar në kohë marrëdhëniet seksuale;
- Të diskutojnë rreth arsyeve dhe metodave se pse dhe si duhen kryer marrëdhëniet seksuale me mjete mbrojtëse në rastet kur nuk janë në gjendje të shmangin kryerjen e tyre;
- T'u përgjigjen në mënyrë të prerë trysnive për të kryer marrëdhënie seksuale pa mjete mbrojtëse;
- Të përcaktojnë se në ç'mënyrë mund të shprehin dashamirësi dhe solidaritet ndaj njerëzve seropozitivë ose të sëmurë me AIDS.

• 5.2. Njësitë e Programit

Programi që paraqitet në këtë material përbëhet nga katër njësi, ku për secilën propozohen një numër veprimtarish për t'u zhvilluar brenda klasës (që shoqërohen me udhëzues për mësuesit për secilën prej tyre).

Njësitë janë hartuar në përshtatje me nivele të ndryshme njohurish, qëndrimesh, aftësish dhe stadesh të zhvillimit të nxitjeve.

Njësia 1 – Njohuritë bazë mbi HIV/AIDS dhe IST

Në këtë njësi theksi vihet më shumë mbi: ç'janë HIV/ AIDS dhe IST, tejçimi i tyre, mbrojtja prej tyre. Në këtë njësi trajtohen objektivat 1–4.

Njësia 2 – Sjelljet e përgjegjshme: vonimi i marrëdhënieve seksuale

Nxënësit, veçanërisht në moshat e hershme, duhet të nxiten të mos kryejnë marrëdhënie seksuale. Shtyrja e tyre për deri në një moshë më të rritur, zakonisht, jep si përfundim marrjen e vendimeve më të pjekura në lidhje me kontracepsionin dhe me mjetet e tjera të mbrojtjes seksuale. Nxënësit duhet t'i kenë të qarta arsyet pse duhet t'i vonojnë marrëdhëniet seksuale, si dhe të mësojnë se si t'i bëjnë ballë trysnive për kryerjen e aktit seksual pa mjete mbrojtëse. Aftësitë, që lidhen me një mënyrë të qartë dhe të prerë komunikimi, duhet të mësohen nëpërmjet inskenimeve të situatave jetësorë, me të cilat mund të ndeshen të rinjtë. Ata gjithashtu mund të mësojnë se dashuria mund të shprehet edhe me mënyra të tjera, përveç atyre seksuale.

Në këtë njësi trajtohen objektivat 5,6,7.

Njësia 3 – Sjelljet e përgjegjshme: marrëdhëniet seksuale me mjete mbrojtëse

Në kohën që nxënësit marrin mësimet për AIDS që përfshin ky program, ka mundësi që disa prej tyre, mbase, tashmë kanë hyrë në rrugën e kryerjes së marrëdhënieve seksuale. Të tjerët kanë nevojë të dinë se si mund të mbrojnë veten në të ardhmen, kur edhe ata do të hyjnë në këto marrëdhënie. Përdorimi i prezervativëve në çdo kryerje të aktit seksual është një mënyrë mjaft e efekshme për të shmangur infektimin nga HIV/ AIDS dhe IST. T'u japësh nxënësve njohuri për kontracepsionin dhe prezervativat, nuk do të thotë aspak se i nxit për të kryer aktin seksual; të rinjtë i marrin të dhënat për prezervativat nëpërmjet një larmie burimesh (nga miqtë, media, reklamat, etj.), kështu që dhënia e këtyre njohurive është e nevojshme që ata të fitojnë aftësitë e duhura për t'i përdorur prezervativat siç duhet.

Në këtë njësi mbulohen objektivat 8 dhe 9.

Njësive 2 dhe 3, të cilat trajtojnë sjelljet e përgjithshme, duhet t'u kushtohet afro 50% e të gjithë kohës mësimore brenda klasës, që mund të parashikohet për të gjithë programin mbi HIV/ AIDS dhe IST. Kjo kërkesë shtrohet për arsye se të dyja këto njësi shtjellojnë kryesisht zhvillimin e aftësive dhe se ky proces kërkon më shumë kohë mësimore, se sa mësimi i fakteve.

Njësia 4- Kujdesi dhe mbështetja e njerëzve të sëmurë nga HIV/ AIDS

Shumë të rinj do të bien në kontakt me njerëz të infektuar dhe të sëmurë me AIDS, të cilët ka të ngjarë të jenë edhe brenda familjeve apo dhe të lagjes së tyre. Është e nevojshme që këtyre të rinjve t'u mësohet të jenë të durueshëm me ta, të jenë dashamirës dhe të gjejnë mënyrat e duhura për të qenë krah tyre. Kjo njësi mbulon objektivin e 10-të. Për çdo njësi propozohet të kryhen një numër veprimtarish me nxënësit. Më poshtë, po japim sipas objektivave informacione për mësuesit dhe veprimtari për nxënësit.

• 5.3 Materiale në ndihmë të mësuesit

AKTIVITET

Njohuritë bazë mbi HIV/AIDS dhe IST (Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme)

Ç'tregojnë termat HIV dhe AIDS?

HIV do të thotë Virusi i Imunodeficiencës njerëzore (prek sistemin imunitar të njeriut) dhe, nga anglishtja, inicialet janë si më poshtë:

H - Human (Të njeriut)
I - Immune deficiency (Dobësim i madh i sistemit imunitar)
V - Virus (Virus)

AIDS do të thotë: Sindromi i imunodeficiencës së fituar, në anglisht inicialet janë si më poshtë.

A - Acquire (I fituar gjatë jetës, jo i trashëguar)
I - Immune (Sistemi imunitar)
D - Deficiency (Dobësim i madh)
S - Syndrome (Tërësia e simptomave dhe shënjave)


AIDS-i është një sëmundje që vjen nga shkatërrimi i sistemit imunitar prej virusit të quajtur HIV. AIDS është termi që përdoret për të treguar shkallën më serioze të infektimit të personit me HIV. Shumë persona të infektuar me HIV janë mirë, duken mirë dhe mund të vazhdojnë kështu për vite, por sidoqoftë, edhe pse me pamje të shëndoshë, ata mund të infektojnë të tjerë. Shpejt ose vonë shumica e personave të infektuar me HIV do të zhvillojnë AIDS-in.

Virusi HIV, siç e tregon dhe vetë emri, sulmon sistemin imunitar. Njerëzit me AIDS preken nga sëmundje të cilat një sistem imunitar i shëndoshë mund t'i luftojë si p.sh., forma të rralla tumoresh apo pneumonish.

• Si është i ndërtuar virusi i AIDS ?

I pari virus përgjegjës për AIDS-in që u arrit të veçohet (HIV 1) përbëhet nga ARN dhe mbështjellja proteinike. ARN përmban kodin gjenetik të virusit. Këto vishen nga një cipë me përzierje yndyrore e proteinike. Proteinat e cipës janë të rëndësishme, sepse në sajë të tyre virusi mbërthehet pas linfociteve T4. Disa pjesë të caktuara të proteinave të cipës, shkaktojnë një përgjigje të fortë imunitare. Këto pjesë janë të domosdoshme për përpunimin e një vaksine për të ardhmen. E veçanta e këtij virusi është se në sipërfaqen e proteinave ka një lakore, që shkakton prodhimin e antikorpeve specifike të cilat asgjësojnë për një fare kohe aftësinë infektuese të virusit.

Prezantimi i virusit HIV



HIV-i dhe sistemi imunitar


Sistemi imunitar është mbrojtja e organizmit ndaj infeksioneve e sëmundjeve. Ai sulmon e shkatërron bakteret, viruset etj. të cilët janë të aftë që në kushte të caktuara të sulmojnë organizmin.

Sistemi imunitar vepron në të gjithë organizmin, sidomos në sajë të disa llojeve të veçanta qelizash, të quajtura limfocite. Ka dy tipe limfocitesh: limfocite T dhe limfocite B, që veprojnë në mënyra të ndryshme. Një lloj i veçantë i limfociteve T janë limfocitet T4, të cilat luajnë rolin e “gjeneralit” në veprimet mbrojtëse të organizmit. Kur një antigen (virus, bakter etj.) hyn në organizëm, ai njihet nga limfocitet T4, të cilat japin alarmin dhe aktivizojnë limfocitet T dhe B. Limfocitet T sulmojnë

drejtpërdrejt, ndërsa limfocitet B prodhojnë disa substanca të quajtura antikorpe, të cilat sulmojnë antigenet dhe i asgjësojnë ato. Antikorpët janë specifike për çdo antigen. Prania e antikorpeve në organizëm tregon se ky antigen ka qenë mëparë. HIV ka aftësinë e sulmit të vazhduar të limfociteve T4.

Për të infektuar limfocitet T4, virusi HIV duhet të ndërfusë kodin e tij gjenetik të përbërë nga ARN në kodin gjenetik të limfociteve T4, të cilat janë të përbërë nga ADN. Dihet se këto dy molekula nuk perputhen midis tyre, prandaj HIV-it i duhet të shndërrojë kodin e tij gjenetik të përbërë nga ARN në kod gjenetik të përbërë nga ADN. Kjo bëhet në saj të një enzime të veçantë që e ka virusi i AIDS-it, e cila quhet *transkriptazë inverse*.

Patogjeneza e infeksionit HIV



Zakonisht ADN-ja transkriptohet në ARN, por transkriptimi i anasjelltë i ARN-së në ADN, ndodh dhe bëhet vetëm në qoftë se ekziston kjo enzimë e veçantë, që quhet transkriptazë inverse. Fatkeqësisht, virusi i AIDS-it e ka këtë enzimë. Me të ndërfutur kodin e tij gjenetik në kodin gjenetik të limfociteve T4, HIV-i fillon të shumohet në “kurriz” të limfoiteve T4, duke i asgjësuar ato. Në këtë mënyrë, sistemi imunitar dobësohet gradualisht, më parë se sa ai të organizojë mbrojtjen. Pra, pasi HIV hyn në qarkullimin e gjakut, penetron tek limfocitet T4, çahet cipa e tij, zbulohet ARN virale, e cila transkriptohet në ADN, futet në bërthamën e limfocitit dhe bëhet pjesë e kodit gjenetik të qelizës.

Janë të mundshme dy mënyra zhvillimi:

Mënyra 1:

Virusi qëndron i fjetur dhe qeliza T4 e infektuar vazhdon të jetojë normalisht, infeksioni është i pranishëm ndërkohë që personi i infektuar nuk paraqet simptoma. Qelizat T4 të infektuara të këtij njeriu mund të transmetohen (nëpërmjet gjakut ose sekrecioneve seksuale) në njerëz të tjerë duke i infektuar edhe këta të fundit.

Mënyra 2:

Virusi bëhet aktiv dhe shumohet brenda në qelizë, e cila më në fund çahet, duke çliruar sasi të mëdha virusi. Kur një numër i madh qelizash T4 shkatërrohen pas infektimit me HIV, mbrojtja imunitare e organizmit dobësohet shumë. Në këtë kohë shfaqen simptomat e AIDSit. Infektimi me HIV mund ta dobësojë sistemin imunitar deri në atë gradë, që e ka të vështirë të luftojë disa infeksione. Këto lloje infeksionesh njihen si infeksione “oportuniste”, sepse ato përfitojnë nga mundësia që iu jep sëmundjeve një sistem imunitar i dobësuar tashmë.

• Si zbulohet virusi i AIDS ?

Metoda indirekte:

Zbulon antikorpet e prodhuara nga organizmi, si reaksion ndaj pranisë të virusit HIV.

Antigenet (AK)	Antikorpet (AG-AK)	Formohet kompleksi (AG)
-------------------	-----------------------	----------------------------

Prania e antikorpeve zbulohet duke e lidhur këtë kompleks me një enzimë që shkakton ngjyrë. Trupit i duhet disa kohë, pas momentit të hyrjes së virusit, që të prodhojë antikorpet. Nëse testi zbulon antikorpet, personi i testuar quhet seropozitiv dhe është i infektuar me HIV. Nëse testi del negativ, personi i testuar quhet seronegativ dhe nuk është i infektuar me HIV.

Metoda direkte:

Zbulon virusin, duke bërë kulturën e limfociteve të infektuara, pra zbulohet antigeni viral në vend të antikorpeve. Metoda direkte ka lejuar zbulimin e pranisë të virusit në gjak, spermë, sekrecionet vaginale dhe rrallë herë në sasi shumë të vogla në pështymë.

• Si trasmetohet HIV ?

Transmetimi i HIV-it mund të bëhet nga marrëdhëniet seksuale të pambrojtura. Është e rëndësishme që të dimë se cilat nga praktikat seksuale janë me rrezik për të marrë HIV-in dhe cilat jo.

a) Praktika seksuale të parrezikshme

Praktikat seksuale, që nuk paraqesin rrezik për infektimin me virusin HIV, janë: përqafimi, masazhimi, masturbimi, prekja e organeve seksuale.

b) Praktika seksuale që paraqesin rrezik

Përdorimi korrekt i prezervativit (kondomit), sa herë kryen marrëdhënie seksuale, e zvogëlon shumë rrezikun e marrjes së HIV-it. Mospërdorimi korrekt apo çarja e prezervativit paraqet rrezik të lartë. Marrëdhëniet seksuale me prezervativ përbëjnë atë që quhet “seks i mbrojtur”.

c) Praktika seksuale të pasigurta

Seksi vaginal pa prezervativ dhe çdo lloj tjetër akti seksual që mund të provokojë hemoragji. Ka të ngjarë që persona të caktuar të jenë më të rriskuar se të tjerët për të marrë HIV-in., por kjo varet nga sjellja e tyre, si p.sh:

- Njerëz që kanë shumë partnerë seksualë;
- Kryerja e marrëdhënieve seksuale të pambrojtura;
- Njerëz që bëjnë seks, ndërkohë që kanë një IST tjetër;
- Përdorimi i një shiringe për të injektuar drogë.

Përveç situatave të mësipërme, ekzistojnë situata të tjera pavarësisht nga ne, që na rrezikojnë:

- Përdorimi i një aqe/shiringe të pa sterilizuar për injeksione të ndryshme;
- Transfuzion me gjak të pakontrolluar.

Pyetje mbi mënyrat e tjera të tejçimit të HIV-it

a) A përhapet HIV-i nga prostitutat dhe klientët e tyre?

Prostitutat dhe klientët e tyre, ashtu si çdo njeri tjetër me shumë partnerë, rrezikohen për t'u infektuar e kështu mund të infektojnë edhe shumë të tjerë. Nëse prostituta përdor prezervativ gjatë aktit seksual, reduktohet rreziku i marrjes së HIV-it për të dhe për klientin e saj. Gjithashtu, shumë prostituta kanë zëvendësuar seksin penetrativ me mënyra të tjera më të sigurta. Për fat të keq, shumica e burrave nuk duan të përdorin prezervativë dhe pozita e prostitutës nuk të lejon të kundërshtosh e të këmbëngulësh. Duke qenë se viktimat e trafikimit detyrohen të prostitutojnë, ato janë në rrezik për t'u infektuar, infektion të cilin më pas mund ta përhapin tek të tjerët.

b) Merret HIV-i nga shiringat?

Shkëmbimi i gjilpërave, shiringave, e pajisjeve të tjera të ndotura përçon virusin HIV, sepse çdo lloj mjeti që shpon ose pret lëkurën mund të marrë një sasi gjaku e nëse ky gjak është i infektuar dhe mjeti nuk sterilizohet, virusi mund të trasmetohet tek një njeri tjetër. Evitoni shpimin e veshëve, tatuazhet, agopunkturën apo shkëmbimin e makinës së rrojes, nëse dyshoni se mjetet shpuese janë të pasterilizuara.

c) Përhapet HIV-i nga gjaku i infektuar?

Sasi të vogla gjaku ngelen në aqe dhe shiringë pas përdorimit të tyre e nëse dikush tjetër i përdor ato, gjaku i mbetur në shiringë do të kalojë në gjakun e tij. Kështu personi i dytë mund të marrë HIV-in, nëse i pari është i infektuar.

d) A trasmetohet HIV-i nga nëna e infektuar tek fëmija ?

HIV-i i kalon fetusit nëpërmjet kordës së kërkthizës, ndërkohë që fëmija është ende në barkun e nënës, nëpërmjet kontaktit me lëngjet e gjakun e vaginës gjatë lindjes, nëpërmjet

qumështit të gjirit. Por jo çdo fëmijë i lindur nga një nënë HIV+, do ta marrë virusin. Rreth 20-40 % e foshnjeve lindin të sëmura. Shumica e këtyre fëmijëve s'jetojnë më gjatë se 2 vjet, por ka që jetojnë edhe deri në 7 vjeç e ndoshta edhe më tepër.

e) A janë burrat dhe gratë njëloj të ndjeshëm fiziologjikisht për të marrë HIV-in?

Mendohet se gratë janë më të ndjeshme ndaj HIV-it se burrat, sepse sipërfaqja e mukozës që përfshihet gjatë ciklit seksual është më e madhe për gratë se për burrat. Vajzat e reja janë shumë më të ndjeshme ndaj HIV-it se gratë 20-45 vjeç, pasi qafa e mitrës së tyre ende e papjekur dhe prodhimi i pakët i seksrecioneve vaginale përbën një mbrojtje të pamjaftueshme për HIV-in.

f) Që të infektohesh me HIV/IST duhet të kesh shumë partnerë?

Ndonjëherë mjafton vetëm kontakti me një të infektuar që ju të merrni HIV/IST. Por, natyrisht, kontakti me shumë partnerë, rreziku është më i lartë.

• Si nuk transmetohet HIV ?

Nga prekja, të biseduarit ose të jetuarit në të njejtën shtëpi me një person të infektuar me HIV ose me AIDS;

- ☐ Përdorimi i enëve të kuzhinës ose i peshqirëve, që janë përdorur nga një person i infektuar;
- ☐ Përdorimi i pishinave, vaskave, çezmeve, tualeteve, dorezave të dyerve, telefonave.
- ☐ Nga pështyma, djersët ose lotët;
- ☐ Pickimi i insekteve, sepse HIV-i strehohet vetëm në qelizat e trupit të njeriut dhe jo në ato të insekteve apo të mushkonjave. HIV-i nuk është si paraziti i malarjes, që strehohet në traktin tretës të mushkonjës e përhapet me pickimin e saj;
- ☐ Teshtitja ose kollitja.

AKTIVITET

Sjelljet e përgjithshme: vonimi i marrëdhënieve seksuale

Arsyet për t'i thënë "jo" marrëdhënieve seksuale

Mësuesi sqaron si më poshtë:

Është mirë të mos kryeni marrëdhënie seksuale deri sa:

- ☐ Të jesh më i përgjegjshëm
- ☐ Të jesh më i pjekur
- ☐ Të kesh një lidhje të sigurtë me një njeri
- ☐ Të jesh i martuar

Pse?

Ka shumë arsye të forta për të refuzuar një kërkesë për marrëdhënie seksuale, të cilat po i rreshtojmë më poshtë:

1. Frikë nga shtatzania. Nëse nuk kryen marrëdhënie seksuale, je 100% i sigurtë.
2. Frikë nga IST dhe HIV-i, të cilat mund të merren gjatë një raporti seksual.
3. Dëshirat dhe besimi i prindërve. Ata nuk dëshirojnë që ju të kryeni marrëdhënie seksuale kaq të rinj.
4. Frikë nga dhuna. Ekziston gjithmonë mundësia e dhunës.
5. Miqësia. Kështu i jepni kohë vetes dhe partnerit të krijoni miqësi në fillim.
6. Ju ose partneri mund të jeni të pirë. Alkooli ju bën të merrni vendime të pamenduara.
7. Nuk jeni gati. Tepër të rinj ose thjesht nuk jeni gati.
8. Vetëm me njeriun e duhur. Ndjeni nevojën t'ju duan.
9. Jo para martesës. Nuk mund t'i besoni partnerit.

Më pas zhvillon me nxënësit një diskutim, duke iu kërkuar nxënësve:

- ☐ Zgjidhni katër nga arsyet e mësipërme, për të cilat ju mendoni se të rinjtë refuzojnë më shpesh të kryejnë marrëdhënie seksuale.

AKTIVITET

Sjelljet e përgjithshme: marrëdhëniet seksuale me mjete mbrojtëse

“Jo”, seksit të pambrojtur

Lojë me role

Mjetet: Fletë për çdo nxënës, tabelë dhe shkumës, materialet në ndihmë të mësuesit

“Informacion mbi infeksionin HIV/IST dhe AIDS”.

Koha: 30 minuta.

Qëllimi: Rritja e ndërgjegjësimit për shpejtësinë e përhapjes së HIV-it dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme.

Zhvillimi i veprimtarisë

Mësuesi sqaron nxënësit:

Duhet të këmbëngulni, nëse partneri juaj nuk do të përdorë prezervativin. Mesazhi juaj duhet të jetë i qartë: “S’ka seks pa prezervativ”.

- Përgatisni fletat e punës, duke shkruar në tre prej tyre “Pasi ta lexoni këtë, mos ndiqni asnjë nga udhëzimet e mia, deri sa t’ju lejoj të ktheheni në përsëri në vendet tuaja”. Në tre faqe të tjera shkruani “k” të vogël, në një të “g”, një tjetër me “h”, në një tjetër “z”, si dhe mund të vini edhe shënimin si “Ndiqni udhëzimet e mia”.

Udhëzoni nxënësit sipas hapave të mëposhtme:

1. Jepini çdo nxënës nga një kartë. U thoni nxënësve t’i mbajnë të fshehta udhëzimet në fletat e tyre dhe t’i ndjekin ato. I thoni nxënësve të ngrihen në këmbë, t’i japin dorën tre nxënësve të tjerë dhe t’u kërkojnë atyre të firmosin kartën. Ata duhet të lëvizin nëpër klasë.

2. Pasi të gjithë të kenë marrë tre firma, u thoni të ulen në vendet e tyre. U thoni nxënësve që kanë fletat me gerrat “g”, “h” dhe “z” të ngrihen në këmbë, por edhe ata që u kanë dhënë dorën këtyre nxënësve duhet të ngrihen në këmbë. Vazhdoni derisa të gjithë të jenë të ngritur, përveç atyre që nuk marrin pjesë.
3. Tani u thoni nxënësve të imagjinojnë sikur personi me kartën “h” ishte i/e infektuar me HIV dhe se në vend që t’i jepte dorën tre personave, ai/ajo kreu seks të pambrojtur me tre njerëz të cilët firmosën kartën e tij/të saj. Bëni të njëjtën gjë me kartat që kanë “g” (gonorea), “z” (herpesi gjenital).
4. Ulini nxënësit përsëri dhe u thoni atyre me fishat “Mos i ndiq udhëzimet e mia” të ngrihen në këmbë. Shjegoni se ata nxënës kanë vendosur të mos kryejnë marrëdhënie seksuale dhe prandaj janë të mbrojtur nga HIV-i dhe IST.
5. U thoni nxënësve që kanë fletët “k” të ngrihen në këmbë. Shpjegoni se, fatmirësisht, ata kanë përdorur prezervativë dhe nuk kanë rrezik për infektim. U thoni të gjithëve të ulen. Rikujtojuni atyre se kjo ishte vetëm një lojë dhe se ata po përfaqësonin njerëz me IST dhe HIV, që nuk ngjiten nga dhënia e dorës.

Më pas zhvillon me nxënësit një diskutim, duke iu kërkuar nxënësve:

- ☐ Zgjidhni katër nga arsyet e mësipërme, për të cilat ju mendoni se të rinjtë refuzojnë më shpesh të kryejnë marrëdhënie seksuale.



• 5.4 Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve për HIV/AIDS

- Teste për vlerësimin e nxënësve (me përgjigje të sakta)

Pyetje “e vërtetë (V) – e pavërtetë (G)”

Njësia 1

1. Meshkujt mund t’ia transmetojnë HIV-in të tjerëve me anë të spermës.	
2. Ju mund ta merrni HIV-in duke u ulur në ndenjësën e wc-së ku ka qenë i ulur një person me AIDS.	
3. Ju mund ta merrni HIV-in duke pirë nga e njëjta gotë ose nga e njëjta çesme ku ka pirë edhe një njeri me AIDS.	
4. HIV-i gjendet në spermë, në lëngjet vaginore dhe në gjak.	
5. Një njeri mund ta marrë HIV-in duke përdorur gjilpëra droge që i kanë përdorur të tjerët.	
6. Njerëzit seropozitivë zakonisht janë të dobët dhe me pamje të sëmurë.	
7. Po u infektove nga HIV-i, je infektuar për jetë.	
8. Disa njerëz janë infektuar nga HIV-i duke u larë në të njëjtin vend ku është larë dhe një i prekur nga AIDS.	
9. Ju mund ta merrni HIV-in nga pickimi i një mushkonje	
10. Një njeri i sëmurë nga AIDS mund ta përhapë virusin edhe duke u kollitur ose pështyrë.	
11. Gratë mund t’ua ngjisin HIV-in të tjerëve me anë të lëngjeve vaginore.	
12. Nuk ka asnjë mënyrë për të zbuluar nëse jeni apo nuk jeni i infektuar nga HIV-i.	

13. Ju mund të infektoheni nga HIV-i duke kryer marrëdhënie seksuale me një njeri që ka përdorur të njëjtën gjilpërë droge që ka përdorur edhe një tjetër.	
14. Seropozitivët jo doemos kanë pamjen e njeriut të sëmurë.	
15. Ju mund të shëroheni nga AIDS në qoftë se i merrni rregullisht ilaçet që ju ka dhënë mjeku.	
16. Duke bërë tatuazhe, shpim veshi ose hunde, ju nuk mund të infektoheni nga HIV-i duke përdorur gjilpëra të përdorura nga një tjetër.	
17. Njerëzit me AIDS vdesin nga sëmundje serioze.	
18. Gratë preken me vështirësi nga AIDS.	
19. HIV-i mund të kalojë nga nëna tek fëmija i palindur ose tek fëmija i posalindur.	
20. HIV-i mund të ngjitet edhe duke veshur rrobat e një njeriu me AIDS.	
21. Kryerja e marrëdhënieve seksuale gjatë menstruacioneve e shton rrezikun e marrjes së HIV-it.	
22. Ju mund ta merrni HIV-in duke u prerë, ndërsa rruheni me briskun e përdorur nga një i infektuar.	
23. Koha që kur njeriu e merr HIV-in, deri sa sëmuret nga AIDS, mund të jetë më e pakta 6 muaj dhe më e shumta 10 vjet e më shumë.	
24. Një njeri me AIDS zakonisht vdes pas 6 muajve deri në 2 vjet.	
25. Një njeri është i aftë të infektojë të tjerët, vetëm kur është i sëmurë me AIDS.	
26. Tashmë ekziston një vaksinë, e cila është e aftë t'i mbrojë njerëzit nga infeksioni i HIV-it.	
27. Në qoftë se një njeri është i sëmurë nga IST, rreziqet e tij për t'u prekur nga HIV-i janë më të mëdha.	
28. AIDS shkaktohet nga HIV-i	
29. Janë njoftuar raste kur HIV-i është përhapur edhe nga të puthurat.	
30. Gjatë veprimtarive të përditshme HIV-i nuk mund të përhapet nga një njeri tek tjetri.	
31. Ka prova të sigurt sipas të cilave disa insekte mund të përhapin HIV-in.	
32. HIV-i mund të ngjitet nga kontakte te tilla si: përqafimet, puthjet, shtrëngimet e duarve.	
33. Një njeri mund ta përhapë HIV-in edhe kur ai nuk ka asnjë shenjë ose simptomë të AIDS.	
34. Sa më shumë partnerë të ketë një njeri, aq më të shumta janë mundësitë e infektimit të tij nga HIV-i.	
35. Çdo njeri i infektuar, pavarësisht nëse i ka apo jo simptomat e AIDS, mund t'ua ngjitë HIV-in të tjerëve.	
36. Një njeri mund ta mbajë HIV-in në trupin e tij për vitë pa u sëmurur nga AIDS.	
37. Njeriu mund të dallohet nga pamja e jashtme nëse është apo jo i infektuar.	
38. Një test negativ për praninë e HIV-it do të thotë se në gjak nuk ka antitrupa.	
39. Ju mund ta merrni HIV-in nga ndenjësjet e wc-ve.	

40. Ata që janë të martuar, nuk mund të preken nga HIV-i.	
---	--

Njësia 2

1. Vonimi i marrëdhënieve seksuale dhe mospërdorimi i gjilpërave të drogës janë mënyrë shumë të mira që adoleshentët të shmangin marrjen e HIV-it.	
2. Një mënyrë për të mos u infektuar nga HIV-i është shmangia e kontaktit seksual.	
3. Nuk ka asnjë mënyrë, nga e cila njeriu mund të ruhet nga infektimi i HIV/AIDS HIV/AIDS.	
4. Moskryerja e marrëdhënieve seksuale është rruga më e efekshme për të shmangur infektimin nga HIV-I.	
5. Njerëzit e vendosur i arrijnë qëllimet e tyre duke iu imponuar të tjerëve.	
6. Një njeri pasiv zakonisht u dorëzohet të tjerëve.	
7. Në qoftë se një njeri përpiket të të bindë të bësh diçka që ti nuk do që ta bësh, ti ose duhet të kundërshtosh, ose të bisedosh për zgjidhje më të sigurta, ose ta vonosh marrjen e vendimit.	
8. Në qoftë se qëndron gjithmonë me një partner, ti nuk infektohesh nga HIV-i.	

Njësia 3

1. Ju nuk mund të infektoheni nga HIV-i në qoftë se kryeni marrëdhënie seksuale një herë apo dy herë pa prezervativë.	
2. Prezervativët sigurojnë mbrojtje të plotë nga HIV-i	
3. Prezervativët që përdoren si duhet dhe sa herë që kryhet kontakti seksual, sigurojnë mbrojtje nga HIV-i, AIDS dhe shmangin shtatzaninë.	
4. Një prezervativ mund të ripërdoret përsëri dhe të jetë i sigurtë.	

Njësia 4

1. Njeriu mund ta marrë HIV-in duke ngrënë ushqime nga një seropozitiv	
2. Një njeri i sëmurë nga AIDS, i cili djersin, vjell apo ka diarre, ka nevojë për lëngje suplementare	
3. Njerëzit me AIDS duhet të rrinë gjatë gjithë kohës në spital, jo në shtëpi	
4. Njerëzit me AIDS duhen inkurajuar të bëjnë gjithçka që mundën për veten e tyre	
5. Nuk janë vërtetuar raste të infektimit nga HIV-I, kur një njeri ka jetuar bashkë me një seropozitiv ose me AIDS	

6. Kur një njeri seropositiv nuk lejohet të vazhdojë shkollën, kemi të bëjmë me një rast diskriminimi	
---	--

• 5.5. Pyetje që kërkojnë përgjigje të shkurtra

Përgjigjet e pranueshme jepen me shkronja korsive (të lakuara)

- Thoni emrat e lëngjeve që njihen si përhapës të virusit të HIV-it .
 - Sperma, sekrecionet vagjinare, gjaku.*
- Thoni emrat e dy rrugëve me anë të gjakut, në të cilat mund të ndodhë tejçimi i HIV-it.
 - Përdorimi i ageve dhe i shiringave të përdorura më parë nga një tjetër, përdorimi i mjeteve të tjera si: thikave, brisqeve të rrojes, veglave të bërjes së tatuazhit dhe shpimit të veshëve, ndodh edhe nëpërmjet të furçave të dhëmbëve;*
 - Transfuzioni i gjakut.*
- Cilat janë tri rrugët e përhapjes së HIV-it?
 - Nëpërmjet kontaktit seksual*
 - Përdorimit të përbashkët i ageve dhe shiringave të injeksionit si dhe të mjeteve të tjera prerës (p.sh. brisqeve)*
 - Nga nëna tek fëmija*
 - Nëpërmjet transfuzionit të gjakut.*
- Jepni dy arsye pse AIDS është një sëmundje tepër serioze.
 - Nuk ka asnjë lloj mjekimi për të*
 - Shkakton vdekje*
 - Shkakton diskriminim dhe intolerance*
 - Nuk ka asnjë vaksinë për parandalimin e saj*
 - Prek moshat e reja*
- Rendit pesë rrugë në të cilat HIV-i nuk përhapet.
 - Me anë të insekteve, përqaqimit ose prekjeve, peshqirëve, kollitjes, teshtitjes, puthjeve, udhëtimit në autobus, banimit në të njëjtën shtëpi ose dhomë; kafshëve; veshjes së rrobave të përdorura; pishinave (vaskave të ngrohta);përdorimi i telefonit të njëjtë; ushqimit, tualeteve; çesmes së njejtë, donimit të gjakut, e të tjera.*
- Rendit katër rrugë, në të cilat mund të mbroheni nga HIV-i dhe nga infeksione të tjera.
 - Moskryerja e marrëdhënieve seksuale*
 - Vonimi në kohë i tyre*
 - Përdorimi si duhet i prezervativëve*

- Mospërdorimi i gjilpërave dhe i shiringave të papastra
 - Bërja e injeksioneve vetëm në spitale dhe qendra mjekësore
 - Pasja vetëm e një partneri seksual të painfektuar nga HIV/AIDS dhe që nuk ka patur partnerë të tjerë më parë.
7. Përshkruaj çfarë ndodh, duke filluar nga koha kur një njeri infektohet nga HIV-i, deri kur vdes nga AIDS.
- Infektimi nga HIV-i, për 2 deri në 12 javë zhvillohen antitruapat; pas 6 muajve deri në 10 vjet ose me shumë fillojnë të shfaqen simptomat e AIDS; pas 6 muajve të tjerë deri në 2 vjet ose pak më shumë ndodh vdekja.
8. Ç'kuptojmë me "periudhë e dritares"? Pse kjo periudhë ka kaq shumë rëndësi?
- "Periudha e dritares" është periudha që nga koha kur një njeri infektohet, deri kur në gjak fillojnë të zhvillohen antitruapa (luftuesit e mikrobeve). Zakonisht kjo periudhë zgjat nga 2 deri në 12 javë. Ajo ka rëndësi sepse në qoftë se gjatë kësaj kohe njeriu bën testin, ai do të dalë negativ; pasi testi kërkon antitruapat kundër HIV-it, që ende nuk janë zhvilluar. Megjithatë ky njeri mund të infektojë të tjerët.
9. Jepni tri arsye pse njeriu duhet të bëjë analizat.
- Për të mos infektuar të tjerët
 - Për të marrë mjekim për të parandaluar infeksionet oportuniste, për shembull, pneumonia.
 - Për të mos ia kaluar HIV-in fëmijëve
 - Për të mos dhuruar gjak të infektuar
 - Për t'ia treguar këtë fakt partnerëve të tij ose të saj seksualë

Përfundime:

- Të mësosh të rinjtë për HIV/AIDS-in është një sfidë profesionale e personale.
- Në momentin kur nuk ka një kurë shërimi, informimi dhe edukimi është shumë i rëndësishëm.
- Nxënësit kanë nevojë për informim të qartë rreth sjelljeve që rrezikojnë infektimin me HIV.
- Përderisa shumica e adoleshentëve eksperimentojnë me disa lloj sjelljesh të rrezikshme për shëndetin, si: pirja e duhanit, alkoolit, përdorimi i drogave të ndyshme, përdorimi i formave të ndryshme të dhunës fizike etj., mësuesit mund t'i ndihmojnë ata të kuptojnë, se cilat sjellje janë të shëndetshme për të shmangur apo për të eliminuar sjelljet me risk.
- Infeksioni HIV/AIDS nuk është vetëm një problem i madh mjekësor, por shihet si një problem i madh social, ku një vend të rëndësishëm luajnë mënyrat e sjelljes.
- Informimi dhe edukimi i nxënësve mund të realizohet nga mësuesit e shkollave të mesme, që japin lëndët e shkencave sociale e biologjike apo nga mësuesit e

lëndëve të tjera në orët edukative, madje është e domosdoshme që tema të tilla të planifikohen e të gjejnë zbatim në planet e punës edukative gjithëvjetore në shkollë.

- *Mësuesit e biologjisë informacionin mbi HIV /AIDS-in apo mbi sjelljet me risk për shëndetin mund t'i realizojnë në tema të tilla si: "Zhvillimi i seksit", "Baza molekulare e trashëgimisë", "Gjenet";*
- *Mësuesit e lëndës Edukata Qytetare informacionin mbi HIV /AIDS-in apo mbi sjelljet me risk për shëndetin mund t'i realizojnë në tema të tilla si "Shëndeti, HIV/AIDS-përhapja dhe pasojat"; etj;*
- *(Edukata Qytetare 6). "Shëndeti, HIV/AIDS-përhapja dhe pasojat";*
- *(Edukata Qytetare 7). "Çfarë e rrezikon shëndetin tonë";*
- *(Edukata Qytetare 9). "AIDS-sëmundje e shekullit";*
- *(Biologjia 9). "Zhvillimi i seksit", "Baza molekulare e trashëgimisë" "Gjenet";*
- *Në këtë mënyrë bëhet lidhja sociale dhe shëndetësore e HIV/AIDS dhe vazhdimësia e informacionit nëpër klasa të mësimit të ulët dhe degëzohet në lëndë të drejtimeve profesionale të mësimit të mesëm.*

Në këtë kapitull do të paraqiten disa mësimet model, të zhvilluara mbi tematikën e trafikimit, të hartuara nga zyrat e IOM në bashkëpunim me specialistë të arsimit në Rumani, Hungari, Shqipëri dhe Kosovë. Këto mësimet janë përvoja të ndryshme, të realizuara gjatë fushatave për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, që IOM-i ka realizuar me shkollat në këto vende.

Mësimdhënësit mund të zbatojnë përvojën e tyre, mbështetur në materialin informativ të paraqitur në këtë doracak, në tabelën (faqe...), ku sugjerohen tema ndërkurrikulare të lëndëve përkatëse, si dhe tek përvoja e mësuesve dhe programeve të vendeve që e kanë aplikuar këtë përvojë në shkollat e tyre.

MËSIMET MODEL

Tema: Njohuri të përgjithshme mbi trafikimin

Tema: Mësim mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore

Objektivat: Nxënësit do të jenë në gjendje:

- ▶ Të identifikojnë karakteristikat e trafikimit të qenieve njerëzore;
- ▶ Të përshkruajnë fazat e trafikimit;
- ▶ Të analizojnë faktorët negativ të trafikimit dhe kushtet që e bëjnë të mundshëm trafikimin;
- ▶ Të përcaktojnë pozicionin e tyre në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe të shpjegojnë nevojën për parandalimin dhe luftën kundër këtij fenomeni;

Mjetet: Një kopje të “materialit ndihmës për mësuesin” (Tregim nga përvoja e një vajze të trafikuar); Artikuj gazetash;

Metodat: Studim rasti; Punë me grupe

Termet çelës

- ▶ Trafikimi i qenieve njerëzore
- ▶ Trafikanti
- ▶ Viktima
- ▶ Cënueshmëria (vulnerabiliteti)

Koha: 45 minuta (një orë mësimore)

Plani i aktivitetit:

1. Paraqisni përmbajtjen e problemeve tek nxënësit, duke sjellë si shembull rreshtat e një gazete, emisionin e lajmeve në TV mbi trafikimin e qenieve njerëzore, apo lexoni me zë tregimin në vijim (material për mësuesin).
2. Ndani dërrasën në tre kolona, sipas modelit në vijim, dhe kërkoni që nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë në fletoret e tyre;

ÇFARË KAM MESUAR?	ÇFARË DI UNE?	ÇFARË DESHIROJ TE DI?
-------------------	---------------	-----------------------

3. Diskutoni me nxënësit problemet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe vendosni elementet përkatës në kolonën e parë (ju duhet të sqaroni informacionin që shfaqet gjatë leksionit dhe të përpiqeni të jetë i qartë sa më shumë prej tij), gjithashtu dhe idetë kryesore.
4. Vendosni të gjitha problemet e paqarta në kolonën e dytë. Pyesni nxënësit se çfarë tjetër duan të dëgjojnë, e këto të shkruhen në kolonën e dytë;
5. Kërkoni prej nxënësve informacion shtesë gjatë zhvillimit të mësimi;
6. Lexoni me zë dhe diskutoni rastin në vijim. Diskutoni rastin (historinë) me nxënësit tuaj dhe drejtoni pyetje të tilla, si:
 - Si u rekrutua viktimat?
 - Cilat janë karakteristikat e rekrutuesit?
 - Cilat janë karakteristikat e viktimës?
 - Çfarë ndodh pas rekrutimit?
 - Pse ndodhi mashtrimi?
7. Analizë e shkaqeve
 - Cilat ishin arsyet që viktimat pranoi ofertën e trafikantit?
 - A mund të bëhet diçka për të shmangur këto situata?
 - Çfarë mendoni se ka ndjerë viktimat, ndërsa përfshihej në atë tragjedi?
 - Çfarë do të ndjenit ju, nëse do të përballeshit me një situatë të njëjtë?
 - Cili ishte gabimi i viktimës?
 - Çfarë do të kishit bërë ju?
8. Në një kohë që diskutimet kanë mbaruar, kërkoni që nxënësit të plotësojnë individualisht kolonën e tretë në fletoret e tyre.
9. Ndani klasën në grupe të vogla (4-5 nxënës).
10. Kërkojini nxënësve të krahasojnë informacionin që ata kanë në kolonën e parë, me informacionin e vendosur në kolonën e tretë, si dhe për të identifikuar ngjashmërinë dhe ndryshimin, duke shkëmbyer informacionin me shokët e klasës.
11. Diskutoni me nxënësit tuaj, çfarë kanë mësuar gjatë këtij mësimi dhe përmbledhni kryesoret në kolonën tuaj të tretë (në dërrase të zezë).
12. Kërkojini nxënësve të krahasojnë:
 - Kolonën e 1 dhe 3;
 - Kolonën e 2 dhe 3.

Nëse ekziston akoma ndonjë element i paqartë, ju duhet të siguronit informacion shtesë (në bazë të materialeve që keni në dispozicionin tuaj).

Materiale në ndihmë të mësuesit

Rasti: T.D., 17 vjeçare nga Moldavia, tetor 2001¹

Edhe pse është vetëm 17 vjeçare, T.D. është jashtë vendit për herë të dytë. Herën e parë, ishte e trafikuar në Bosnjë. Ajo jetonte me prindërit e saj, por kishte marrëdhënie jo të mira me babain.

Ai kishte probleme me konsumin e alkoolit, ishte i dhunshëm dhe i vrazhdë ndaj saj, madje edhe më shumë se ndaj nënës së saj. Kështu që, preokupimi i vetëm i saj ishte si të largohej nga ai, meqë jeta po bëhej shumë të vështirë.

Një e njohur e saj i kishte premtuar T.D.-së punë në Bosnjë, si kameriere ose si vallëzuese. T.D. e kaloi kufirin Moldavi-Rumani në mënyrë legale, por më vonë, u detyrua që kufirin me Serbinë ta kalojë ilegalisht, në këmbë dhe me sy të mbyllur.

Pasi hyri në Serbi, atë e zhvendosnin nga një vend në tjetrin, kurse trafikantët ia kishin marrë pasaportën. Së bashku me tri vajza të tjera, T.D.-në e sollën në Kosovë. Edhe këtë radhë, trafikantët i zhvendosnin ato nga njëri vend në tjetrin.

Tri vajzat, duke e përfshirë këtu edhe T.D.-në, ishin detyruar t'u ofrojnë shërbime seksuale shumë meshkujve. Ditën tjetër, pronari i një bari erdhi dhe i bleu vajzat. Ato u sollën në Prishtinë, vazhduan të keqtrajtohen dhe ishin të detyruara që t'u ofrojnë shërbime seksuale shumë njerëzve, të kërcënuara se do t'i vrasin nëse do të përpiqeshin të ikin.

¹ Tregim i shkëputur nga përvoja e një vajze të trafikuar, e ndihmuar nga Misioni i IOM-it në Kosovë, në vitin 2001. Inicialet e emrit të viktimës janë ndryshuar për çështje të sigurisë dhe mirëbesimit.

Tema: Mësim mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore

Objektivat: Nxënësit do të kenë një kuptim më të mirë të rrezikut e të pasojave të trafikimit, si dhe do të bëhen të përgjegjshëm mbi problemet që e bëjnë nxënësin të pambrojtur nga shfrytëzimi.

Mjetet: Një kopje të “materialit ndihmës për mësuesin”, gërshërë, kuti, tabakë letre ose tabelë dhe shkumës.

Koha: 45 minuta (një orë mësimore)

Plani i aktivitetit: Prisni në rrip fletën e materialit ndihmës për mësuesin “Deklaratat”. Palosni thëniet dhe futini në kuti për t’i përdorur në hapin B.

Termat çelës

- ▶ Trafikimi i qenieve njerëzore
- ▶ Trafikanti
- ▶ Viktima
- ▶ Cënueshmëria (vulnerabiliteti)

- A. Klasa është e ndarë në grupe të vogla prej 5 nxënësish secili. Udhëheqësi i grupit është zgjedhur rastësisht nga mësuesi dhe i është dhënë një paketë materiale (një varg deklaratash dhe kopje e një ngjarje të vërtetë). Anëtarët e grupit ndajnë rolet që secili nga grupi do të luajë. Secili person në një grup duhet të ketë një rol.

“Drejtuesi” është vendosur rastësisht.

Një person është “Kohëmatësi” (përgjegjësia e të cilit është të organizojë kohën e diskutimit dhe të sigurojë që grupi të mbarojë të gjitha detyrat në një për kohën e caktuar)
Një person është “Ndihmësi” (i cili siguron që secili nxënës nga grupi merr pjesë dhe kontribuon aktivisht).

Një person është “Mbajtës shënimesh” (i cili mban shënimet e diskutimit për “Prezantuesin”).

Një person është “Prezantuesi” (i cili i paraqet klasës konkluzionet e diskutimit në grup.)

- B. “Drejtuesi” hap paketën dhe merr një copë letër me direktivat e “Liderit”. Nxënësit shkruajnë në fletore “Opinionet” mbi ato që do të lexojë “lideri i grupit”. Lideri lexon një deklaratë të caktuar, dhe secili anëtar i grupit vendos vlerësimin, nëse ai/ajo janë dakort apo jo me atë deklaratë (thënie), duke përdorur një shkallë vlerësimi nga 1-10. “Udhëheqësi” duhet të lexojë një deklaratë, dhe të heshtë për kohë të caktuar, në mënyrë që të lejoj anëtarët e grupit të vendosin për vlerësimin e tyre dhe të shkruajnë përgjigjet e tyre, e më pas të vazhdojë të lexojë deklaratën tjetër derisa secili të jetë gati. Secili shkruan numrin e tij të zgjedhjes, 1 = shumë dakort dhe 10 = plotësisht jo dakort (kundër), për secilën deklaratë. Nxënësi nuk duhet t’i komunikojë përgjigjet e tij në këtë kohë.

Materiale në ndihmë të mësuesit

- Deklarata #1:* Njerëzit, të cilët gjenden të përfshirë në trafikim, mund të shpëtojnë, nëse ata dëshirojnë vërtetë këtë.
- Deklarata #2:* Viktimat e trafikimit e dinë çfarë do të ndodhë me ta në të ardhmen.
- Deklarata #3:* Vajzat, të cilat janë të trafikuar janë imorale, sepse ato janë bërë prostituta.
- Deklarata #4:* Viktimat e trafikimit e meritojnë ndihmën e institucioneve dhe shoqërisë kosovare.
- Deklarata#5:* Vajzat, të cilat janë të trafikuar, duhet të jenë budallaqe, përderisa mashtrohen nga një trafikues.
- Deklarata#6:* Vajzat, të cilat janë të trafikuar, përfshihen në trafik me dëshirë, sepse ato kanë nevojë për të holla dhe nuk kanë asnjë mënyrë tjetër për t'i siguruar ato.
- Deklarata #7:* Vajzat, të cilat janë të trafikuar, ia kanë bërë fatin vetes; asnjë gjë nuk mund të bëhet për to, dhe qeveria nuk duhet të shpenzojë para në përpjekje për t'i ndihmuar ato.
- Deklarata#8:* Nëse ndonjë, për të cilin unë kam simpati, më premtun një punë shumë të mirë shumë larg prej këtu, do ti kisha besuar atij.
- Deklarata #9:* Vajzat, të cilat janë trafikuar janë viktimat; janë trafikantët fajtorët e vërtetë të kryerjes së veprës penale të trafikimit apo shfrytëzimit të tyre.
- Deklarata #10:* Unë kurrë nuk do të trafikohesha. (Mësuesi mund të shtojë deklarata të tjera në dërrasë).

Anëtarët e grupit tani mund të vendosin përgjigjet e tyre dhe nuk duhet t'i ndajnë në këtë moment. "Lideri" i tregon që mos t'i hedhin poshtë ato, sepse do t'i duhen më vonë.

MËSIMET MODEL

Tema: Rekrutimi

Koha: 45 minuta (një orë mësimi)

Objektivat: Nxënësit do të jenë në gjendje:

- ▶ Përshkruajnë karakteristikat e trafikimit të qenieve njerëzore
- ▶ Analizojnë situatat vulnerable të trafikimit të qenieve njerëzore dhe kushtet që e bëjnë të mundshëm trafikimin
- ▶ Identifikojnë metodat kryesore të rekrutimit.

Mjetet: Një kopje të “materialit ndihmës për mësuesin” (Tregim nga përvoja e një vajze të trafikuar);

- ▶ Tregime/pjesë të shkëputura nga bisedat me viktimë të trafikuar – pjesa e rekrutimit;
- ▶ Fotokopje e seksionit të intervistës që i referohet rekrutimit;
- ▶ Letër për punë me grupe;
- ▶ Letra transparente;

Metodat: Dialogu ; “galeria”,

Termat çelës

- ▶ Trafikimi i qenieve njerëzore
- ▶ Trafikanti
- ▶ Viktima
- ▶ Cënueshmëria (vulnerabiliteti)

Plani i aktivitetit:

1. Prezantojë këtë aktivitet duke filluar me një dialog të shkurtër mbi temat e trafikimit të qenieve njerëzore. Ju duhet të bëni të qartë, që rekrutimi i viktimës është elementi kritik i biznesit të trafikimit.
2. Shpërndaji materialet përkatëse, seleksiono pjesët që i referohen metodave të rekrutimit (tregimi në vijim);
3. Ndaje klasën në grupe të vogla (3-4 nxënës);
4. Kërkoji secilit grup që të diskutojnë, ose të studiojnë dhe analizojnë temat;
5. Kërkoji çdo grupi nxënësish të identifikojnë si më poshtë:
 - Metodat e rekrutimit
 - Karakteristikat e rekrutueseve
 - Karakteristikat e viktimës.

Pastaj shkruaj të gjitha copat e informacionit mbi një letër (flipchart), në një formë tabele ose “letër vizatimi”.

6. Ndhmo grupin të publikojë “produktin” e tyre mbi murin e klasës.
7. Më pas kërkojini nxënësve të shqyrtojnë çdo “produkt” të grupit tjetër. Nxënësit mund të mbajnë shënim, ose të shkruajnë komente mbi letrat e publikuara.
8. Në një kohë që grupi ka përshkruar “galerinë”, ata duhet të shkëmbejnë komentet e tyre për lexim, apo mbi produktin e tyre.
9. Krijoni një diskutim me nxënësit tuaj në mënyrë që të identifikoni ngjashmërinë dhe ndryshueshmërinë ndërmjet produkteve të tyre.
10. Vendos një poster (IOM apo organizata të tjera) apo vizatim ku paraqitet viktimja
11. Secili grup do të krahasoj krijimin e tij me atë të paraqitur nga mësuesi, IOM-i, gazetat, etj.
12. Diskuto me nxënësit rreth faktorëve që e bëjnë të lehtë rekrutimin e viktimës.
13. Ndhmoji ata të identifikojnë faktorët kryesor të cënueshmërisë (vulnerabilitetit) dhe diskuto mundësitë dhe arsyet, që faktori i vulnerabilitetit nuk do të thotë që ato të mund të trafikohen.
14. Në përfundim të aktivitetit tuaj, ju duhet të pyesni nxënësit tuaj, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, të zgjedhin një informacion nga media apo bazuar në historitë gojore të dëgjua mbi tragjeditë e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Materiale në ndihmë të mësuesit

Rasti: Q.B., vajzë kosovare e trafikuar në moshën 17 ²

“Një ditë, kur isha duke u kthyer nga shkolla, më rrëmbyen tre njerëz të panjohur dhe më futën në makinë. Gjithçka ndodhi shumë shpejt. Unë qaja dhe bërtisja, kërkoja ndihmë. Ata më rrahën shumë, derisa unë humba vetëdijen. Tre muaj më mbajtën të mbyllur në një dhomë. Nuk mund të lëvizja askund”.

Q.B. u keqtrajtua seksualisht në mënyrë të vazhdueshme nga dy njerëz. Ajo u detyrua t’u ofrojë shërbime seksuale edhe njerëzve të tjerë. Pas disa muajve, Q.B.-në e shitën për 1000 Euro dhe e bleu një burrë, i cili donte të martohej. Ai kishte probleme psikike, kështu që Q.B. asnjëherë nuk u pajtua me këtë martesë.

Ajo qëndroi për 7 muaj e martuar, pa dëshirën e saj. Gjatë kësaj periudhe, Q.B. bëri jetë shumë të vështirë me këtë njeri. Një ditë vendosi të largohej. Një mëngjes të hershëm, ajo iku nga shtëpia pa e pasur idenë se ku mund të shkonte. Ishte e frikësuar; mendonte se familja e saj asnjëherë nuk do ta pranonte, meqë ajo ishte zhdukur nga shtëpia para 10 muajsh.

² Tregim i shkëputur nga përvoja e një vajze të trafikuar, e ndihmuar nga Misioni i IOM-it në Kosovë, në vitin 2001. Inicialet e emrit të viktimës janë ndryshuar për çështje të sigurisë dhe mirëbesimit.

Rasti: V.H., vajzë kosovare e trafikuar në moshën 13 vjeçe³.

V.H. së bashku me familjen e saj, la Kosovën në Mars të vitit 1998, pak para fillimit të luftës në Kosovë. U strehuan në një kamp refugjatësh, ku edhe u takua dhe ra ne dashuri me L.K. Pasi kaluan vetëm 2 javë, L.K. i premtoi V.H-së se do të martohej me të.

V.H. nuk i tregoi familjes për këtë ofertë dhe iku fshehurazi së bashku me LK-në. Për disa javë rradhazi ata kërkuar punë për V.H.-në, nëpër qytete të ndryshme të Shqipërisë, por pa sukses.

L.K. i sugjeroi që të shkonin në Itali. Ata kaluan kufirin Shqipëri-Itali në mënyrë ilegale dhe udhëtuan për në qytetin e Torinos. Sapo arritën atje, L.K. prezantoi V.H.-në me një grua tjetër, me A.S. Në të njëjtën ditë, A.S. e informoi V.H. se do të punonte si prostitutë. Që nga kjo ditë V.H. u përdhunua dhe u keqtrajtua nga trafikantët dhe nga shumë njerëz të tjerë.

V.H. punoi si prostitutë në rrugët e Torinos për katër vjet. Kishte shumë frikë që të lajmërohej në polici, apo të përpiqej të ikte, meqë L.K. e kishte kërcënuar duke i thënë se do ta vriste atë dhe familjen e saj.

Rasti: B.H., 18 vjeçare nga Rumania, prill 2002.⁴

B.H. është rritur në një mjedis të rëndë. Nëna e saj ishte ndarë dhe ishte martuar përsëri. B.H. është fëmija i vetëm nga martesja e dytë. Ajo është ankuar të ketë qenë e keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht nga e ëma, e cila ka pasur probleme për shkak të përdorimit të tepërt të alkoolit. Babai i kishte vdekur, ajo nuk kishte mundur të marrë pjesë as në varrimin e tij.

B.H. për herë të parë, doli jashtë vendit, duke shpresuar se do të mund të gjente punë si shërbëtoreshë në Jugosllavi. Trafikanti, një fqinj nga fshati, e kishte bindur se çdo gjë do të jetë në rregull dhe se do të kujdeset për të gjitha dokumentet, për pasaportën dhe për vizën e saj. Ai e mori atë në banesën e tij, në një qytet afër kufirit të Rumanisë me Serbinë. Kur kishte arritur atje, B.H. kishte kuptuar se diçka s'ishte në rregull, andaj kishte kërkuar nga bashkëfshatari që ta kthente në shtëpi. Ai i kishte thënë se tanimë ishte vonë dhe se të gjitha ujdite ishin bërë. Ai arriti ta bindë atë se çdo gjë do të jetë në rregull.

Kështu B.H. së bashku me dy vajza të tjera u sollën ilegalisht në Serbi dhe iu shiten një serbi. Ato i sollën dhe i mbyllën në një apartament, ku meshkuj të ndryshëm filluan t'i vizitonin. Atyre iu ishte thënë të zhvishen, ndërsa B.H. ishte rrahur sa herë që kishte refuzuar të bënte një gjë të tillë. Pas kësaj, ajo i ishte shitur një trafikanti tjetër në Serbi. Në këtë vend, ishin edhe dymbëdhjetë vajza të tjera dhe përsëri blerës të ardhshëm filluan t'i vlerësonin. Në fund të muajit, B.H. dhe dy vajzat e tjera morën pasaporta false nga trafikanti; pastaj, ai i dërgoi në stacionin e autobusëve. Një person tjetër i mori dhe i solli në Kosovë. B.H. i ishte shitur një personi nga Kosova në Ferizaj, i cili pastaj ia kishte shitur pronarit të një bari/lokali.

3 Tregim i shkëputur nga përvoja e një vajze të trafikuar, e ndihmuar nga Misioni i IOM-it në Kosovë, në vitin 2002. Inicialet e emrit të viktimës janë ndryshuar për çështje të sigurisë dhe mirëbesimit.

4 Tregim i shkëputur nga përvoja e një vajze të trafikuar, e ndihmuar nga Misioni i IOM-it në Kosovë, prill 2002. Inicialet e emrit të viktimës janë ndryshuar për çështje të sigurisë dhe mirëbesimit.

MËSIME MODEL

Tema: Histori të vërteta

Koha: 45 minuta (një sesion mësimor)

Objektivat: Nxënësit do të kenë një kuptim më të mirë të faktorëve, me të cilat përballen viktimat e trafikimit, do ta kuptojnë tragjedinë e tyre dhe do ta analizojnë fenomenin nga këndvështrimi i dhunimit të të drejtave të njeriut dhe të skllavërisë.

Mjetet: Një kopje të “materialit ndihmës për mësuesin”, “tregimi im”

Koha: 45 minuta (një orë mësimore)

Plani i aktivitetit:

Te shpërndahen kopje të tregimit, apo te lexohet tregimi me zë.

A. Grup pune (10 minuta)

“Drejtuesi” shpërndan tek secili anëtar i grupit, historinë e vërtetë të një viktime reale, duke i thënë anëtarëve të grupit që një viktimë e trafikimit e shkroi historinë, por emri i saj është ndryshuar. Anëtarëve të grupit u lihet kohë sa t’u nevojitet për ta lexuar historinë, dhe duhet të sinjalizojnë kur të mbarojnë së lexuari. Anëtarët e secilit grup kanë të njëjtën histori. Secili grup i vogël në klasë ka një histori të ndryshme. Mbasi të gjithë e kanë lexuar historinë, mësuesi i jep grupit një kohë limit për diskutim dhe i kujton klasës që “Ndihmësi”, “Mbajtësi i kohës” dhe “Mbajtësi i shënimeve” do të luajnë rolin e tyre. “Lideri” udhëheq grupin e vogël me pyetjet në vazhdim:

- Cili është reagimi juaj mbi këtë histori?
- Si ju bën të ndjeheni kjo histori?
- Cila pjesë e historisë ndikoi tek ju më shumë?
- Cili është trafikuesi në këtë histori?
- Si i ndodhi kjo asaj? Pse ajo u bë e trafikuar?
- Çfarë opsione/alternativa ka ajo?
- Është faji i saj për çfarë i ndodhi asaj? Shpjegoni dhe komentoni këndvështrimet tuaja.
- Çfarë do të bënit ju, nëse do të ishit në vend të saj?
- Nëse ajo do të ishte një anëtare e klasës tuaj, çfarë mbështetje do t’i ofronit?

B. Prezantimet (10 minuta)

Kur koha limit ka mbaruar, mësuesi shpjegon se secili “Prezantues” do të japë një prezantim të shkurtër mbi historinë e grupit të tyre, ndërkohë që nxënësit duhet të shohin për ndonjë ngjashmëri në historitë. “Prezantuesi” i grupit të parë, duke iu përgjigjur shënimeve të marra nga “Mbajtësi i shënimeve”, përmbledh historinë për klasën si dhe reagimin e grupit mbi këtë histori. Secili “Prezantues” nga grupet e tjera e ndjek.

C. Diskutime mbi ngjashmëritë e historive (15 minuta)

Kur të gjithë prezantuesit kanë mbaruar, mësuesi i kërkon klasës, “Çfarë ngjashmëri shihni?” dhe shkruan në dërrasë përgjigjet e nxënësve. Ngjashmëritë mund të përfshijnë metodologjinë e trafikantit, karakteristikat e trafikantit, arsyet pse viktimat vendos të pranojë trafikantin etj.

Detyra shtëpie

Në rast se nxënësi nuk ka mundur të mbarojë detyrën në klasë, atij i nevojitet të mbarojë së shkruari ngjashmëritë mes historive. Nxënësit i është dhënë, gjithashtu, një tjetër lexim rreth trafikimit dhe i thuhet që ato do t'i diskutojnë reagimet e tyre në orën tjetër. (Ky mund të jetë një artikull i ri gazete rreth trafikimit që mund të zgjidhet, apo ndonjë histori e një rasti tjetër të trafikimit).

Tema: Vlerësimi i Qëndrimeve

Koha: 45 minuta (një orë mësimore)

Objektivat: Nxënësit do të zhvillojnë më shumë sjelljet edukative në drejtim të trafikimit dhe opinione më shumë tolerante për viktimat e trafikimit. Nxënësit do të kenë një kuptim më të mirë për trajtimin që viktimat kanë marrë ose duhet tu bëhet, si dhe vështirësitë e riintegritit; gjithashtu ata do të jenë në gjendje të shohin më mirë se faji i takon trafikanteve dhe jo viktimave. Nxënësit do të jenë më tolerante ndaj viktimave të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual. Ata do të kuptojnë më mirë trajtimin çnjerëzor, që u bëhet viktimave nga trafikantët apo shfrytëzuesit e tyre, si dhe problemet reale që ato ndeshin në procesin e ri-integritit. Në thelb ata do të kuptojnë që autori i vërtetë i veprës penale është trafikanti, i cili i ka shkatërruar jetën e viktimës duke e detyruar të prostitutojë me anë të zgjedhës së skllavërisë, apo formave të tjera të mbajtjes nën tutelë (nën kontroll).

Rishikim (5 minuta)

Nëse nxënësit nuk ishin në gjendje të përfundonin diskutimin e ngjashmërive të historive, atyre i duhet ta bëjnë atë si detyrë shtëpie. Nxënësve u caktohet edhe një detyrë tjetër e ngjajshme, si detyrë shtëpie dhe u thuhet që reagimet e tyre do t'i diskutojnë në orën në vijim.

Opinione diskutimesh në grupe të vogla (10 minuta)

Klasa është e ndarë në grupe të njëjta prej 5 nxënësesh. Së pari, nxënësit nxjerrin përgjigjet e tyre për pyetjet Dakort/Jo dakort nga ora e fundit (në fletoret e tyre të punës nën temën “Opinione”) dhe bëjnë një kolonë të re. Çdo “Lider” i grupit lexon të njëjtën deklaratë që lexoi një orë më parë, duke pushuar pas secilës për ti dhënë nxënësit një mundësi për të shkruar numrin e përgjigjeve të tyre në rreshtin e ri, duke i shpjeguar se ata mund të ndjehen ndryshe sot si pasojë e dijeve të marra një orë më parë. Më pas “Lideri” lexon deklaratën #1 përsëri, dhe çdo grup diskuton opinionet e tyre dhe nëse ndonjë anëtar ndryshon mendje. I njëjti proces është ndjekur pas të gjitha deklaratave.

Opinione, diskutimi në grupe të mëdha (5 minuta)

Mësuesit shpjegojnë që duke iu përgjigjur nga 1-5 të deklaratës #10 automatikisht i vendos ato në një kategori rreziku të lartë për tu trafikuar. Mësuesi mund të pyesë pse. Mësuesi

mund të pyesë gjithashtu, për histori ose përgjigje të tjera. Mësuesi pyet nxënësit për reagimet e tyre të përgjithshme dhe pyet nëse ndonjë nxënës kishte ndryshime thelbësore në opinion nga ora e fundit dhe pse.

Mësuesi – Drejtimi i Aktivitetit (25 minuta)

Më pas mësuesi lexon historinë e V me zë të lartë dhe më pas i thotë klasës, “Imagjroni sikur të ishit V. Përse nuk i largoheni prostitucionit dhe të ktheheni menjëherë në shtëpi?” (Jepini atyre 10 minuta dhe lëri nxënësit individualisht të nxjerrin sa më shumë arsye pse një person i trafikuar nuk mundet të jetë në gjendje ose i gatshëm të rikthehet në shtëpi, duke i shkruar ato në një copë letër. Duke i thirrur nxënësit një e nga një për ti përmendur, etj., duke i shkruar arsyet e tyre në dërrasë).

MËSIME MODEL

Tema: Tragjedia/përvoja personale

Koha: 45 minuta (një orë mësimi)

Objektivat: Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- ▶ Identifikojnë dhe analizojnë etapat (momentet) e trafikimit.
- ▶ Kenë simpati për viktimën, në mënyrë që të kuptuar tragjedinë e saj
- ▶ Analizojnë fenomenin e trafikimit nga këndvështrimi i dhunimit të të drejtave të njeriut dhe të skllavërisë.

Mjetet: Një kopje të “materialit ndihmës për mësuesin” (Tregim nga përvoja e një vajze të trafikuar); Tregime për përvoja të personave të trafikuar për shfrytëzim seksual apo të formave të tjera; Histori reale

Metodat: mozaik; bisedë; përdor një varg pyetjesh “çfarë-nëse”

Termat çelës

- ▶ Transferimi/transportimi
- ▶ Shfrytëzimi/skllavërimi
- ▶ Tragjedia personale

Plani i aktivitetit:

1. Prezantoheni këtë aktivitet, duke kërkuar nga nxënësit të paraqesin një material të shkurtër që ata kanë seleksionuar.
2. Përdorini këto materiale, nëse juve ju duken të përshtatshme për përdorim për objektivat e mësimi, apo vetëm tregimin në vijim.
3. Krijoni grupe koordinuese dhe kërkonin që të përdorin materialet e seleksionuara.
4. Formuloni përgjegjësitë e ekspertëve:
 - a. Nisja nga vendi i origjinës dhe udhëtimi për në vendin e destinuar;

- b. Mashtrimi, ushtrimi i dhunës, zhgënjimi.
 - c. Shfrytëzimi ose shitja;
 - d. Lufta (arratisja), denoncimi.
5. Kërkoni nga ekspertët të krijojnë grupe fokusuese dhe të studjojnë materialet. Çdo grup ekspert do të mbledhë informacionin në materialet e seleksionuara nga nxënësit dhe do të përgatisin prezantimet e tyre për kolegët e tjerë.
 6. Pastaj nxënësit do të kthehen në grupet koordinuese, sepse çdo ekspert do të paraqesë informacionin tek nxënësit e grupit të tij/saj.
 7. Diskutoni etapat e aktiviteteve trafikuese menxënësit tuaj. Pastaj kërkoni nga secili grup të caktoj një reporter, i cili do të paraqesë rezultat e grupit, përpara gjithë klasës.
 8. Përdorimi i një sistemi pyetjesh “çfarë, nëse”: çfarë do të kishte ndodhur, nëse...? Çfarë do të kishit bërë nëse do të kishit qenë viktimë?
 9. Pyesni nxënësit për të identifikuar opsionet për një person të përfshirë në fazat e trafikimit: Çfarë duhet bërë për ta ndihmuar personin e trafikuar, që t'i kthehet jetës normale; si do ta ndihmonit?
 10. Kur aktiviteti ka mbaruar, ju duhet të pyesni nxënësit të shkruajnë një ese të shkurtër mbi atë çfarë ka ndodhur mbi viktimën, menjëherë pas arratisjes, dhe të identifikojnë sa më shumë alternativat e mundshme për riintegrim në jetë normale.

Materiale në ndihmë të mësuesit

(tregimi në vijim mund të përdoret për të dy mësim modelet e mësipërme)

Rasti: M.B., 16 vjeçare nga Kosova, tetor 2003⁵

Tregimi im

“Para se të fillonte kjo ngjarje e tmerrshme, isha 16 vjeçe, sapo kisha filluar mësimet në shkollën e mesme. Një ditë, teksa shëtisja me një shoqen time të fshatit, një shok i yni, të cilin e njihnim prej shumë kohësh, na ftoi të pimë kafe bashkë. Na ofroi të shkonim me makinën e tij, për t’ju shmangur rrugës me shumë pluhur. Kaluam shumë mire, në mes të të të tjerave, unë thashë se më duhet të gjej një punë.

Pas pak ditësh, takova shokun tim dhe më tha që më kishte gjetur punë në një dyqan ëmbëlsirash. U nisëm bashkë për të shkuar në qytet, për të më treguar vendin se ku do punoja dhe për t’u njohur me punëdhënësin.

Sapo u nisëm, filloi ta ngiste makinën me shpejtësi të madhe dhe për një çast ndaloj; nxorri revolen dhe e drejtoi nga unë duke më kërcënuar se do me vriste nëse do përpiqesha të ikja. U frikësova shumë, nuk dija çfarë të bëja. Nuk kuptoja se çfarë po ndodhte... aq më pak mund të besoja që “shoku”, që më kishte ofruar ndihmë ishte pjesë e këtij ankthi.

Më dërgoi në një motel... më detyroi të pija... Kur hapa sytë, rreth meje ishin 4 meshkuj ..., ishin të dehur dhe qeshnin me mua... isha krejtësisht e hutuar, nuk kisha fuqi as të qaj e as të kërkoj ndihmë... më përdhunuan disa herë... për disa orë me radhë... edhe më

⁵ Përvojë e shkëputur nga studimi “Vështirimi i Përgjithshëm i Mbështetjes Psikologjike dhe i Shërbimeve që u Ofrohen Viktimave të Trafikimit, Misioni i IOM-it, Kosovë, Shtatorë 2003.

rrahën...

Sapo u errësua, më dërguan në një qytet tjetër të Kosovës, në një shtëpi private. Më mbajtën të mbyllur për më shumë se një muaj. Aty kishte edhe vajza të tjera kosovare, por nuk mund të flisnim me njëra-tjetrën, na kishin kërcënuar që do na vrisnin ne dhe familjet tona, nëse do përpiqeshim të bënim ndonjë plan për të ikur. Më mbajtën të mbyllur, më përdhunuan dhe keqtrajtuat me ditë e netë të tëra.

Pas më shumë se një muaj erdhi më mori një djalë tjetër; u nisëm me makinën e tij. Ndalum; po na prisnin tre meshkuj të tjerë. Ata më detyruan të ecja pas tyre. Ecëm nëpër një mal...pas pak më thanë që ishim në Shqipëri. Një makinë tjetër po na priste në anën tjetër të rrugës...Më sollën në një motel tjetër dhe me lanë aty. Më dorëzuan tek dy persona tjerë...Ishin vëllezër...edhe ata më mbajtën për një muaj. Ata të dy dhe një burrë tjetër më i moshuar më përdhunonin vazhdimisht...as këtu nuk mund ta dalloja kur ishte natë apo ditë.

Një natë më morën nga ky vend, dhe më dërguan në një qytet tjetër. Më futën në një motobarkë. Aty pashë shumë vajza të pashpresa dhe të dëshpëruara...Kështu arrita në Itali. Më kërcënonin vazhdimisht që të mos kërkoja ndihmë, përndryshe do të më vrisnin...Bënte shumë kohë e keqe, nuk kishim ngrënë një kohë të gjatë...i humba shpresat, mendova se do të vdesim të gjithë...por unë nuk shqetësohesha, sepse do t'i jepja fund këtij ankthi. Nuk mund të besoja se diçka e tillë po ndodhte me mua.

Të nesërmen arritëm në një fshat të vogël të Italisë, aty takova një grua, ishte e dashura e njërit nga vëllezërit. Më mbyllën në një apartament...Isha shumë e frikësuar...shumë e lodhur...dhe nuk shpresoja në rrugëdalje...

Të nesërmen më thanë që do të punoj në rrugë, si prostitutë... Refuzova... Më rrahën shumë...Më thanë që do më vrisnin mua dhe familjen time në Kosovë, nëse përpiqesha të flisja me dikë apo të kërkoja ndihmë...Isha tmerrësisht e frikësuar...nuk mund të kërkoja ndihmë, nuk dija çfarë të bëja... nuk mund të shkoja askund pa u shoqëruar nga ata".

E detyruar punova dy vite si prostitutë...e kontrolluar në çdo kohë.

Më rrihnin sa herë u tekej: kur ishin të dehur, të gëzuar, të çmendur, apo kur nuk kishin dinin çfarë të bënin, nga qejfi...

Nuk mund të duroja më...Një natë e sollën një vajzë shumë të re...kishte shikim të pashpresë; filluan ta keqtrajtojnë syve të mi...vura re një thikë mbi tavolinë...isha aq e dëshpëruar nga rrethanat dhe nuk duroja më... Nuk dija çfarë të bëj... mora thikën dhe desha t'i jap fund këtij ankthi...

Policia erdhi në shtëpi dhe me morën... Ata më kishin denoncuar, duke thënë se jam një prostitutë dhe po ju shkaktoja probleme, që isha e rrezikshme, dhe nuk kisha dokumente identifikimi... dhe se donin të më hiqnin qafe... Nuk kisha fuqi të përballesh dhe të luftoja me ata...E rëndësishme ishte që do të largohesha nga këta njerez...

Policia Italiane më deportoi në Shqipëri. Atje më strehuan në një shtëpi të sigurtë dhe më ndihmuan të kthehem në Kosovë, tek familja ime.

Së fundi arrita në shtëpi, edhe sot i kujtoj gjërat që kam përjetuar. Prindërit e mi qanë kur u takuan me mua...Qava edhe unë... Nga gëzimi që erdha në shtëpi... Por edhe për

kujtimet e hidhura që solla me vete... kujtime të hidhura që nuk mund t'i flas me asnjëri... Dua të filloj një jetë normale, t'i harroja të gjitha... Unë nuk jam fajtores për gjërat që më kanë ndodhur. Prindërit nuk më lejuan të vazhdojë shkollën, më thanë që të mos dilja nga shtëpia, se njerëzit flasin për mua, më shanin duke thënë se unë e kisha ngritur familjen time me gjërat që më kishin ndodhur. Nuk mund të shkoja as për vizita tek faretisi, ata nuk donin që unë të shoqërohesha me fëmijët e tyre.

E ndjejë sikur jeta ime i takon dikujt tjetër e jo mua... jeta ime drejtohet nga të tjerët... ndërkohë që unë nuk kam faj për të kaluarën time...

MËSIME MODEL

Tema: Riatdhesimi dhe Ri-integrimi

Koha: 45 minuta (një orë mësimi)

Objektivat: Nxënësit do të jenë në gjendje:

- ▶ Identifikojnë karakteristikat e trafikimit të qenieve njerëzore;
- ▶ Të pozicionohen mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe të shpjegojnë nevojën për ta parandaluar dhe luftuar këtë fenomen;
- ▶ Përshkrimi i programit të asistencës për viktimat e trafikuar;

Mjetet: Një kopje të "materialit ndihmës për mësuesin" (Tregim nga përvoja e një vajze të trafikuar); Tregime për përvoja të personave të trafikuar për shfrytëzim seksual apo të formave të tjera; Histori reale; Fotokopje të artikujve 3 dhe 4 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

Metodat: Punë me grupe; Dialogje, lojë me role;

Termat çelës

- ▶ Transferimi/transportimi
- ▶ Shfrytëzimi/skllavërimi
- ▶ Tragjedia personale

1. Realizojeni këtë aktivitet, duke i kërkuar nxënësve të paraqesin esetë e tyre, detyra e shtëpisë e dhënë nga mësimi i fundit;
2. Prezantoni materialet që përmbajnë informacion mbi ri-atdhesimin (aktivitete të agjensive të ndryshme);

Shënim: Bashkëngjitur do të gjeni programin dhe shërbimet që ofron IOM-i për viktimat e trafikimit, qoftë ato të huaja apo vendore. Ky informacion mund të ndryshojë në varësi të nevojave të vlerësuara. Mësimdhënësit duhet të mbledhin të dhëna edhe për shërbimet e ofruara nga agjensi të tjera vendore e ndërkombëtare.

3. Bëjini të qartë nxënësve që viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë ndihmuar

nga institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë.

4. Përgatisni një organigram (poster) që përshkruan Programin Mbështetës të agjensive të ndryshme për personat e trafikuar.
5. Diskutoni me nxënësit mbi rëndësinë e Programit të Mbështetjes së Viktimave dhe riintegritit të tyre.
6. Ndajini nxënësit në grupe të vogla (3-4 nxënës).
7. Bazuar në aktivitetet e mëparshme, kërkoni që çdo grupi të identifikojë karakteristikat e trafikimit të qenieve njerëzore.
8. Kërkoni që secili grup të caktojë një nxënës, i cili do të paraqesë një aktivitet të grupit të tij/saj.
9. Shkruani në dërrasë (ose kërkoje nga një nxënës vullnetar) karakteristikat që vihen re në trafikimin e qenieve humane.
10. Sapo të gjithë grupet të kenë paraqitur raportet e tyre dhe të gjithë karakteristikat e identifikuara të jenë shkruar në bllok, ju duhet të përkufizoni trafikimin e qenieve njerëzore, si është specifikuar në dokumentat ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara, Protokoll i Palermos etj.
11. Kërkoni që nxënësit të krahasojnë këtë përkufizim me elemente të identifikuar në grupet e punës.
12. Diskutoni problemin me nxënësit dhe përpiku t'ua bëni sa më të kuptueshme dhe pozitive luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
13. Bëni një prezantim për nxënësit tuaj të Nenit 3 dhe 4 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Diskutoni me nxënësit se si janë shkelur të drejtat, në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore.
14. Kërkoni nga nxënësit që të diskutojnë mbi mënyrat e përfshirjes së tyre në parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.

MËSIME MODEL

Tema: Për sigurinë tuaj

Koha: 45 minuta (1 orë mësimi)

Objektivat: Nxënësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë më mirë dhe të përvetësojnë vështirimin kritik ndaj ofertave për punë në vend dhe jashtë vendit.

Mjetet: “Materiale në ndihmë të mësuesit”

Metodat: Loja me role zhvillohet për të praktikuar situata reale. Loja me role mbi rekrutimin duhet të luhet në klasë dhe varet nga situatat e ndryshme që do të krijojnë nxënësit.

Plani i aktivitetit:

Ndani nxënësit në 3 grupe. Secilit grup jepini një nga reklamat “ Material për mësuesin” Për t’ua sjellë problemin më afër, shpjegojini nxënësve që ofertat e mësipërme janë reale dhe që janë marrë nga gazetatat vendore. Secili grup punon 20 minuta për të përgatitur lojën në role, duke pasur parasysh që duhet të vlerësojnë, nëse puna e ofruar është e sigurtë. Karakteret e personazheve caktohen nga vetë nxënësit në varësi nga teksti i reklamës.

Secili grup prezanton lojën në role.

Materiale në ndihmë të mësuesit

1. Tentativë rekrutimi në disko.

Personazhet: një burrë ose një djalë dhe një nxënëse, inskenojnë një situatë të trafikimit në një disko-bar.

2. Përgjigja për një reklame të publikuar në gazetë

Personazhet: 2 ose 3 vajza bisedojnë rreth reklamës, inskenojnë reagimin ndaj reklamave të dëgjuara.

Reklamat:

1. Kërkojmë urgjentisht punëtore/vajza të reja, që janë të intersuara të punojnë si hostesa prej datës 30 Korrik-20 Gusht. Informacionet në nr e tel Cel. 04489

2. Ju mund të përfitoni një shumë të pabesueshme parash! Të udhëtoni në vende shumë të bukura: Paris, Londër, Kanada, Los Anxhelos, Malaga, me një kompani modelesh që i pëlqen festat. Nëse je vajzë e moshës 14-24 vjeç, me fytyrë dhe trup të bukur, atëhere mund të vetëvendosni.

3. Me ofertën e Painthous e: "TopModelX", ju mund ta ndërtoni të ardhmen tuaj menjëherë, shfrytëzoheni bukurinë tuaj. Aplikoni duke lënë një mesazh në: 044...234 ..., apo në email adresën ... Edhe fillestaret janë të mirëseardhura!

• Diskutoni:

Çfarë i bëri nxënësit të dyshojnë që puna e ofruar nuk është e sigurtë?

Cilat mund të jenë pasojat, nëse pranojmë një punë ilegale, nëse nuk kemi kontratë pune, apo leje pune?

Çfarë duhet të bëni para se të punësoheni?

MËSIME MODEL

Tema: Për sigurinë tuaj

Koha: 45 minuta (nje sesion mesimor)

Objektivat: Nxënësit do të informohen drejtë për mënyrat e drejta të punësimit dhe studimit jashtë vendit.

Mjetet: "Materiale në ndihmë të mësuesit"

Metodat: Bisedë e hapur

Hapi 1

Mësimdhënësi lexon apo kërkon nga një nxënës që të lexojë një tregim nga "Materiali ndihmës për mësuesin" (në vijim), që flet për përvojën e një vajze të trafikuar. Ajo flet për ëndrrat e saj dhe për përvojën kur shkoi jashtë vendit, për të kërkuar punë dhe një jetë më të mirë.

Hapi 2.

Diskutoni për personin që i ofroi punë të rreme? Kush ishte ai/ajo? Diskutoni për besimin?

Cilët janë faktorët tregues se kujt duhet t'i besojmë dhe kujt jo?

Diskutoni për marrjen e një vendimi/zgjedhjen?

Shënim: Mësimdhënësit do të hartojnë pyetjet në bazë të tregimit të zgjedhur.

Hapi 3

A rrezikohemi ne nga dukuria e trafikimit të qenieve njerëzore?

Dëgjoni nxënësit dhe shkruani përgjigjet e tyre në tabelë apo fletë (flipchart).

Shpjegoni:

Shpesh, pas ofertave për “punë të lehtë dhe të paguar mirë” apo ofertave të rreme martesore, fshihen veprime kriminele.

Këto oferta mund të bëhen edhe nga:

- Agjensi të ndryshme që ofrojnë punë në restorante, hotele, fabrika, ndihmës për punë shtëpie, dado, etj.
- Agjensi mode;
- Agjensi turistike;
- Agjensi për ndërlidhje martesore, e të tjera...

Diskutoni me nxënësit**Hapi 4**

Pyesni nxënësit: Çfarë duhet të bëni para se të punësoheni?

Dëgjoni nxënësit dhe shkruani përgjigjet e tyre dhe shënoni në tabelë apo “flipchart”

Kini parasysh për sigurinë tuaj:

- Para se të vendos të punësohem, gjithnjë kontrolloj legjitimitetin e agjensisë nëpërmjet së cilës mendoj të punësohem dhe të agjensisë në të cilën do të punësohem;
- Para se të udhëtoj në vendin ku do të punoj, vendos kontakt me punëdhënësin për t'u informuar hollësisht për punën që do të bëj.
- Marr njohuri themelore në gjuhën që flitet në vendin ku do të punoj; marr hartat e vendit/qytetit dhe adresat kontaktuese të ambasadave, policisë, spitalit, etj...)
- Siguroj të holla të mjaftueshme, dhe i lë në vend të sigurtë, që t'i kem në rast nevoje.

Bisedoni me nxënësit dhe kërkoni që t'i përsërisin mesazhet e sigurisë.

Hapi 5

Pyet nxënësit: Cfarë duhet të pyesni gjatë intervistës me punëdhënësin?

Dëgjoni nxënësit dhe shkruani përgjigjet e tyre dhe shënoni në tabelë apo “flipchart”

Gjatë intervistës me punëdhënësin?

- Edhe nëse puna iu afrohet nga miku apo shoku i juaj, para se të merrni vendimin adekuat, kontaktoni punëdhënësin që të verifikoni se ku do të punoni dhe pyesni rreth punës që duhet të bëni, për pagën dhe kushtet e jetës.
- Kërkoni emrin e punëdhënësit, adresën, numrin e telefonit (jo vetëm numrin e telefonit celular).
- Gjithmonë pyesni për të gjitha detajet dhe faqet e kontratës;
- Kontrata e punës dhe dokumentet e tjera përcjellëse duhet të jenë të shkruara në gjuhën time dhe duhet të përmbajnë: emrin e vendit ku do të punoj, (shteti, qyteti), emrin e agjensisë që më punëson. Një kopje do të mbetet tek unë gjatë tërë kohës.
- Të theksohet kohëzgjatja, gjatë së cilës do të punoj.
- Kur ta lexoni kontratën, duhet t'i kushtoni vëmendje çështjeve në vijim: “shuma totale e të hollave do të jepen në fund të kontratës”, “Harxhimet ditore do të hiqen nga shuma totale e të hollave”, “Një përqindje e fitimit do të mbetet tek ne”

Nëse diçka më duket e dyshimtë, unë nuk do ta nënshkruaj kontratën.

Bisedoni me nxënësit dhe kërkoni që t'i përsërisin mesazhet e sigurisë.

Hapi 6

Pyesni nxënësit: Cfarë duhet bërë para se të udhëtojnë jashtë vendit?

Dëgjoni nxënësit dhe shkruani përgjigjet e tyre në tabelë apo “flipchart”

Bisedoni me nxënësit dhe kërkoni që t'i përsërisin mesazhet e sigurisë.

Materiale në ndihmë të mësuesit

Rasti: A.K., 16 vjeçare nga Kosova;

Kishim shumë probleme në familje dhe ishim në gjendje shumë të vështirë ekonomike. Babai im im ishte shumë i acaruar nga rrethanat dhe nuk më lejonte të dilja nga shtëpia e as të shoqërohem me shoqe. Më rrihte shumë. Më trajtonte shumë keq, dhe kjo ndodhte çdo ditë. As në shkollë nuk mund të shkoja, kisha turp, trupi im ishte gjithë shenja të mavijosura, madje edhe në fytyrë.

Vendosa të iki nga shtëpia, por nuk dija ku të shkoja. I tregova hallin një shoqes time dhe ajo më tha që do më ndihmonte të gjeja një punë, meqë njihte shumë njerëz. U gëzova shumë, mendova që këtu ishte fundi i vuajtjeve të mia.

Një ditë dolëm për të takuar një mik të shoqes time i cili më kishte gjetur punë. Më tha

që do punoja në një motel në dalje të qytetit, si recepsioniste. Nuk pyeta për çfarë vendi bëhet fjalë, as për emrin e motelit, aq më pak për punëdhënësin, meqë punën ma kishte ofruar miku i shoqes time shumë të mirë, dhe natyrisht i besova.

Isha e gëzuar që do të filloja të punoja, do të ndihmoja familjen time, shpresoja që sadopak gjërat në familje do të ndryshonin. I tregova prindërve, babai filloi të bëjë fjalë, por i thashë që do sillja para në shtëpi, u qetësua dhe nuk më pyeti më shumë.

Fillova punë. Në motel punonin edhe vajza të tjera, por unë nuk i takoja shpesh, meqë ato punonin në mbrëmje. Kaluan disa disa javë, dhe djali i pronarit të motelit më ftoi të pimë kafe. Vazhdova të shoqërohem me të, shpesh më kthente në shtëpi me makinë, ishte shumë i mirë me mua, më premtoi qo do t'i ndihmonte familjes time.

Një natë nuk më lejoi të shkoj në shtëpi, më detyroi të shkonim në një dhomë të motelit. Më përdhunoi. Fillova të qaj dhe të bërtas, por nuk erdhi njeri për të më ndihmuar. Isha e trishtuar për atë që kishte ndodhur. Ai më tha që gjithçka ishte në rregull, që unë jam e dashura e tij dhe se shumë shpejtë do të martoheshim, meqë kishte kohë që më dashuronte, prandaj dhe më kishte ofruar punë që të jem më afër tij. I besova, meqë edhe unë e pëlqeja shumë. Ishte dita e fundit që dola nga shtëpia dhe nuk u ktheva për dy vite. Për një kohë vazhduam të jetojmë në motel.

I “dashuri” im më blinte gjëra të bukura, vishesha shumë mirë, ndjehesha shumë mirë. Ai ishte shumë i mirë me mua. Më premtoi që bashkë do të shkonim të jetonim në Zvicër ose Gjermani, meqë këtu nuk i pëlqente të jetonim, atje do më gjente punë dhe do vazhdoja shkollimin. U gëzova shumë, por menjëherë u merakosa meqë nuk kisha pasaportë e as kartë identiteti, asgjë, por ai më tha që ky ishte problemi më i vogël, sepse ai do të merrej me të gjitha. Një mbrëmje u takuam me disa shokë të tij. “I dashuri im” u largua, kinse për të mbaruar një punë. Shokët e tij më thanë që të shkonim bashkë me një restorant, ku do të vinte edhe “I dashuri im”. Nuk e pashë më asnjëherë. Përfundova në një motel tjetër, e kërcënuar se do më vrisnin mua edhe familjen time, nëse do përpiqem të kërkoj ndihmë. Isha e e detyruar t’u ofroj shërbime seksuale shumë meshkujve, dhe nuk kisha rrugëdalje tjetër. Më thanë që isha pronë e tyre, meqë më kishin blerë nga “I dashuri im”. E kuptova që ai në të vërtetë kishte qenë “pronari im”.

Kini parasysh për sigurinë tuaj:

Udhëtimi

- ▶ Për të udhëtuar jashtë vendit/shtetit, unë duhet të kem pasaportë të vlefshme dhe vizën, që kërkohet në vendin në të cilin do të udhëtoj. Gjithashtu, duhet të kem lejen e punës, nëse dua të punoj në atë vend;
- ▶ Gjatë gjithë kohës, të gjitha dokumentet (pasaportën, kartën e identitetit, paratë dhe dokumentet e tjera personale) i mbaj unë dhe do t'i tregoj vetëm me kërkesë të autoriteteve përkatëse.
- ▶ Kur udhëtoj në vendin në të cilin do të punoj, lajmërohem në ambasadën apo zyrën ndërlidhëse të vendit tim.
- ▶ Nëse dokumentet personale i kam humbur, m'i kanë vjedhur ose marrë me dhunë, pa humbur kohë unë menjëherë do të lajmërohem në polici.

Kur ndodhem jashtë vendit

Rregullisht kontaktoj me prindërit dhe të afërmit.

Në rast rreziku, së paku me një person, do të kem “një fjalë sekrete” që i bën të ditur se jam në rrezik.

Materiale në ndihmë të mësuesit

Kur të shqyrtosh një ofertë për punë në vend dhe jashtë vendit

Bëhu i kujdesshëm dhe skeptik

Shpeshherë, pas ofertave për “punë të lehtë dhe të paguar mirë” apo edhe oferta martesore, fshihen veprime kriminale.

Këto oferta mund të bëhen edhe nga:

- ☐ Agjensi të ndryshme që ofrojnë punë në restorante, hotele, fabrika, ndihmës për punë shtëpie, dado, etj.
- ☐ Agjensi mode;
- ☐ Agjensi turistike;
- ☐ Agjensi të shoqërimit (shoqërim edhe nëpërmjet telefonit)
- ☐ Agjensi për lidhje martesore, e të tjera...

Në shumë raste, personave që u është ofruar punë me paga të mira jashtë vendit, kanë përfunduar në duart e trafikantëve. Por e njëjta mund të ndodhë edhe brenda vendit. Lexoni këshillat në vijim, për t'ju shmangur ofertave të dyshimta.

Para se të punësohem:

1. Përpara se të vendos që të punësohem, gjithnjë kontrolloj legjitimitetin e agjensisë nëpërmjet së cilës mendoj të punësohem dhe të agjensisë në të cilën do të punësohem;

2. Përpara se të udhëtoj në vendin se ku do të punoj, do të kontaktoj me punëdhënësin për t'u informuar hollësisht për punën që do të bëj;
3. Nëse puna e ofruar jashtë vendit, unë duhet të kem njohuri për vendin, kulturën, zakonet, dhe së paku njohuri themelore të gjuhës që flitet në atë vend;
4. Do të siguroj hartat e vendit/qytetit dhe adresat kontaktuese të ambasadave, policisë, spitalit etj;
5. Do të siguroj të holla të mjaftueshme, dhe do t'i lë në vend të sigurt, që t'i kem në rast nevoje.
6. Nëse oferta për punë është reale, është praktikë e përgjithshme që të firmosësh (nënshkruash) një kontratë punësimi të shkruar. Do të kërkoj më shumë kohë dhe informacione para se të marr vendimin e duhur.
7. Edhe nëse puna më ofrohet nga një mik, shok/shoqe, para se të marr vendimin e duhur, unë do të siguroj emrin, adresën, numrin e telefonit (jo vetëm numrin e telefonit celularë) të punëdhënësit dhe do ta kontaktoj për të verifikuar se ku do të punoj, për ta pyetur më hollësisht për punën që duhet të bëj dhe kushtet në të cilat do të punoj.

Mos i beso parave që fitohen “lehtë”. Mund të shitesh si skllav

Gjatë intervistës me punëdhënësin

1. Kontrata e punës dhe dokumentet e tjera përcjellëse duhet të jenë të shkruar në gjuhën time dhe duhet të përmbajnë si minimum: emrin tim, emrin e vendit ku do të punoj, (shteti, qyteti), emrin e agjensisë që më punëson; kushtet e punës dhe pagën. Një kopje e kontratës dhe i gjithë dokumentacioni tjetër përcjellës do të mbeten tek unë gjatë gjithë kohës.
2. Interesohem për të gjitha detajet dhe faqet e kontratës; në kontratë duhet të përmenden të gjitha kushtet e punës, koha dhe paga.
3. Gjatë leximit të kontratës në veçanti i kushtoj vëmendje çështjeve në vijim: “shuma totale e të hollave do të jepen në fund të kontratës”, “Harxhimet ditore do të hiqen nga shuma totale e të hollave”, “Një përqindje e fitimit do të mbetet tek ne”;
4. Nuk firmos asnjë letër nëse nuk mund ta lexoj, sepse është në gjuhë të huaj dhe nuk di se për çfarë po firmos.
5. Nëse kam dyshime, do të kërkoj më shumë kohë dhe informacione. Nëse e vlerësoj ofertën si të dyshimtë, unë nuk do ta nënshkruaj kontratën

Nëse udhëtoj jashtë vendit:

1. Për të udhëtuar jashtë vendit/shtetit unë duhet të kem pasaportë të vlefshme dhe vizën që kërkohet në vendin për ku po udhëtoj, po ashtu duhet të kem lejen e punës, nëse dua të punoj në atë vend, apo dukumentacionin e duhur nëse do të studioj atje.
2. Gjatë gjithë kohës, të gjitha dokumentet (pasaportën, kartën e identitetit, paratë dhe dokumente të tjera personale) i mbaj unë dhe do t'i tregoj vetëm me kërkesë të autoriteteve përkatëse.
3. Kur udhëtoj në vendin në të cilin do të punoj, paraqitem në ambasadën apo zyrën ndërlidhëse të vendit tim.

4. Nëse vendos që të shkoj diku vetë apo me dikë, unë gjithmonë do t'i lë familjes sime adresën, një numër telefoni në vendin ku do të shkoj, si dhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me udhëtimin tim.
5. Do të mbaj me vete numra telefoni kontaktues, si dhe numrin e policisë.
6. Nëse kam humbur, më kanë vjedhur apo marrë me dhunë dokumentet personale, pa humbur kohë unë menjëherë do të lajmërohem në polici.

Kur ndodhem jashtë vendit

1. Kontaktoj rregullisht me prindërit dhe të afërmit.
2. Gjithmonë mbaj me vete një fotokopje të pasaportës.
3. Siguroj adresa dhe kontakte me persona të besueshëm, në mënyrë që të mund t'i kontaktoj në raste të ndryshme.
4. Në rast rreziku, së paku me një person do të kem “një fjalë sekrete” që i bën të ditur atij/asaj se jam në rrezik.
5. Kurrë nuk i jap pasaportën time të tjerëve.
6. Nëse pasaporta ime do të nevojitet për ndonjë çështje zyrtare, unë do të jem gjithmonë prezent.
7. Nëse do të ndjehem i/e detyruar/sforcuar/kërcënuar për të punuar, unë do të kërkoj ndihmë në polici ose në organizata ndërkombëtare humanitare për azil ose asistencë.

Nëse do të ndjehem i/e izoluar, i/e detyruar/sforcuar/kërcënuar të punoj, unë kam të drejtë të kërkoj mbrojtje dhe asistencë në çfarëdo lloj kushtesh që të ndodhem, edhe nëse jam i/e përfshirë në ndonjë vepër penale të lehtë si p.sh., qëndrim i parregullt në një vend, dokumenta false, punë në tregun e zi etj.

E VËRTETA KUNDREJT MASHTRIMIT

1. **Një ofertë për punë në vend dhe jashtë vendit, që të bëhet nga dikush që ti e njeh, është absolutisht e besueshme.**

Kjo nuk është e vërtetë. Shpesh femrat e trafikuar kanë rënë në duart e trafikantëve apo rrjeteve të tyre nëpërmjet personave të njohur si p.sh. shok, ose ndonjëherë edhe të afërm.

2. **Ju do të fitoni shumë para duke punuar jashtë vendit.**

Mos i besoni kësaj gënjeshtre. Në rastet kur një vajzë detyrohet të prostitutojë me anë të mashtrimit

se do të fitojë para të madhe, apo një djalë detyrohet të punojë në çfarëdo aktiviteti, kjo nuk është asnjëherë e vërtetë. Të gjitha paratë shkojnë tek shfrytëzuesi apo trafikanti.

3. **Ju nuk keni nevojë për dokumenta zyrtare për të shkuar jashtë vendit. Të gjitha i rregullojnë disa njerëz “të zotë” apo “të shkathët”.**

Asnjëherë mos bini në situata “borxhi” me ata që ju premtojnë se mund t’iu rregullojnë

fare mirë jashtë vendit, pa qenë nevoja për dokumenta zyrtare, sepse gjoja këtë “nder” ju do ta paguani kur të mbërrini në vendin e destinacionit.

4. Ju do të jeni në gjendje që ta lini “punën”, nëse do ta vlerësoni që është në kundërshtim me moralin tuaj, dhe se do të ktheheni në shtëpi kur të doni.

Duke qenë në situata borxhi, pa pasaportë apo dokumenta të rregullta, do të thotë të të kontrollojnë plotësisht të tjerët.

5. Trafikantët do ti bëjnë keq familjes suaj, nëse ju nuk u bindeni.

Shpesh përdoret dhunë për të detyruar femrën të ushtrojë prostitucion apo për të kryer çfarëdo lloj pune tjetër me detyrim. Përdoren gjithashtu presione/kërcënime mbi anëtarë të familjes. Por trafikantët nuk janë asnjëherë aq të fortë sa thonë. Ju duhet të mbështeteni gjithmonë tek, ligji, policia, institucionet e drejtësisë, organizatat qeveritare, apo joqeveritare.

6. Nuk ja vlen të kërkosht ndihmë tek të tjerët, kur tashmë je në duart e trafikantëve apo shfrytëzuesve.

Femrat/meshkujt që shfrytëzohen, megjithëse pa dokumenta apo lejeqëndrimi të rregullt, gjithmonë shikohen nga autoritetet vendore si viktimë. Këto autoritete në çdo rast ofrojnë mbrojtje dhe kujdes të veçantë që garantohen me ligj.

7. Nëse kërkon ndihmë tek drejtësia, atëherë të gjithë do ta marrin vesh “punën” që ke kryer jashtë shtetit.

Organet e drejtësisë janë të detyruara me ligj të ruajnë konfidencialitetin e femrave që denoncojnë shfrytëzuesit e tyre. Ka ligje që i japin mundësi viktimës së trafikimit të dëshmojë në rrethana konfidenciale.

INFORMACIONE TË NEVOJSHME / Për sigurinë tuaj

Këshilla nga vajzat dhe gratë e trafikuar

1. Mëso të thuash JO.
2. Tregohu e kujdesshme dhe gjithmonë duhet të kesh parasysh pasojat e të thënit PO.
3. Tregohu dyshuese dhe mendo që të gjitha premtimet mund të jenë të rreme.
4. Dashuria romantike mund të jetë e shtirur. Nëse një partner romantik duket perfekt, kjo është shumë e bukur për tu besuar, por megjithatë ndoshta edhe është në të vërtetë.
5. Nëse një i dashur ushtron presion, duke kërkuar me çdo mënyrë që ju të bëni diçka që nuk ju nuk ndjeheni mirë nëse e bëni, atëherë kjo nuk mund të quhet dashuri.
6. Nëse një shok apo ndonjë i afërt do t’ju afronte ndonjë punë, në asnjë mënyrë nuk duhet t’i besoni në mënyrë të verbër.
7. Nëse pranoni para, dhurata, ose ndonjë favor nga ndonjë person, do të ndjeheni të detyruara dhe ngandonjëherë në kurth. Qëllimi i trafikantit është që t’u vendosë në një situatë nga e cila nuk ka kthim mbrapa. Trafikantët gjuajnë pikën tuaj të dobët, që ta shfrytëzojnë atë më vonë.

8. Nëse i vë vetes detyrimin që të bësh atë që ky person thotë, a ke një plan se si mund të dalësh nëse kjo marrëdhënie rezulton e shtirur? Mos harroni që ai që ngre kurthe, kurrë nuk do t'ia dijë për ty dhe fare mirë mund të abuzojë me ty. Kur ai ngre një kurth për ty, kjo do të thotë se ai ka një qëllim tepër specifik ndaj teje dhe ç'do gjë që bën, e bën për të arritur këtë qëllim.

Mos harro: Jeni ju dhe vetëm ju ajo që kontrolloni trupin tuaj. Vetëm ju vedosni për trupin tuaj. Jeni JU kapiteni i anijes suaj. JU vendosni se si do ta drejtoni dhe se sa shpejt do të lundroni. Nuk ka rëndësi se çfarë bëjnë anijet e tjera, sa shpejt lundrojnë ato, ose në çfarë drejtimi ato lëvizin. Ju dhe vetëm JU jeni kapiteni i anijes suaj.

Për Vajzat

Kur shqyrton një propozim martese

Tregohu e kujdesshme

Tregohu skeptike

Në shumë raste vajzat që janë trafikuar përmes premtimeve apo martesave false kanë menduar se djali që kanë takuar ka qenë djali i ëndrrave të tyre, por në fakt ai ka dale një shfrytëzues, që i ka shitur dhe shfrytëzuar. Shumë prej këtyre vajzave kanë bërë gabime të njëjta, gabime që kanë rritur shanset që ato të përfundonin si viktima. Për t'i shmangur këto gabime, lexoni sa më poshtë:

1. Kërkoni një periudhë fejese më të gjatë. Nëse ai nuk pranon, konsiderojë këtë si një paralajmërim.
2. Marrëdhëniet e vërteta duan kohën e tyre. Nëse një djalë nuk të ka njohur për një kohë të gjatë, atëherë si do të të dojë? Tërheqja fizike mund të ndodhë që me pamje të parë, por dashuri do të thotë ta njohësh personin shumë mirë.
3. Dhuratat, lulet, çokollatat, etj., nuk do të thonë dashuri patjetër. Ndoshta, në ndonjë rast janë edhe mënyrë e përdorur nga një trafikant, që kërkon të të fitojë ty me mashtrim.
4. Nëse një djalë të thotë “të dua”, kjo nuk do të thotë vërtetë se ai të do. Ndoshta edhe të mashtron.
5. Ti vlen më shumë se paraqitja jote fizike.
6. Nëse një djalë kërkon që marrëdhënien tuaj kërkon ta mbajë të fshehtë, ose mashtron mbi marrëdhënien tuaj, konsiderojë këtë si një paralajmërim se ai mund të jetë një shfrytëzues.
7. Nëse një djalë nuk ka respekt për ju, në një farë mënyre është një shenjë se ai se nuk ju do vërtet.

8. Nëse një djalë ushtron presion mbi ju p.sh., të kërkon të largohesh nga familja, ose të kushtëzon të kini marrëdhënie seksuale kundër dëshirës suaj etj., kjo nuk është një shenjë e marrëdhënieve të mira.
9. Dhuna është një shenjë e mosrespektit. Nëse një marrëdhënie bëhet e dhunshme, ndërprite atë.
10. Nëse një djalë përdor seksin, paratë, forcën fizike, ose ndonjë metodë tjetër për të siguruar pushtetin, apo kontrollin mbi ju, kjo nuk do të ishte një bazë e mirë për të ndërtuar jetën bashkë.
11. Nëse i dashuri juaj insiston që ti të përdorësh dokumenta të falsifikuara në rast se do të dilni jashtë vendit, ky është një rast pandershmërie dhe mashtrimi.
12. Nëse i dashuri juaj të thotë se ti mund të bësh shumë para shpejt dhe lehtë jashtë vendit, mos i beso. Suksesi financiar për shumicën e njerëzve vjen përmes shkollimit dhe punës për një periudhë të gjatë kohe.
13. Nëse i dashuri juaj ju thotë se ju nuk do të jeni kurrë e suksesshme në Kosovë, mos besoni atij. Ka shumë gra të suksesshme në të gjitha fushat: art, biznes, shkenca, juridiksion, politikë, media, arsim, diplomaci, sipërmarrje private, etj.

Materiale në ndihmë të mësuesit

DEKLARATA UNIVERSALE MBI TË DREJTAT E NJERIUT

HYRJE

Deri sa njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë; Deri sa mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut ka çuar drejt akteve barbare, të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit, dhe deri sa krijimi i botës në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, të besimit dhe lirinë nga frika e skamja është proklamuar si dëshira më e lartë e çdo njeriu; deri sa është e nevojshme që të drejtat e njeriut të mbrohen me dispozita juridike, në mënyrë që njeriu të mos jetë i shtrënguar që në pikën e fundit t'i përvishet kryengritjes kundër tiranisë dhe shtypjes; deri sa është e nevojshme që të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore midis kombeve; deri sa popujt e Kombeve të Bashkuara vërtetuan përsëri në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e personit të njeriut dhe në barazinë midis burrave dhe grave dhe mbasi vendosën që të nxisin përparimin shoqëror dhe të përmirësojnë nivelin e jetës në liri të plotë; derisa shtetet anëtare u detyruan që, në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, të sigurojnë respektimin e përgjithshëm dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore; deri sa kuptimi i përbashkët i këtyre të drejtave dhe lirive është më i rëndësishëm për realizimin e plotë të këtij detyrimi;

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME shpall këtë

DEKLARATË UNIVERSALE MBI TË DREJTAT E NJERIUT si ideal i përgjithshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm shoqëror, duke pasur parasysh gjithmonë këtë deklaratë, të përpiqet që me anë të mësimit dhe të edukimit, të ndihmonte respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe që me anë të masave progresive kombëtare dhe ndërkombëtare, të sigurohej njohja

dhe zbatimi i tyre i përgjithshëm dhe i vërtetë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që janë nën administrimin e tyre.

Neni 1.

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me frymë vëllazërimi.

Neni 2.

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë, pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.

Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.

Neni 3.

Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri personale.

Neni 4.

Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose çifçi; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

Neni 5.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet mundimit, veprimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtërues.

Neni 6.

Gjithkush ka të drejtë që kudo t'i njihet personaliteti para ligjit.

Neni 7.

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë që, pa asnjë diskriminim, të mbrohen barabarësisht nga ligji. Të gjithë kanë të drejtë për t'u mbrojtur barabarësisht kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.

Neni 8.

Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare, për veprimet me të cilat shken të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet.

Neni 9.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose internimit.

Neni 10.

Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale kundër tij.

Neni 11.

Kushdo që është i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe në një proces publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vet.

Asnjëri nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë vepër penale, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në kohën kur janë kryer. Gjithashtu, nuk mund të caktohet një dënim më i rëndë nga ai që është zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale.

Neni 12.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtë të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

Neni 13.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti. Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

Neni 14.

Gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe të gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet.

Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 15.

Gjithkush e ka të drejtën e një nacionaliteti.

Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga nacionaliteti e tij, si dhe as nga e drejta që të ndërrojë nacionalitetin.

Neni 16.

Burrat dhe gratë në moshë të pjekur kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi.

Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen.

Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe e ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

Neni 17.

Gjithkush ka të drejtë të ketë pasuri, si vetëm, ashtu edhe në bashkësi me të tjerët.

Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.

Neni 18.

Gjithkush e ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose të bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, ta shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.

Neni 19.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.

Neni 20.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor.

Asnjëri nuk duhet të detyrohet të bëjë pjesë në ndonjë bashkim.

Neni 21.

Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

Gjithkush ka njëloj të drejtë të ketë qasje në shërbimet publike në vendin e vet.

Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votim të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës ekuivalente të votimit të lirë.

Neni 22.

Si anëtar i shoqërisë, gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale e kulturore, të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.

Neni 23.

Gjithkush ka të drejtë për punë, që të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.

Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë.

Gjithkush që punon ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.

Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë dhe të bëjë pjesë në të, për mbrojtjen e interesave të veta.

Neni 24.

Gjithkush ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orarit të punës dhe pushimin e paguar periodik.

Neni 25.

Gjithkush ka të drejtë për një nivel të mjaftueshëm jetese i cili i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

Nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.

Neni 26.

Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulëta. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet dhe arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të aftësisë.

Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në radhë të parë prindërit.

Neni 27.

Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor dhe dobisë e tij.

Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë.

Neni 28.

Gjithkush ka të drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë.

Neni 29.

Gjithkush ka detyrime vetëm ndaj asaj bashkësie në të cilën është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.

Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, gjithkush do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj, ekskluzivisht me qëllim që të sigurohet

njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve e që të plotësohen kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.

Këto të drejta dhe liri nuk mund të zbatohen në asnjë rast kundër qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara.

Neni 30.

Asgjë në këtë deklaratë nuk mund të interpretohet si e drejtë e një shteti, grupi apo personi për të kryer çfarëdo veprimtarie ose për të bërë një akt drejtuar kundër çdo të drejte ose lirie të shpallur në këtë Deklaratë.

Materiale në ndihmë të mësuesit

“Programi i IOM-it për ndihmë dhe riintegrim të viktimave të trafikimit”

Që nga shkurti i vitit 2000, misioni i IOM-it në Kosovë - njësitë për kundër-trafikim - ka ofruar shërbime për viktimat e trafikimit, për të ndihmuar dhe lehtësuar pasojat, si rezultat i shfrytëzimit seksual dhe të formave të tjera dhe të shkeljes të të drejtave njerëzore që kanë përjetuar.

Përveç përkrahjes për viktimat jokosovare, IOM-i vëmendje të posaçme i kushton burimeve dhe mjeteve në ndihmë viktimave kosovare të trafikimit, duke përfshirë këtu viktimat e trafikuar jashtë Kosovës (që kthehen në Kosovë), si dhe atyre që janë trafikuar brenda Kosovës.

Aktivitetet e kundër-trafikimit të IOM-it dhe partnerëve të tjerë mund t'i ndajmë në disa fushëveprime: Mbrotjtje dhe asistencë (përfshirë riintegrimin e viktimave të huaja dhe vendore); Aktivitete për parandalimin e dukurisë së trafikimit të qenieve njerëzore (përfshirë fushatat për informim dhe ndërgjegjësim të komunitetit), dhe masat për të promovuar fuqizimin socio-ekonomik të femrave.

Që nga fillim i punës, njësitë i IOM-it për kundër-trafikim ka krijuar dhe zhvilluar bashkëpunim të ngushtë me agjensitë vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e kundër-trafikimit dhe çështjeve të tjera të ndërlidhura, si çështjet gjinore dhe mbrojtja e fëmijëve.

Në pajtueshmëri me përfituesin e programit, IOM-i përkrah viktimat e trafikimit drejtpërdrejtë apo nëpërmjet partnerëve qeveritarë dhe agjensive joqeveritare të ndryshme. Plani për ndihmë dhe riintegrim hartohet në bazë individuale, në mënyrë që t'i përgjigjet nevojave dhe rrethanave të veçanta të secilit përfitues.

Programi i IOM-it për riintegrim të viktimave ofron asistencë:

- ▶ Akomodim/referim në qendrat strehuese apo familje kujdestare/strehuese
- ▶ Ndërmjetësim për kthim në familje;
- ▶ Këshillime psiko-sociale (asistencë psiko-sociale, asistencë psikologjike (një-për-një, apo në grupe), asistencë për të sëmurët mendorë);
- ▶ Referim për trajtim psikiatrik (vizita dhe trajtime mjekësore në klinika dhe spitale);

- ▶ Ndihmë financiare (për trajnim, shkollim, ushqim, mjekim, veshmbathje, akomodim, udhëtim);
- ▶ Ndihmë dhe ndërmjetësim për vazhdimin e shkollimit;
- ▶ Udhëzime dhe gjetje shërbimesh për trajnime të ndryshme profesionale;
- ▶ Ndihmë për të gjetur punë (viktima apo anëtarët e familjes);
- ▶ Projekte vetëpunësimi (mikro biznese) etj.
- ▶ Sigurimi i transportit për rastet e trafikuar jashtë vendit;
- ▶ Ndihmë për riintegrim 6-12 muaj, apo sipas nevojës
- ▶ Bashkëpunim me partnerë;

Ruajtje e anonimitetit dhe konfidencialitetit.

Shënim: Programi i mësipërm mund të ndryshojë në bazë të nevojave të përfituesve dhe rrethanave vendore.

Literatura

1. Korniza Kushtetuese e Institucioneve të Përkohshme Vetë-Qeverisëse të Kosovës, 2001
2. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, prill 2004.
3. Kodi i përkohshëm i Procedurës Penale, prill 2004.
4. Rregullorja e UNMIK-ut për Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë, 2001/4, e adaptuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, e miratuar në janar të vitit 2001.
5. Protokolli Opsional i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
6. IOM, misioni në Kosovë, Raporti i gjendjes për viktimat e huaja dhe vendore të trafikimit, të asistuar nga viti 2000 deri më 30 Qershor 2005.
7. UNIFEM, Nuk ka vend të sigurtë, Kosovë, 2000.
8. Studimi demografik dhe shëndetësor në Kosovë, Zyra e statistikave në Kosovë (2004).
9. UNICEF, Trafikimi i fëmijëve në Kosovë, studimi mbi mbrojtjen dhe asistencën që u ofrohet fëmijëve viktimë të trafikimit, Kosovë, Qershor 2004.
10. Protokolli i Kombeve të Bashkuara për të Parandaluar, Ndaluar dhe Ndëshkuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar; dhjetor 2000.
11. Organizata Botërore e Shëndetësisë "Parandalimi i Dhunës dhe Dëmtimit, Dhuna ndaj Grave: Çështjet prioritare të shëndetësisë". Infomacion i OBSH-së përdhunën dhe shëndetin.
12. Trafikimi i qenieve njerëzore dhe roli i shkollës në parandalimin e tij, Doracak për mësimdhënës, IOM dhe Instituti për Studime Pedagogjike, dhe Ambasada e Mbretërisë e Vendeve të Ulta, Tiranë 2003.
13. Trafikimi i qenieve njerëzore dhe roli i shkollës në parandalimin e tij, libri për nxënësit e mësimi të ulët, IOM dhe Instituti për Studime Pedagogjike, dhe Ambasada e Mbretërisë e Vendeve të Ulta, Tiranë 2003.
14. Trafikimi i qenieve njerëzore dhe roli i shkollës në parandalimin e tij, libri për nxënësit e mësimi të mesëm, IOM dhe Instituti për Studime Pedagogjike, dhe Ambasada e Mbretërisë e Vendeve të Ulta, Tiranë 2003.

